студии во коишто е утврдено дека настанувањето на преканцерозните цервикални лезии зависи во голема мера од сексуалното однесување на пациентката. Резултатите покажуваат дека постои статистичка сигнификантност $p < 0,25$ со Odds Ratio (OR) од 1,29 и интервал на доверба 0,7928-2,0091 во фреквенцијата на онкогениот тип HPV16 кај CIN. Истотака се утврди дека HSV, CT и TV инфекциите се можни кофактори на онкогените типови на HPV во настанувањето и развојот на цервикални преканцерозни лезии. Оваа асоцијација меѓу CIN и СПБ коишто се среќаваат во нашата студија е публикувана во минатото и од бројни други автори (Schmauz 1989[8], Kharsany 1993[9]). Хипотезата дека хроничната цервико-вагинална инфламација може да ја зголеми онкогеноста на HPV се наоѓа во многу студии, но има и такви кои ја отфрлаат таа можност (de Sanjose 1994[10]).

Во нашата студија се утврди дека онкогените типови на HPV сепак се најважни фактори во настанувањето и развојот на цервикалните преканцерози, но постои и сигнификантна асоцијација на оваа хетерогена група на вируси со HSV, CT и TV инфекции како можни кофактори во настанувањето и развитокот на CIN (табела1 и график1) особено градус 2 и 3 кај кои е индицирана конизација како третман на избор.

ЗАКЛУЧОК

HPV а особено онкогениот тип HPV16 е најважен фактор на ризик во настанувањето на CIN, а неговата асоцијација се зголемува со степенот на лезијата. Тој во содејство со сексуално преносливите болести завзема големо место меѓу предизвикувачите на цервикалните преканцерозни лезии особено оние кај кои е индициран хируршки третман, заради што употребата на вакцината против HPV инфекцијата, заштитениот сексуален однос како и зголемување на имунитетот на пациентките може да одиграат значајна улога во нивната превенција.

ЛИТЕРАТУРА:

1. KOHLER U., WUTTKE P. Results of a case-control study of a current effect of various factors on a risk of cervix cancer. 1 Factors in reproduction, sex behaviour and infectious genital diseases. Zentralbl Gynakol: 116 (6): 194
2. FRANCO EL. Epidemiology and natural history of HPV-induced disease. 17th International Papillomavirus Conference; 1999 Jan 12th. Charleston, SC, USA.
3. SCHNEIDER A., HOYER H., DURST M. Bedeutung des Nachweises von humanen Papillomviren für die Vorsorge, Dt Dtztebl 2001;98 [Heft 39]: A 2517-21.
4. ZHANG ZF., BEGG CB. Is trichomonas vaginalis a cause of cervical neoplasia/ Results from a combined analysis of 24 studies. Int J Epidemiol 1994;23:683.
5. KOUTSKY LA., HOLMES KK., CRITCHLOW CW. et al. A cohort study of the risk for cervical intraepithelial neoplasia grade 2 or 3 in relation to papillomavirus infection. N Engl J Med 1992;327:1272.
6. ZUR HAUSEN H. Human genital cancer: Sinergism between two virus infections or synergism between a virus infection and initiating events? Lancet 1982;2:1370.
7. RICHART RM., WRIGHT TC. Human papillomavirus. Curr Opin Obstet Gynecol 1992;4:662.
8. SCHMAUZ R., OKONG P., de VILLIERS EM. et al. Multiple infections in cases of cervical cancer from a high-incidence area in tropical Africa. Int J Cancer 1989;43:805-9.
9. KHARSANY AB., HOOSEN A., MOODLEY J., BAGERTEE J., GOUWS E. The association etween sexually transmitted pathogenes and cervical intraepithelial neoplasia in a developing community. Genitourin Med 1993 Oct;69(5):357-60.
10. de SANJOSE S., MUNOZ, BOSCH FX., et al. Sexually transmitted agents and cervical neoplasia in Colombia and Spain. Int J Cancer 1994;56:358-63
11. HOLSCHNEIDER, CHRISTINE H. MD; GHOSH, KRIS MD; MONTZ, F. J. MD, KM. See-and-Treat in the Management of High-Grade Squamous Intraepithelial Lesions of the Cervix: A Resource Utilization Analysis Obstetrics & Gynecology: 1999;94 (3):377-385
12. HOWAYDA S ABD EL ALL, AMANY REFAAT, AND KHADIGA DANDASH Prevalence of cervical neoplastic lesions and Human Papilloma Virus infection in Egypt: National Cervical Cancer Screening Project Infect Agent Cancer. 2007; 2: 12.
13. TOSHIYUKI S, YU-ZHEN D, KIYOFFUMI S, SHIN-ICHIROU S, MASAYA T & MASAKI I. Human Papillomavirus Infection and Risk Determinants for Squamous Intraepithelial Lesion and Cervical Cancer in Japan, Jpn J Cancer Research 1997 April;88:376-384.
14. DAVIES P, KORNEGAY J, IFTNER T. Current methods of testing for human papiullomavirus. Best Pract Res Clin Obstet Gynaecol 2001; 15:677-700.

FRUENCA E HPV16, HERPES SIMPLEX, CHLAMYDIA TRACHOMATIS DHE TRICHOMONAS VAGINALIS TE PACINTËT ME LEZIONE PREKANCEROZE CERVIKALE TË MITRËS TE TË CILËT INDIKOHET KONIZIMI

Dimitrov Goran¹, Xhikova Elena¹, Rufati Nagip³, Antovska Vesna¹, Dinitrov Gligor²

¹ Klinika Universitare Gjonekol,ogjike-obstetrike

² Spitali I pergjithshem Remedika Shkup

³ Qendra Klinike spitalore Tetovë

PËRMBLEDHJE

Hyrje: Është e njohur se sëmundjet që barten në mënyrë seksuale (SBS) asocohen me incidencë të lartë të neoplazisë cervikale intraepitelijale (NCI)

Qëllimi: Të përdëftohet frekuenca e HPV16 dhe bashkëveprimi i ndërsjelltë me Herpes simplex virus (HSV), Chlamydia Trachomatis (CT) dhe Trichomonas vaginalis (TV), si dhe faktorët e ndodhisë të lezioneve të cilat është inicuar konizimi.

Metodat dhe materialet: Janë testuar 136 paciente me NCI të vërtetuar me histologji dhe 50 kontrollime me rezultate normale citologjike dhe kolposkopike.

Rezultatet: Prej 136 pacienteve me NCI, 56.5% HPV+, 48.5% kanë pasur sëmundje që barten në mënyrë seksuale. Në kontrollimet HPV+ ishin 18%. Konizim i inicuar ishte tek 48.5%. Në 50% prej tyre janë vërtetuar HPV16, HSV, CT, TV.

Diskutimi: Frekuenca e HPV16 është e rëndësishme për ndodhjen e NCI. HSV, CT dhe TV janë kontrafaktorë të mundshëm sidomos për lezionet për të cilat është inicuar konizimi.

Përfundim: HPV16 është faktori më i rëndësishëm që rrezikon ndodhjen sidomos të stadiumeve më të larta të NCI dhe sëbashku me SBS është nxitës i rëndësishëm i lezioneve NCI të cilat është inicuar konizimi.

Fjalët kryesore: Neoplazia cervikale intraepitelijale (NCI), konizimi, human paplioma virus (HPV), faktorë të rrezikut dhe kofaktorë, Herpes simplex virus (HSV), Chlamydia Trachomatis (CT), Trichomonas vaginalis (TV), leziona cervikale parakancerogjene.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE E HIV/AIDS NË SHQIPËRI, NË VITIN 2011

Marjeta Dervishi¹, Silvia Bino¹, Roland Bani, Shpëtim Qyra¹, Redona Dudushi¹, Florinda Balla¹

¹Instituti Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 43-48

PËRMBLEDHJE

Bazuar në statistika Shqipëria mbetet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV. Deri në fund të infeksionit 2011, në Shqipëri janë raportuar 485 raste me HIV/AIDS. Shpërndarja e rasteve HIV pozitive në vite tregon që tendenca është në rritje. Në vitin 2011 janë raportuar 72 raste të reja, 40 prej të cilave në stadin AIDS. Niveli i infeksionit HIV në 2011 ishte 2.25 për 100 000 banorë, niveli më i lartë vjetor i hasur në periudhën 1993-2011. Në total, 40% e rasteve kanë zhvilluar AIDS dhe 19 % e tyre kanë vdekur nga shkaqe të lidhura me AIDS. Shpërndarja sipas seksit tregon se 70% janë meshkuj dhe 30% janë femra. Rruga seksuale është mënyra kryesore e transmetimit të infeksionit HIV, 82% e kanë marrë këtë infeksion nëpërmjet rrugës heteroseksuale, 10% përmes marrëdhënieve homo-biseksuale, 4% nga nëna te fëmija, 2.5% nga transfuzioni i gjakut, më pak se 1% janë raportuar si përdorues intravenozë të drogës. Shumica e rasteve ose 66% i përket grupmoshës 25-49 vjeç, 5% e totalit i përket fëmijëve të grupmoshës 0-15 vjeç. 33% e rasteve që jetojnë me HIV/AIDS marrin terapinë me antiretrovirale (ART). Vetëm institucioni publik Qendra Spitalore Universitare Tirane, (QSUT), siguron ndjekjen dhe trajtimin me anti retrovirale për personat që jetojnë me HIV/AIDS. Në 2011, afërsisht 26000 persona mbi 15 vjeç, janë testuar për HIV në Shqipëri.

Fjalë kyçe: HIV/AIDS, epidemiologji, prevalencë, rrugë transmetimi.

HYRJE

HIV/AIDS-i është një nga problemet më madhore të shëndetit, pasi sëmundjet e lidhura me AIDS-in përbëjnë një nga shkaqet më të rëndësishme të vdekjeve në botë. Sipas parashikimeve, ato do të vazhdojnë të jenë një nga shkaqet kryesore të vdekjeve të parakohshme edhe në dhjetëvjeçarët e ardhshëm. Nga të dhënat e raportit të UNAIDS-it të vitit 2010 mbi epideminë botërore të AIDS-it vlerësohet se në vitin 2010 afro 34 milionë (31.6-35.2 milion) njerëz jetonin me HIV dhe midis tyre 2.5 milionë (1.6 - 3.4 milionë) ishin fëmijë nën 15 vjeç. Njëkohësisht, po në vitin 2010, janë evidentuar rreth 2.7 milionë (2.4-2.9 milionë) raste të reja me HIV. Numri i rasteve të infektuara me HIV është duke u ulur, madje në disa vende më shpejt se në të tjerët. Incidenca e HIV-it ka rënë në 33 vende, 22 prej të cilave në Afrikën Sub-Sahariane, që mbetet rajoni më i prekur nga epidemia e AIDS-it. Ndërkohë, si pasojë e rritjes së aksesit në shërbimet e parandalimit nga nëna të fëmija, vërehet një ulje e numrit total të fëmijëve të lindur me HIV.

Në vitin 2010 u diagnostikuan vetëm 390 000 (340 000-450 000) raste të reja të fëmijët duke evidentuar një rënie prej 30% krahasuar me vitet 2002-2003 ku

kjo shifer ishte 560 000 (500 000-630 000). Në vitin 2010, numri i vdekjeve të lidhura me AIDS-in është ulur nga 2.2 milionë (1.9-2.3 milionë) që ishte në mesin e viteve 2000 në shifra që vlerësohen të jenë 1.8 milionë (1.6-1.9 milionë). Kjo ulje pasqyron rritjen e mundësisë për trajtim me antiretrovirale, por edhe për kujdes e mbështetje. Gjithsesi, vlerësimet tregojnë se në vitin 2010 humbën jetën nga sëmundjet e lidhura me AIDS-in 260.000 (150.000-360.000) fëmijë, një shifër prej 19% më pak se ajo që u vlerësua në vitin 2004. Kjo prirje pasqyron edhe njëherë shtrirjen e shërbimeve të parandalimit të transmetimit të HIV-it te fëmijët si dhe rritjen, ndonëse të ngadaltë, të aksesit në trajtimin për fëmijët (1, 2, 3, 6).

Epidemia e HIV/AIDS-it në Shqipëri është shfaqur relativisht më vonë krahasuar me vendet e tjera evropiane. Në rast se do t'u referoheshim shifrave të EUROHIV-it, ku pasqyrohet mbikëqyrja e HIV/AIDS-it në Evropë sipas OBSH-së dhe ECDC-së, Shqipëria bën pjesë në vendet e Evropës Qendrore së bashku me shumicën e vendeve të Evropës Juglindore (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia) dhe vende të tjera të BE-së (Çekia, Hungaria, Polonia, Qiproja, Sllovakia, Sllovenia) dhe

Turqia. Ky rajon paraqet shifrat më të ulëta të rasteve të reja me HIV (1.4/100000 banorë), por me një numër më të lartë të rasteve në moshat e reja krahasuar me Evropën Perëndimore dhe atë Lindore (18.9%). Bazuar në të dhënat seroepidemiologjike që nga viti 1993 (vit në të cilin është diagnostikuar personi i parë i infektuar me virusin HIV) deri në fund të vitit 2011, numri i të diagnostikuarve me HIV/AIDS në vendin tonë arrin në 485 persona (4). Burimet kryesore të të dhënave të profilit epidemiologjik të HIV/AIDS në vendin tonë janë si me poshtë:

1. Programi Kombëtar i HIV/AIDS.
2. Shërbimi Infektiv pranë QSUT.
3. Shërbimi Pediatrik pranë QSUT
4. Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive.
5. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.
6. Qendrat e Këshillimit dhe Testimit Vullnetar në nivel prefekturë.
7. Organizata të ndryshme jo-qeveritare (OJQ)
8. Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe, etj.

QËLLIMI I PUNIMIT

Të rishikojë, të analizojë dhe të dokumentojë situatën epidemiologjike të HIV/AIDS në Shqipëri, deri në fund të vitit 2011.

MATERIALI DHE METODA

Në këte punim janë paraqitur të dhënat e rasteve seropozitivë të diagnostikuara deri në fund të vitit 2011.

Në periudha të ndryshme janë serosurvejuar grup-popullata të ndryshme:

- Persona të suspektuar nga klinika të ndryshme.
- Dhuruesit e gjakut
- Persona me sjellje rrisht për HIV/AIDS (vullnetarë)
- Persona që i përkasin grupeve vulnerabël ndaj HIV/AIDS (Përdorues të drogës me injektim, punëtorët e seksit, meshkuj që kryejnë seks me meshkuj, viktimat e trafikimit etj)
- Persona të politransfuzuar
- Gra shtatzana
- Persona që kërkojnë testim për efekt dokumentash

Pasqyra 1: Shpërndarja e rasteve me HIV/AIDS në vitet 1993-2011

Vitet	'93	'94	'95	'96	'97	'98	'99	'00	'01	'02	'03	'04	'05	'06	'07	'08	'09	'10	'11
HIV+	2	9	12	7	3	5	4	10	20	26	21	29	31	32	44	49	61	48	72
AIDS		1	4	3	2	1		4	12	10	5	6	9	7	18	20	32	25	40

Duke qenë se vendi ynë është një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV, atëherë vëmendja është përqendruar te grupet më në risk.

Sipas rekomandimeve të OBSH mbi Survejancën e Gjeneratës së Dytë, janë kryer disa herë Studimet Biologjike dhe të Sjelljeve (Bio- BSS, përkatësisht në vitet 2005, 2008 dhe 2011), në grupet vulnerabël të listuara më poshtë (8).

- Përdoruesit e drogës me injektim (PDI)
- Meshkuj që kryejnë seks me meshkuj (MSM)
- Komuniteti ROM

Në studimin e vitit 2005 është kryer kjo survejancë edhe në popullatën e përgjithshme.

Këto studime përcaktojnë prevalencën e HIV-it në grupet me risk më të lartë dhe ndihmojnë në një planifikim më të mirë të programeve të parandalimit.

Të dhënat e sjelljeve për personat që testohen për HIV mblidhen nga plotësimi i skedës së HIV-it, skedë e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.


Përsa i përket pjesës biologjike kampionet pozitive (reaktive) me ELISA janë konfirmuar me testin Western Blott në Laboratorin Kombëtar të Referencës së HIV/AIDS në Institutin e Shëndetit Publik ose pranë Laboratorit të Mikrobiologjisë, në QSUT.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Gjatë vitit **2011** janë diagnostikuar **72 raste** me HIV/AIDS, duke paraqitur një nivel të rasteve të reja të infektuara me HIV/AIDS prej **2.25 raste /100 000 banore**, niveli më i lartë i hasur në vendin tonë. Numri i përgjithshëm (kumulativ qysh prej vitit 1993 të rastit të parë të diagnostikuar me HIV në vendin tonë) i rasteve HIV pozitive rezulton të jetë **485 raste**, (Pasqyra 1, Grafiku 1). Vihen re qartë tendencat në rritje të infeksionit HIV nga viti në vit. Nga **72 rastet** incidente të vitit 2011, **40 raste** kanë shfaqur AIDS-in .

Numri total i rasteve me AIDS shkon në **199 raste ose 41%**, ndërsa numri i vdekjeve nga AIDS shkon në **93 raste ose 19%** (7 raste janë vdekje nga AIDS në 2011, 6 prej të cilëve janë raste të diagnostikuara në vitin 2011 dhe 1 rast i diagnostikuar në vitin 2008).

Grafiku 1: Shpërndarja e rasteve HIV/AIDS në vitet 1993-2011



Nga ky grafik duket qartë tendenca në rritje e numrit të rasteve të diagnostikuara nga viti në vit. Një pjesë e madhe e rasteve diagnostikohen në stadin AIDS, pra bëhet fjalë për një diagnostikim të vonshëm të tyre. Ky fakt mbështetet edhe nga të dhënat e shpërndarjes së rasteve sipas referimit të tyre, të treguara në pasqyrën 2.

Pasqyra 2: Shpërndarja e rasteve me HIV/AIDS në vitet sipas referimit 1993-2011

Referimi	Perqindja
Klinikat	60 %
Vullnetare	14 %
Ndjekje epidemiologjike	14 %
QKTGJ	11%
Per efekt dokumenta	1%
Total	100.0%

Shpërndarja e rasteve me HIV/AIDS sipas gjinisë, tregon se në vitet e para të fillimit të epidemisë së HIV/AIDS në vendin tonë (1993-2000), femrat përbënin një përqindje mjaft të ulët në krahasim me meshkujt; më pas u duk qartë një tendencë feminizimi, vitet e fundit kjo tendencë në rritje po zëvendësohet me nivel të qëndrueshëm të peshës specifike të femrave në totalin vjetor të rasteve të raportuara për çdo vit. (pasqyra 3, Grafiku 2).[7,8]


Shpërndarja totale tregon se meshkujt përbëjnë 70% të rasteve kundrejt femrave që zënë 30% të ketij totali.

Nëse i referohemi vitit të fundit 2011, nga 72 rastet e reja të vitit 2006, 52 janë meshkuj dhe 20 janë femra. Është rritur numri i rasteve që diagnostikohen në çift, vetëm në vitin 2011, 16 raste HIV pozitive janë diagnostikuar në çift, cka thekson edhe njëherë rrugën seksuale të transmetimit HIV-it në vendin tonë.

Pasqyra 3: Shpërndarja e rasteve HIV+ sipas gjinisë për periudhën 1993-2011

Vitet	Meshkuj (Nr. Raste)	Femra (Nr. Raste)
1993-1996	24	6
1997	3	
1998	5	
1999	4	
2000	7	3
2001	17	3
2002	16	10
2003	13	8
2004	18	11
2005	22	9
2006	21	11
2007	31	13
2008	30	19
2009	43	18
2010	33	15
2011	52	20
Totali	339	146


Grafiku 2: Shpërndarja e rasteve në përqindje sipas gjinisë për periudhën 1993-2011



Shpërndarja gjeografike e rasteve me HIV/AIDS tregon se 54.5 % e tyre i përket vendbanimit Tiranë, ndërsa rrethet e tjera në ndryshim të madh nga Tirana zënë një përqindje më të vogël (< 5%). Një informacion më të saktë mbi shpërndarjen e rasteve sipas vendbanimit jep harta e prevalencës (raste /100000 banorë) së HIV-it sipas rretheve.

Harta tregon se shpërndarja e rasteve është shtrirë në shumicën e rretheve të vendit, duke mbetur jashtë vetëm 4 rrethe të vogla.

Prevalenca (raste/100000 banore) e HIV/AIDS sipas rretheve deri ne vitin 2011



Rastet e diagnostikuara si seropozitive për HIV janë të shpërndara (0-5 vjeç) deri në moshën e avancuar (mbi 65 vjeç).

Grupmosha më e prekur nga HIV/AIDS rezulton të jetë ajo 25-49 vjeç, që zë 73 % të totalit të rasteve. Kjo grupmoshë, seksualisht aktive tregon edhe njëherë që në vendin tone predominon rruga seksuale e transmetimit.

Të rinjtë 15-24 vjeç zënë pothuajse 8.5% të totalit të rasteve, por nisur nga studimet e ndryshme të sjelljeve me risk të fokusuar te ky grup, ne i konsiderojmë kete grupmoshë si një grup vulnerabël [Most At Risk Adolescents (MARA); BIO-BSS etj].

Fëmijët (0-15vjeç) përbëjne 5% të rasteve në total, ku 18 ose 75% e tyre e kanë marrë këtë infeksion nëpërmjet transmetimit vertikal dhe vetëm 6 ose 25 % e tyre nëpërmjet transfuzionit të gjakut.

Vetëm në vitin 2011 u raportuan tre raste të reja të infektuara me HIV nëpërmjet transmetimit vertikal, fakt ky që dëshmon se ka ardhur koha për krijimin e një Programi Kombëtar të Parandalimit të HIV nga nëna te fëmija. Nga një vlerësim i nevojave psiko-sociale dhe ekonomike të familjeve të femijeve që jetojne me HIV/AIDS në vendin tone, dolën një seri problemesh që bashkëshoqëronin problemin shëndetësor të këtyre

fëmijëve, për të cilat u sugjeruan dhe rekomandimet përkatëse. Disa prej këtyre rekomandimeve janë:

- Përfshirja e testimit dhe e këshillimit për HIV për gratë shtatzëna në paketën e shërbimeve bazë të kujdesit të paralindjes.
- Krijimi i një Programi Kombëtar për Parandalimin e Transmetimit nga Nëna te Fëmija (PKPTNF) që do të reduktonte lindjen e një fëmije HIV pozitiv nga nëna e infektuar me HIV. [5]
- Mbështetja psikosociale dhe ekonomike për fëmijët me HIV/AIDS dhe për familjet e tyre.
- Njohja e Ligjit të HIV/AIDS-it nga të gjithë aktorët dhe zbatimi i tij me korrektësi. Shoqërimi i Ligjit me mjete financiare e ndoshta edhe me një udhëzues për të lehtësuar zbatimin e tij. [11]
- Trajnimi i vazhdueshëm i personelit shëndetësor (i mjekëve, infermierëve), mesuesve, psikologeve mbi problemet e HIV/AIDS-it.
- Fuqizimi i qendrave të këshillimit dhe të testimit për HIV në rrethe, rishikimi i protokolleve dhe i standardeve të funksionimit të tyre për t'i bërë këto shërbime sa më të efektshme.
- Trajnimi i medias mbi problemet e HIV/AIDS-it në mënyrë që të mos përballemi më me situatat e pakëndshme që e kanë thelluar më tej stigmatizimin ndaj personave me HIV/AIDS. Fushatat sensibilizuese të shtrihen gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm me rastin e 1 Dhjetorit.

Pasqyra 4: Shpërndarja e rasteve HIV/AIDS sipas grup-moshave gjatë periudhës 1997-2011


Vitet	<1vj	1-4vj	5-9vj	10-14vj	15-19vj	20-24vj	25-29vj	30-34vj	35-39vj	40-44vj	45-49vj	50-54vj	55-59vj	60-64vj	65+
1997	1							2							
1998						1	2		1		1				
1999								1	1		1		1		
2000						3	1	1	2	1			1	1	
2001							4	4	5	4	2	1			
2002	1				1	1	5	6	4	4	1	1		1	1
2003		2	1			1	3	2	7	4		1			
2004			1			1	4	9	4	6	3		1		
2005		1		1	1	3	2	1	6	7	5		1	1	1
2006	1	2	2			1	1	6	9	3	4		1	1	1
2007		4			2	1	6	7	9	6	4	1	1	2	2
2008			1			5	3	9	9	12	4	3	1		2
2009		2				7	9	8	9	5	5	6	2	3	1
2010					2	3	3	6	10	3	6	2	3	4	2
2011		2		1	1	2	12	9	12	9	8	7	1	3	1
Totali	2	14	5	2	7	29	55	71	88	64	44	22	13	14	11

Shpërndarja sipas rrugës së transmetimit tregon se në **84 %** te rasteve, HIV/AIDS është transmetuar nëpërmjet rrugës heteroseksuale, **9%** e rasteve i përkasin grupit të meshkujve që kryejnë seks me meshkuj (MSM), afërsisht **4%** e zë rruga vertikale e transmetimit, **2.5 %** e zë rruga e transmetimit të HIV nëpërmjet gjakut dhe në përqindje mjaft të vogël e kemi ndeshur këtë infeksion tek përdoruesit e drogës me injektim, duke mos qenë të sigurtë për mënyrën sesi e kanë marrë këta përdorues këtë infeksion, nëpërmjet shkëmbimit të shiringave apo rrugës seksuale.

Pasqyra 5: Shpërndarja e rasteve HIV/AIDS sipas rrugëve të transmetimit gjatë periudhës 1993-2011

Vitet	hetero	homo-bisex	Gjaku	Përdorues drogë	Transmetimi vertikal	I papërcaktuar
1993	1	1				
1994	5	2	2			
1995	9	2	1			
1996	5	1	1			
1997	1	1			1	
1998	3	2				
1999	2	1				1
2000	8	2				
2001	16	4				
2002	22	2		1	1	
2003	16	2			3	
2004	26	1	1	1		
2005	26	1	4			
2006	27				4	
2007	37	1	2	1	3	
2008	42	6			1	
2009	51	7		1	2	
2010	44	3	1			
2011	64	5			3	
Totali	405	44	12	4	18	1

Grafiku 3: Shpërndarja e rasteve HIV/AIDS sipas grup-moshave gjatë periudhës 1993-2011



Nga viti 2004 në vendin tonë ofrohet terapia falas me antiretrovirale, 161 raste (147 te rritur dhe 14 femije) marrin këtë terapi pranë Sherbimit Infektiv dhe atij Pediatric, pranë QSUT deri në fund të vitit 2011. Që nga viti 2007 në vendin tonë funksionojnë qendrat e Këshillimit dhe Testimit Vullnetar (KTV) në nivel prefekturë, të cilat ofrojnë këshillim për të gjithë personat që testohen për HIV. Megjithatë duhet të theksohet se pavarësisht nga kjo, numri i testeve vullnetare mbetet në nivele të ulëta çka do të thotë se duhet të punohet më shumë për t'i bërë më efektive këto shërbime.

Pasqyra 6 sjell një informacion të detajuar mbi numrin e testeve për HIV gjatë vitit 2011 (vullnetarë, të rekomanduara dhe të detyruara) të shpërndara sipas qendrave ku janë kryer këto teste. Shihet qartë se dominojnë testimet e detyruara te donatorët e gjakut, ndërsa testimet vullnetare zënë vetëm 6.4 % të totalit të testeve të kryera për HIV.

Pasqyra 6: Shpërndarja e numrit të testeve për HIV gjatë vitit 2011, sipas institucioneve ku janë kryer këto teste

INSTITUCIONI	TESTIME VULLNETARE	TESTIME TE REKOMANDUARA	DONATORE GJAKU	TOTALI
ISHP	316	930	0	1 246
VCT NE RRETHE (12)	1 060	0	0	1 060
QKTGJ	0	0	22 745	22 745
KLINIKA AMBULATORE	301	653	0	954
TOTALI	1 677	1 583	22 745	26 005

Të gjithë personave që janë paraqitur si vullnetarë në Institutin e Shëndetit Publik ose në VCT e rretheve, ju është ofruar këshillimi para dhe pas testimit.[9]

PËRFUNDIME

1. Shqipëria vazhdon të mbetet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV, me një tendencë në rritje, duke fokusuar vëmendjen në grupet me risk më të madh.
2. Në vendin tonë predominon rruga seksuale e transmetimit të HIV.
3. HIV/AIDS ndeshet në të gjitha moshat, por grupmosha

- më e prekur është 25-45 vjeç, çka thekson edhe njëherë dominimin e rrugës seksuale të transmetimit.
4. Rastet më të shumta të të infektuarve me HIV janë në Tiranë.
 5. Numri i testimeve vullnetare për HIV mbetet në nivele të ulëta dhe një përqindje e konsiderueshme e rasteve HIV pozitive diagnostikohen në stad të avancuar, ndaj kërkohet informim i vazhdueshëm i popullatës për HIV/AIDS-in dhe të nxitet testimi vullnetar për HIV.
 5. WHO 2011. Towards the elimination of mother to child transmission of HIV.
 6. UNAIDS, WHO, 09 AIDS epidemic update.
 7. QYRA SH. Studim seroepidemiologjik mbi infeksionin HIV për vitin 2005 në Shqipëri. Revista mjekësore 2006; 2; 19-28.
 8. BOCI M. HIV/SIDA në Shqipëri, vështrim i përgjithshëm, 2006.
 9. UNAIDS /WHO. World Health Organization and joint united nations programme on HIV/AIDS , 2000: "Guidelines for second generation HIV surveillance".
 10. WHO, Delivering HIV test results and messages for re-testing and counselling in adult.
 11. Ligji Nr. 9952, Datë 14.7.2008 "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it".

BIBLIOGRAFIA

1. UNAIDS. Report on the global aids epidemic,
2. CDC. The global HIV/AIDS pandemic 2010.
3. ECDC. HIV/AIDS surveillance report 2010.
4. ISHP. Raporti vjetor i HIV/AIDS, 2011.

SERO-EPIDEMIOLOGICAL STUDY OF HIV INFECTION ON 2011 IN ALBANIA

Marjeta Dervishi¹, Silvia Bino¹, Roland Bani,¹Shpëtim Qyra¹, Redona Dudushi¹, Florinda Balla¹

¹Institute of Public Health, Tirana, Albania

SUMMARY

Based on the statistics Albania remains a low HIV prevalence country. By the end of 2011, Albania has reported a cumulative total of 485 cases. The distribution of HIV cases in years shows that the trend is going up. For the year 2011, 72 new cases were reported, 40 out of them in the stage of AIDS. The rate of newly diagnosed HIV infections in 2011 was 2.25 per 100 000 population, which is the highest rate /per year, in the period 1993-2011. In total 40% of them have developed AIDS and 19 % of them died from AIDS-related causes. According to the distribution by sex, 70% were males male and 30% females. Sexual transmission is most common way of infection, 82% were transmitted via heterosexual contact, 10% via homo-bisexual intercourse, 4% from mother to child transmission, 2.5 % from blood transfusion, less than 1% has been reported as IDU (Injecting Drug User). Most of the cases (or 66%) of them belong to the age group 25-49 yr. old; 5% of the total belong to the age group 0-15 yr. old. 33% of PLWHA were on antiretroviral therapy (ART). The only governmental institution providing follow-up and antiretroviral therapy (ART) for people living with HIV in Albania is the University Hospital Centre, in the capital city of Albania. In 2011, approximately 26 000 people over 15 yr. old were tested for HIV in Albania.

Key words: HIV/AIDS, epidemiology, prevalence, way of transmission

ECURIA E PROCESIT KARIOZ NË DENTACIONIN E PËRZIER TE FËMIJËT E MOSHËS 7 DERI NË 10 VJEÇ NË QARKUN E DURRËSIT, SHQIPËRI

Fiorda Mezini

Specialiste stomatologjie në Qendrën e Shëndetit Durrës Pedagoge në Universitetin Planetar të Tiranës

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 49-54

ABSTRAKT

Kariesi i dhëmbëve është një problem madhor i shëndetit të gojës. Megjithatë, studimet e bëra në lidhje me këtë sëmundje të dhëmbëve dhe në veçanti në raport me denticionin e përzier te fëmijët, janë disi në numër të kufizuar.

Qëllimi i këtij studimi ishte të përcaktohej niveli i kariesit të dhëmbëve te fëmijët 7-10 vjeç të qarkut të Durrësit.

Kariesi i dhëmbëve u vlerësua në përputhje me kriteret e OBSH(1997) duke përdorur indeksin *dmft* për dhëmbët e qumështit dhe indeksin *DMFT* për dhëmbët e përhershëm, ku *d/D* tregon numrin e dhëmbëve të prishur, *m/M* tregon numrin e dhëmbëve të munguar për shkak të kariesit; *f/F* tregon numrin e dhëmbëve të mbushur, dhe *t/T* dhëmbët.

Në përfundim të studimit rezultoi që *dmft* për fëmijët e moshave 7,8,9 dhe 10 vjeç ishte respektivisht 3.7 , 4.3 , 3.6, 2.1. *DMFT* po për këta fëmijë të moshave 7,8,9 dhe 10 vjeç ishte respektivisht 0.48 , 4.3 , 3.6 , dhe 1.7.

Prevalenca e kariesit ishte 92.1%. Duket që prevalenca e lartë e kariesit në dhëmbët e përkohshëm është një faktor që rrit riskun për karies të dhëmbëve të përhershëm.

Fjalët kyç: karies i dhëmbëve, denticion miks, prevalencë, *dmft*, *DMFT*.

HYRJE

Kariesi i dhëmbëve është një problem madhor i shëndetit oral. Pasojat e tij janë dhimbja, vuajtja dhe ulja e cilësisë së jetës te fëmijët [3]. Prevalenca e kariesit të dhëmbëve në popullata dhe shtrirja e tij në individ varion. Prevalenca e kariesit gjithashtu varion me kalimin e kohës dhe në varësi të zonave gjeografike. Mbi 95% e vendeve të zhvilluara janë të prekura nga kariesi [16,1,23].

Shumë studime janë kryer për të përcaktuar etiologjinë, prevalencën dhe trajtimin e kariesit, por numri i studimeve në lidhje me prevalencën e kariesit në denticionin e përzier është shumë i kufizuar. Mbledhja e të dhënave në lidhje me shfaqjen e kariesit në denticionin e përzier ka një rëndësi të madhe sepse kjo periudhë është koha kur në gojë gjenden si dhëmbët e qumështit dhe ata të përhershëm. Kjo periudhë normalisht zgjat nga mosha 6-11 vjeç.

Kariesi i dhëmbëve u vlerësua në përputhje me kriteret e OBSH (1997) duke përdorur indeksin *dmft* për dhëmbët e qumështit dhe indeksin *DMFT* për dhëmbët e përhershëm, ku *d/D* tregon numrin e dhëmbëve të prishur, *m/M* tregon numrin e dhëmbëve të munguar për shkak të kariesit; *f/F* tregon numrin e dhëmbëve të mbushur, dhe *t/T* dhëmbët.

Prevalenca e kariesit për fëmijët me moshë 6-11 vjeç vlerësohet nga shuma totale e regjistruar e vlerave të *dmft* dhe *DMFT* respektivisht për dhëmbët e qumështit dhe për dhëmbët e përhershëm.

Ka evidenca të mjaftueshme që dëshmojnë se prevalenca e kariesit është reduktuar ndjeshëm gjatë dy dekadave të fundit për grup-moshën e re të popullsisë në shumë vende të zhvilluara. Edhe pse shkencëtarët nuk bien dakort kur është fjala për renditjen e faktorëve që kanë ndikuar në këtë dukuri, përdorimi i gjerë i florit shpesh cilësohet si faktori që ka luajtur rolin kryesor [2,11,18].

Studimet epidemiologjike bëjnë të mundur monitorimin e popullatës për të vlerësuar nivelin e trendeve të indikatorëve të shëndetit të gojës. Për pasojë, morbiditeti dhe nevojat për trajtime mund të orientojnë ndërmarjen e nismave për programe të shëndetit që përmbushin këto nevoja të tij.

Një numër i madh studimesh epidemiologjike të kryera kudo në botë kanë dëshmuar për një lidhje direkte midis kariesit dhe faktorëve të ndryshëm, sikurse janë: faktorët e sjelljes, faktorët social, faktorët ekonomik dhe faktorët klinik. Në këto studime theksohet se larja e dhëmbëve dhe praktikatat e ruajtjes së higijenës së gojës janë faktorë

kryesorë të lidhur me përhapjen e kariesit [19,24,4]. Autorë të tjerë kanë arritur në përfundimin se prevalenca e kariesit shtohet me rritjen e moshës [4,5-12].

Në shumë studime të bëra në vende të ndryshme rezultojnë se kariesi i dhëmbëve të qumështit ndikon më shumë se variablat e tjerë në kariesin e dhëmbëve të përhershëm. Kjo lidhje mes tyre ndryshon nga ndikimi i kariesit nga faktorët socio-ekonomik [4,12,9,15,13].

Autorë të tjerë kanë publikuar një lidhje midis kariesit dhe gjinisë. Sipas tyre, te meshkujt vihet re një prevalencë më të lartë e kariesit sesa te femrat [7,12,10]. Një situatë e ngjashme është vënë re edhe për dhëmbët e përhershëm [17,20,21,22].

Ky studim u krye për tu dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

1. Cila është gjendja e kariesit të dhëmbëve te fëmijët 7-10 vjeç?
2. Si të përmirësohen në të ardhmen politikat për menaxhimin e kariesit në denticionin e përzier?
3. Të grumbullohen të dhëna që do të shërbejnë si referenca për krahasime me studime të ngjashme në të ardhmen që të percaktohet nëse situata është përmirësuar apo është përkeqësuar?

MATERIALET DHE METODAT

Për kryerjen e këtij studimi u përzgjedhën në total 585 (n=585) fëmijë të moshës 7-10 vjeç të qarkut të Durrësit. Studimi filloi në shtator të vitit 2011 dhe përfundoi në prill të vitit 2012. Për këtë qëllim, fillimisht u plotësua një pyetësor për çdo fëmijë ku u regjistruan emri, mosha, gjinia.

Në studim u përfshinë vetëm ata fëmijë të cilët dhanë pëlqimin e tyre dhe për të cilët u mor dhe aprovimi i mësuesve dhe prindërve të tyre.

Ekzaminimet intraorale u bënë nëpër klasa në shkolla 9 vjeçare, me anë të sondës, pasqyrës dhe dritës. Radiografitë nuk u përdorën për të diagnostikuar kariesin.

Të dhënat e grumbulluara për kariesin e dhëmbëve u regjistrua duke përdorur indeksin *DMFT* për dhëmbët e përhershëm, dhe *dmft* për dhëmbët përkohshëm, ku (D=të prishur, M=mungojnë, F=të mbushur, T=dhëmbë), në përputhje me kriteret e OBSH(1997).

Të dhënat e grumbulluara u përpunuan me versionin 10.0 të programit SPSS që përdoret për përpunime statistikore shëndetësore.

REZULTATET

Mostra e studimit

U mblodhën të dhëna për 585 fëmijë të moshës 7-10 vjeç të cilët përbëheshin nga 293 (50.1%) fëmijë meshkuj dhe 292 (49.9%) fëmijë femra. Mesatarja e moshës së fëmijëve të marrë në studim ishte 8.5 .Mesatarja e moshës për fëmijët meshkuj ishte 8.4 dhe për fëmijët femra ishte 8.6, të cilat nuk përbëjnë ndonjë ndryshim domethënës. Nga përpunimi i të dhënave të formularëve të plotësuar me të dhënat e mbledhura rezultuan parametrat mëposhtëm:

PRANIA E KARIESIT TË DHËMBËVE

Dhëmbët e qumështit

Njëqind e një fëmijë (17.2%) nuk kishin karies në dhëmbët e qumështit. Nga këta 51 (8.7%) ishin meshkuj dhe 50 (8.5%) ishin femra.

Katërqind e tetëdhjetë e katër fëmijë (N=484) (82.7%) rezultuan se kishin karies në një ose më shumë dhëmbë qumështi.

Shpërndarja e fëmijëve që kishin nga 1 deri në 12 dhëmbë të prishur paraqitet në tabelën 1.

Tabela 1. Shpërndarja e indeksit të *DMFT* për dhëmbët e qumështit dhe të përhershëm të mostrës në studim.

dmft/DMFT	dh.e përkohshëm nr (%)	dh.e përhershëm nr (%)
0	101	301
1	69	79
2	86	130
3	73	38
4	78	32
5	53	3
6	39	1
7	29	1
8	27	
9	12	
10	7	
11	6	
12	5	
Total	585 (100)	585 (100)

Tabela 2 tregon vlerën e mesatares së *dmft* ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Tabela 2. Krahasimi i dmft/DMFT ndërmjet meshkujve dhe femrave

Numri	Mesatarja e dmft/DMFT
Dh.qumështi	
Meshkuj	3.4
Femra	3.3
Dh.Përhershëm	
Meshkuj	0.9
Femra	1.0

Frekuenca e prekjës së dhëmbëve të përhershëm

Ne tabelën 3 është paraqitur numri total i dhëmbëve të përhershëm me $DMFT \geq 0$ dhe përqindja e rasteve të prekur nga kariesi ($DMFT \geq 0$) për secilin prej këture dhëmbëve.

Tabela 3. Nr.dhe përqindja e dhëmbëve të përhershëm të prekur nga kariesi ($DMFT \geq 0$).

Dhëmbi	Numri i rasteve me karies	Përqindja e kariesit (%)
11	9	1.5
12	6	1
13	0	0
14	0	0
15	0	0
16	75	12.5
21	4	0.7
22	3	0.5
23	0	0
24	2	0.3
25	1	0.2
26	77	12.8
31	1	0.2
32	0	0
33	0	0
34	1	0.2
35	2	0.3
36	211	35
41	1	0.2
42	1	0.2
43	0	0
44	1	0.2
45	11	1.8
46	195	32.4
TOTAL	601	100

Gjendja e molarëve të qumështiit te fëmijët 7,8,9 dhe 10 vjeçar është paraqitur përkatësisht në tabelat 4,5,6,7.

U vu re se ndërmjet dhëmbëve me karies, kariesi i patrajtuar rezultoi dukuri në shumicën e dhëmbëve, duke u pasuar nga indikatorit tjetër- dhëmbët që mungonin. U konstatuan shumë pak dhëmbë qumështi të mbushur.

Dhëmbët e përhershëm

Treçind e një fëmijë (51.4%) nuk kishin karies në dhëmbët e përhershëm. Nga këta 157(26.8%) ishin meshkuj dhe 144 (24.6%) ishin femra. Pravalenca e kariesit ishte 48.6%.

Fëmijët me karies kishin vlera të $DMFT$ nga 0 në 7 nga të cilët 247 (42.2%) kishin një $DMFT$ ndërmjet 1 dhe 3.

Vlerat e frekuencës së kariesit për premolarët e përhershëm 45, 44, 25, 24 ishin respektivisht 1.8%, 0.2%, 0.2%, 0.3%. Më shumë të prekur nga kariesi rezultuan molarët e parë të poshtëm të përhershëm (36-35% dhe 46-32.4%), krahasuar me molarët e përhershëm të sipërm (16-12.5% dhe 26 -12.8%).

Fëmijët që nuk kishin karies as në dhëmbët e qumështit dhe as në dhëmbët e përhershëm përbënin 7,8% (N= 46) të fëmijëve të marë në studim. Pravalenca e kariesit në total dmth $dmft$ dhe $DMFT > 0$ ishte 92.1% (N=539).

Tabela.4 Gjendja e 8 molarëve të qumështit te 7 vjeçarët

nr	Nr (%)			
	0	1	2	3
D55(142)	100	42	-	1
D54(138)	96	42	-	5
D65(141)	100	41	-	2
D64(141)	106	33	2	2
D75(136)	86	49	1	7
D74(136)	75	61	-	7
D85(137)	84	53	-	6
D84(137)	91	46	-	6

Gjendja e dhëmbëve: 0=i shëndetshëm; 1=i prishur; 2=i mbushur; 3=mungon.

Tabela 5. Gjendja e 8 molarëve të qumështit te 8 vjeçarët

nr	Nr (%)			
	0	1	2	3
D55(151)	96	55	-	6
D54(155)	111	42	2	9
D65(153)	92	61	-	4
D64(148)	104	44	-	9
D75(131)	64	66	1	26
D74(136)	80	56	-	21
D85(138)	74	64	-	19
D84(133)	76	57	-	24

Gjendja e dhëmbëve: 0=i shëndetshëm; 1=i prishur; 2=imbushur; 3=mungon.

Tabela 6. Gjendja e 8 molarëve të qumështit te 9 vjeçarët

nr	Nr (%)			
	0	1	2	3
D55(113)	77	35	1	7
D54(113)	94	19	-	7
D65(115)	87	28	-	5
D64(113)	94	19	-	7
D75(103)	65	36	2	17
D74(108)	74	33	1	12
D85(104)	64	39	1	16
D84(107)	78	29	-	13

Gjendja e dhëmbëve: 0=i shëndetshëm; 1=i prishur; 2=i mbushur; 3=mungon.

Tabela 7. Gjendja e 8 molarëve të qumështit te 10 vjeçarët

nr	Nr (%)			
	0	1	2	3
D55(159)	130	18	11	6
D54(162)	145	14	3	3
D65(161)	112	44	5	4
D64(161)	143	15	3	4
D75(149)	118	28	3	16
D74(155)	140	13	2	10
D85(148)	111	33	4	17
D84(156)	133	22	1	9

Gjendja e dhëmbëve: 0=i shëndetshëm; 1=i prishur; 2=i mbushur; 3=mungon.

DISKUTIME

Ky studim, ndër të tjera përcakton frekuencën e kariesit në fëmijët e moshës 7-10 vjeç në qarkun e Durrësit, Shqipëri. Prevalenca e kariesit rezultoi të ishte 92.1%. Prania e kariesit të dhëmbëve te fëmijët e kësaj grup-moshe analizohet me anë të vlerave të mesatares së *dmft* dhe *DMFT* të cilat përkatësisht rezultuan të ishin 3.4 dhe 1.04. Indeksi i kariesit për dhëmbët e qumështit ishte $SiC=6.6$. Për dhëmbët e përhershëm ky indeks rezultoi të ishte $SiC=2.6$.

Një nga shkaqet për nivelin e lartë të shfaqjes së kariesit u vlerësua mungesa e florizimit të ujit të pijshëm. Arsye të tjera mund të jenë praktikat e gabuara në ushqyerje dhe praktikat e gabuara dhe të varfra në ruajtjen e higjenes së gojës.

Edhe pse kariesi është studiuar gjersësisht, është bërë shumë pak në lidhje me studimin e korelacionit të kësaj sëmundjeje të dhëmbëve me denticionin e përzier, veçanërisht për fëmijët në Shqipëri. Ka qenë shumë e vështirë të gjendeshin studime të ngjashme për këtë grup-moshë, prandaj dhe është e vështirë që të bëhen krahasime për përfundimet arritura në këtë studim, me studime paraardhëse.

Në përgjithësi, studimet e kryera në vende të tjera tregojnë se kariesi në denticionin e përzier është në nivele më të larta se kariesi në grup-moshat 6 dhe 12 vjeç [6,8]. Shkaku i kësaj gjendjeje ndoshta ka lidhje me faktin se këto studime paraqesin nivelin e kariesit për moshën 6 dhe 12 vjeç duke u fokusuar veçanërisht ose për dhëmbët e qumështit ose për dhëmbët e përhershëm. Sidoqoftë, në denticionin e përzier, dhëmbët e qumështit që janë në gojë kanë tendencë për tu kariuar për shkak të natyrës grumbulluese të sëmundjes, ndërsa dhëmbët e përhershëm që sapo dalin kanë një rrezik të madh për tu prekur nga kariesi gjatë kësaj periudhe. Dhëmbët e rinj të sapo dale, dihet që kanë përqendrime më të larta të karbonateve në smaltin e tyre, duke shkaktuar ndryshime në rrjetën kristalore të hidroksiapatitit, duke bërë që sipërfaqja e smaltit të jetë më acide [14]. Përveç kësaj, dhëmbët gjatë daljes nuk kanë një kontakt funksional në okluzion, duke rritur mundësinë për grumbullime ushqimore në ta dhe duke penguar larjen e tyre [14].

Prania e kariesit në molarët e qumështit është parë se përshejton daljen e premolarëve me 2-8 muaj [15]. Këto faktorë ndihmojnë për të shpjeguar shkaqet e shfaqjes së parakohshme të kariesit te premolarët si dhe praninë e kariesit në premolarët dhe molarët e sapodalë te fëmijët e përfshirë në këtë studim.

Nivelet e larta të kariesit në molarët e parë të përhershëm mund të ndikohen gjithashtu edhe nga disa faktorë të tjerë shtesë, si p.sh. pozicionimi i dhëmbit në pjesën e fundit të gojës gjatë periudhës së denticionit miks, zhërvjellësia e pamjaftueshme e fëmijës në këtë moshë për larjen e rregullt të dhëmbëve në kohën kur këta dhëmbë dalin, dhe të paturit e gropëzave dhe fisurave më të thella në krahasim me dhëmbët e qumështit.

Një shqetesim i madh i prevalencës së lartë të kariesit në denticionin miks mendohet të jetë edhe risku i lartë për karies në dhëmbët e përhershëm. Është vënë re se fëmijët me *DMFT* dhe *dmft* ≥ 0 ishin më të prirur për karies në dhëmbët e përhershëm, krahasuar me fëmijët pa karies në të dyja denticionet [14]

KONKLUZIONE

Edhe pse problemet e kariesit të dhëmbëve nuk rrezikojnë jetën, ato shmangen me trajtime të kushtueshme.

Studimet e prevalencës së kariesit të komunitetit janë të dobishme për planifikuesit e kujdesit të shëndetit për të identifikuar burimet e nevojshme për shërbimet dentare në komunitet dhe për të ofruar shërbime parandaluese dhe kurative për shëndetin e dhëmbëve. Për më tepër, studimet kanë dëshmuar se kariesi i dhëmbëve ndikon në frekuencimin e shkollës dhe shkakton shtimin e ditëve me aktivitet të kufizuar [1]. Shumë autorë theksin e vënë në planifikimin e programve promocional për shëndetin e gojës nëpër shkolla që në periudhën e denticionit të përzier.

REFERENCA

- Almas K, Afzal M, Fauzi Z. Prevalence of dental caries in Al Qassem region Saudi Arabia. *PODJ* 93; 13: 19-27.
- Birkeland JM, Haugejorden O, von der Fehr FR. Analyses of the caries decline and incidence among Norwegian Adolescents 1985-2000. *Acta Odontol Scand* 2002; 60:281-9
- Casamassimo PS, Thirkkurissy S, Edelstein BL, Maiorini E (2009). Beyond the dmft: the human and economic cost of early childhood caries. *J Am Dent Assoc*, 140 (6): 650-657.
- Casanova-Rosaldo AJ, Medina-Solis CE, Casanova - Rosaldo JF, Vallejos-Sanchez AA, Maupome G, Avila-Burgos L. Dental caries and associated factors in Mexican schoolchildren aged 6-13 years. *Acta Odontol Scand* 2005; 63:247-51.
- Chu CH, Fung DSH, Lo ECM. Dental caries status of preschool children in Hong Kong. *Br Dent J* 1999; 187:616-20
- Dye BA, Arevalo O, Vargas CM (2010). Trends in pediatric dental caries by poverty status in the United State, 1988-1994 and 1999-2004. *Int J Pediatr Dent*, 20(2):132-143.
- Gonçalves Leite I, Almeida-Ribero R. Dental caries in the primary dentition in public nursery school children in Juiz De Fora, Minas Gerais, Brazil. *Cad Saude Publica* 2000;16:717-22.
- Gonçalves Leite I, Almeida-Ribero R. Dental caries in the primary dentition in public nursery school children in Juiz De Fora, Minas Gerais, Brazil. *Cad Saude Publica* 2000;16:717-22.
- Gratrix D, Holloway PJ. Factors of deprivation associated with dental caries in young children. *Community Dent Health* 1994; 11:66-70.
- Hallett KB, O'Rourke PK. Dental caries experience of preschool children from the North Brisbane region. *Aust Dent J* 2002; 47:331-8.
- Helminen SKJ, Vehkalahti MM. Does caries prevention correspond to caries status and orthodontic care in 0-18-year-olds in the free public dental service? *Acta Odontol Scand* 2003; 61: 29-33.
- Herrera MS, Medina-Solis CE, Rosaldo-Vila G, Minaya-Sanchez M, Vallejos-Sanchez AA, Casanova-Rosaldo JF. Prevalence of a suburban community of Campeche-2001.
- Irigoyen ME, Maupome G, Mejia AM. Caries experience and treatment needs in a 6-to 12-year-old urban population in relation to socio-economic status. *Community Dent Health* 1999; 16:245-9.
- Kassawara AB, Tagliaferro EP, Cortelazzi KL, Ambrosano GM, Assaf AV, Meneghim Mde C, Pereira AC (2010). Epidemiological assessment of predictors of caries increment in the 7-10-year-olds: a 2-year cohort study. *J Appl Oral Sci*, 18(2):116-120.
- Leroy R, Bogaerts K, Lesaffre E, Declereck D (2003). Impact of caries experience in the deciduous molars on the emergence of the successors. *Eur J Oral Sci*, 111 (2):106-110.
- Maqbool G. Prevalence of dental caries in school children in Al-Khobar, Saudi Arabia. *J dent Child* 1992; 59:385-86.
- Maupome G, Borges YA, Ledesma MC, Herrera ER, Leyva HE, Navarro AA. The prevalence of caries in marginal rural and peripheral urban areas. *Salud Publica Mex* 1993; 35:357-67.
- Maupome G, Clark DC, Levy S. M, Berkowitz J. Patterns of dental caries following the cessation of water fluoridation. *Community Dent Oral Epidemiol* 2001; 29:37-47.
- Milgrom P, Riedy CA, Weinstein P, Tanner AC, Manibusan L, Bruss J. Dental caries and its relationship to bacterial infection, hypoplasia, diet, and oral hygiene in 6- to 36-month-old children. *Community Dent Oral Epidemiol* 2000; 28:295-306.
- Nieto-Garcia VM, Nieto-Garcia MA, Lacalle-Remigio JR, Abdel-Kader-Martin L. Oral health of schoolchildren in Ceuta. Influences of age, sex, ethnic background and socioeconomic level. *Rev Esp Salud Publica* 2001; 75:541-50.

21. Peterson PE, Hoerup N, Poomviset N, Prommajan J, Watanapa A. Oral health status and oral health behaviour of urban and rural schoolchildren in Southern Thailand. *Int Dent J* 2001; 51:95-102.
22. Sanchez-Perez L. Dental caries in southern DF. *Pract Odontol* 1987; 8:25-30.
23. Sheiham A. Changing trend in dental caries. *Int J Epidemiol* 1984; 13:142-47.
24. Vanobbergen J, Martens L, Lesaffre E, Bogaerts K, Declerck D. Assessing risk indicators for dental caries in the primary dentition. *Community Dent Oral Epidemiol* 2001; 29:424-34.

THE PROGRESS OF DENTAL CARIES IN THE MIXED DENTITION OF 7-10-YEAR-OLD CHILDREN IN DURRES DISTRICT, ALBANIA

Fiorda Mezini

Dentistry specialist in Durrës Health Center Lecturer at Planetar University of Tirana

Abstract

Dental caries is a major oral health problem. However, studies on this dental disease, and in particular in relation to mixed dentition in children, are somewhat limited in number.

The aim of this study is to determine the level of dental caries in 7-10-year-old children in Durrës district.

Dental caries was assessed according to WHO criteria (1997) using the dmft index for milk teeth and DMFT index for permanent teeth, where d / D indicates the number of broken teeth, m / M indicates the number of missing teeth due to caries; f / F indicates the number of filled teeth, and t / T = teeth.

The study showed that dmft for 7-8-9-10-year-old children was respectively 3.7, 4.3, 3.6, 2.1, whereas DMFT for the same sample of children was respectively 0.48, 4.3, 3.6 and 1.7.

The presence of caries in the examined sample of children resulted to be very high. The caries was present even in the new permanent teeth. The prevalence of caries was 92.1%. It seems that the high prevalence of caries in temporary teeth is a factor that increases the risk for dental caries in permanent teeth.

Key words: dental caries, mix dentition, prevalence, dmft, DMFT.

DIAGNOZA SEROLOGJIKE DHE EPIDEMIOLOGJIA E SIFILIZIT

Dhurata Torba¹, Mirela Lika² (Çekani), Zhaneta Abazaj³, Silva Bino¹, Shpëtim Qyra¹

¹ Departamenti i sëmundjeve infektive, Instituti i Shëndetit Publik Tiranë, Shqipëri

² Departamenti i biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës Tiranë, Shqipëri

³ Qendra Kombëtare e Konservimit të Gjakut Tiranë, Shqipëri

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 55-60

ABSTRAKT

Sifilizi është një sëmundje seksualisht e transmetueshme e cila shkaktohet nga bakteri *Treponema pallidum*. Tjetër rrugë transmetimi është marrja e gjakut të infektuar dhe rruga verikale, nga nëna tek feta, kur nëna është e infektuar me këtë sëmundje. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i incidencës, i grup moshës më të ekspozuar ndaj sëmundjes, i shpërndarjes së sëmundjes në Shqipëri, i sensibilitetit dhe specificitetit të metodave diagnostikuese dhe krahasimi i këtyre të dhënave me studimet e mëparshme. Ky është një studim prospektiv, unicentrik, i realizuar në Institutin e Shëndetit Publik Tiranë, në periudhën kohore një vjeçare (1 prill 2011 deri në 1 maj 2012). Kemi ekzaminuar serumet e personave vullnetarë, serumet e pacientëve nga Shërbimi i Sëmundjeve Infektive në QSUT "Nënë Tereza", dhe rastet për konfirmim nga Qendra Kombëtare e Dhurimit të Gjakut Tiranë. Për vënien e diagnozës kemi përdorur reaksionet serologjike Rapid plasma reagin (RPR) dhe *Treponema pallidum* haemagglutination assay (TPHA). Analiza e të dhënave është bërë me metodën statistikore SPSS 20, testin χ^2 dhe one way ANOVA. Konkluzione. Gjatë periudhës një vjeçare kemi patur 59 raste të reja me sifiliz. Grup moshë 25-34 vjeç ka qënë më e ekspozuar ndaj Sifilizit. Kanë mbizotëruar rastet pozitive në rrethin e Tiranës. Në studimin tonë RPR ka patur sensibilitet 77% dhe specificitet 85% dhe TPHA ka patur sensibilitet 99% dhe specificitet 98%.

Fjalë kyç: *Treponema pallidum*, sifilis, RPR, TPHA, bakter

HYRJE

Sifilizi është sëmundje seksualisht e transmetueshme dhe shkaktohet nga spiroketa *Treponema pallidum*. Është një infeksion që prek vetëm njeriun. Rruga e transmetimit është kryesisht ajo seksuale. Ai kalon në dy stadi: Sifilizi recent (ngjitës) dhe sifilizi tardiv (jo ngjitës). Në stadin recent futet periudha e inkubacionit, stadi primar, stadi sekundar dhe stadi i sifilizit latent. Në sifilizin tardiv futen gjëndjet e vonuara të sifilizit latent dhe komplikacionet e rënda të sëmundjes. Incidenca e sifilizit varion në vartësi të faktorëve social, ekonomik, kulturës mjekësore mbi infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe traditës së vendeve. Në SHBA, në vitin 2010 incidenca e sifilizit ishte 7.9 raste për 100000 burra dhe 1.1 raste për 100000 gra. Edhe pse shumica e rasteve me sifiliz është parë mes homoseksualeve edhe mes bashkëshortëve vazhdon të jetë problem. (1) Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton 12 milionë raste të reja të sifilizit çdo vit. (2) Në shumë vende të Evropës Lindore rastet me sifiliz janë ende dukshëm më lartë sesa në Evropën Perëndimore. (3) Incidenca e sifilizit për 100.000 banorë për vendet e rajonit është raportuar: Bullgari (2009) 5.5 raste, Rumani (2007) 25.71 raste, Slloveni (2009) 2.3 raste, Turqi (2000)

4.95 raste. (4) Nga viti 1973 deri në 1995 në Shqipëri nuk është raportuar asnjë rast me sifiliz. Nga viti 1995 numri i rasteve ka qënë gjithnjë në rritje.

Tabela 1. Incidenca e Sifilizit në Shqipëri sipas viteve

Vite	Raste	Përqindje
1995	3	1.18%
1996	3	1.18%
1997	15	5.9%
1998	34	13.4%
1999	22	8.69%
2000	14	5.53%
2001	19	7.50%
2002	6	2.37%
2003	5	1.97%
2004	6	2.37%
2005	14	5.53%
2006	12	4.74%
2007	34	13.4%
2008	11	4.34%
2009	29	11.4%
2010	26	10.2%

Kjo sëmundje kalon nëpër disa faza të cilat kanë karakteristika të ndryshme klinike. Në 95% të rasteve infeksioni transmetohet me rrugë seksuale, nëpërmjet membranave mukoze ose gërvishtjeve shumë të vogla të lekurës. Rrugë tjetër transmetimi është nëpërmjet transfuzionit të gjakut, si dhe nga nëna e sëmurë tek fetausi dhe shpesh shkakton dështim, vdekje fetale, neonatale ose pasoja të rënda të tilla si: verbëri dhe shurdhësi, zhvillim mendor të vonuar. (5) Treponemat janë të shumta në erozionet e mukozave genitale, anale dhe bukale. Treponema pallidum është bakter i gjatë, i hollë dhe i përdredhur në formë spirale me gjërësi 0.2 mikron dhe gjatësi 5-15 mikron që lëviz në formë spiraleje. (6) Fig 1, 2



Fig. 1. Spiroketa Treponema Pallidum




Fig. 2. Prerja transversal e spiroketës

Treponema pallidum qëndron i gjallë në mjedisin e jashtëm për një kohë relativisht të shkurtër. Ngordh shpejt në thatësi, nxehtësi, në dritën e diellit dhe ujë. Në

temperaturë 41°C ngordh për një orë. (7) Mbetet i gjallë për 24 orë në gjakun e mbajtur në 4 °C. Treponema pallidum jeton më shumë në përqëndrime të ulëta të oksigjenit. (8) Treponema është e ndjeshme ndaj çdo dezinfektuesi. Tradicionalisht, metodat diagnostike janë ndarë në metodat e zbulimit të drejtpërdrejtë (imunofluoreshenca direkte, ekzaminimi mikroskopik me fushë të errët, inokulimi në kafshë) dhe ato serologjike për përcaktimin e pranisë së antitropave kundër Treponema pallidum. Metodat serologjike janë të ndarë në: teste jotreponematoze, Rapid plasma reagin (RPR) dhe teste treponematoze: Treponema pallidum haemagglutination assay (TPHA) dhe immunofluoreshenca indirekte (Fta-abs test). (9) Sifilizi është i shërueshëm me antibiotikë standartë. (10)

MATERIALI DHE METODAT

Ky punim është kryer në periudhën kohore 1Prill 2011 deri 1 Maj 2012 dhe është realizuar në Departamentin e sëmundjeve infektive, Instituti i Shëndetit Publik Tiranë, Shqipëri. Kemi ekzaminuar 336 serume, të marra nga personat vullnetarë, nga Qendra Kombëtare e Dhurimit të Gjakut dhe Shërbimi i sëmundjeve infektive në QSUT “Nënë Tereza”. Kemi përdorur reaksionet serologjike RPR dhe TPHA për venien e diagnosis. Fig 3, 4




Fig. 3. Teknika e reaksionit RPR (Rapid Plasma Reagin)




Fig. 4. Teknika e reaksionit TPHA (T. pallidum Haemagglutination Assay)

RPR është konsideruar pozitiv në aglutinim latex në titër antitropash >1:2 (11)

TPHA është konsideruar pozitiv në titër antitropash > 1:100 (12)

Analiza e të dhënave u bë me metodën statistikore SPSS 20. Është përdorur testi χ^2 për krahasimin e proporcioneve ndërmjet variablave kategorikë. One way ANOVA është përdorur për krahasimin e variablit të vazhduar “moshë” sipas kategorive. Intervali konfidencës është pranuar 95% dhe niveli i sinjifikancës $\alpha < 0.05$.

REZULTATI

Mosha mesatare e personave të ekzaminuar ka qënë 34.8 vjeç (SD ± 12.0), duke variuar nga 15 deri në 68 vjeç.




Fig. 5. Shpërndarja e sifilizit sipas grup-moshave




Fig. 6. Moshë e seropozitivëve Meshkuj-Femra

Shpërndarja e seropozitivëve sipas gjinisë ka qënë: 48 raste ose 81.4% meshkuj dhe 11 raste ose 18.6% femra. Moshë mesatare e meshkujve të cilët kanë rezultuar pozitivë ishte 38.1 vjeç (SD ± 11.1) ndërsa moshë mesatare

e femrave pozitivë ishte 35.1 vjeç (SD ± 10.4), shihet ndryshim statistikisht i rëndësishëm ndërmjet tyre ($t = 0.8$ $p = 0.4$) Meshkujt kanë 1.2 herë më tepër gjasa sesa femrat për të rezultuar pozitivë por pa ndryshim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet tyre (OR=1.2, 95% CI: 0.6 - 2.5 $p = 0.5$).

Shihet mbizotërim të rasteve pozitivë tek meshkujt, me ndryshim statistikisht të rëndësishëm në raport me femrat $p < 0.01$.

Tabela 2. Rezultatet sipas grupmoshës


Grupmosha	Pozitivë	Negativë	OR	95% CI	P
15-24	5	72	-	-	-
25-34	25	84	4.2	1.5-11.7	< 0.01
35-44	12	60	2.8	0.9-8.6	0.06
45-54	12	42	4.1	1.3-12.4	0.01
55-64	4	17	3.4	0.8-13.9	0.09
>65	1	2	7.2	0.5-93.6	0.1

Grupmosha 25-34 vjeç ka 4.2 herë më tepër gjasa që të rezultojë pozitivë krahasuar me grupmoshën 15-24 vjeç, me ndryshim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet tyre (OR=4.2 95%CI 1.5 - 11.7 $p < 0.01$).

Grupmosha 45-54 vjeç ka 4.1 herë më tepër gjasa që të rezultojë pozitivë krahasuar me grupmoshën 15-24 vjeç me ndryshim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet tyre (OR=4.1 95%CI 1.3 - 12.4 $p < 0.01$).

Tabela 3. Seropozitivët sipas grupeve të ekzaminuara

Grupe të ekzaminuara	Pozitivë	Negativë	OR	95% CI	P
Vullnetarët	13	144	-	-	-
Qendra Kombëtare e Dhurimit të Gjakut	22	68	3.6	1.7-7.8	< 0.001
Shërbimi i Sëmundjeve Infektive QSUT	24	65	4.3	2.1-8.9	< 0.001



Rrethe	Raste	%
Kukësi	1	1.69
Shkodra	2	3.38
Durrësi	3	5.07
Tirana	38	64.22
Elbasani	5	8.45
Fieri	2	3.38
Korca	5	8.45
Vlora	2	3.38
Gjirokastra	1	1.69

Fig. 7. Shpërndarja e rasteve pozitivë sipas rretheve

Vërehet mbizotërim i rasteve pozitivë në rrethin e Tiranës me ndryshim statistikiqisht të rëndësishëm me rrethet e tjera, $p < 0.01$.




Fig 8. Përqindja e rasteve pozitivë dhe negative

Nga 336 serume të ekzaminuara, 59 persona ose 17.6% serume rezultuan pozitivë.




Fig 9. Përqindjet e rasteve pozitivë me RPR dhe TPHA

Ne kemi përdorur dy metoda diagnostikuese. Fillimisht kemi bërë testimin me RPR. Me këtë test kanë rezultuar pozitivë 45 raste ose 77% të rasteve pozitivë. Rezultatet tona tregojnë që sensibilitet i RPR ka qënë 77% dhe specificitet 86%. Të gjitha serumet janë testuar edhe me testin TPHA dhe kanë rezultuar pozitivë 59 raste ose 17.6% e të gjitha serumeve të testuara.

DISKUTIMI

Sifilizi është një sëmundje që haset në të gjitha moshat. Në studimin tonë sifilizi është hasur nga moshë 15 deri në moshën 65 vjeç. Moshë mesatare ka qënë 33 vjeç. Duke krahasuar të dhënat e dalë nga studimi ynë me studimin e kryer nga Torba Dh & Lika M, 2005-2006, ne mund të themi që rezultatet janë relativisht jo të ndryshme. Shihet mbizotërim i rasteve pozitivë tek meshkujt. Grupmosha 25-34 vjeç ka qënë grup moshë me e ekspozuar ndaj sëmundjes. Kjo është e lidhur me riskun e shtuar të kësaj grup moshë për të qënë më të ekspozuar ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.

Serumet e personave të ekzaminuar nga Qendra Kombëtare e Dhurimit të Gjakut kanë rezultuar pozitiv në 24%. Ky grup ka 3.6 herë më tepër gjasa që të rezultojë pozitivë krahasuar me vullnetarët. Shihet ndryshim statistikiqisht i rëndësishëm ndërmjet tyre (OR=3.6 95%CI 1.7 - 7.8 $p < 0.001$).

Serumet e personave të ekzaminuar nga Spitali Infektiv kanë rezultuar pozitiv në 27%. Ky grup ka 4.3 herë më tepër gjasa që të rezultojë pozitivë krahasuar me vullnetarët me ndryshim statistikiqisht të rëndësishëm ndërmjet tyre (OR=4.3 95%CI 2.1 - 8.9 $p < 0.001$).

Sigurisht që ishte e pritshme kjo tendencë, sepse nga Qendra Kombëtare e Dhurimit të Gjakut serumet kanë ardhur për tu konfirmuar për sifiliz tek ne, si qendër reference. Ndërsa serumet për ekzaminim nga Shërbimi i Sëmundjeve Infektive në QSUT i përkasin personave të sëmurë, në rastin e të cilëve duhet të konfirmohet ose të përjashtohet pozitiviteti për sifiliz.

Duke analizuar seropozitivët sipas grupeve të ekzaminuara vërehet që numri më i vogël i individëve pozitivë me 13 raste ose 22% e totalit prej 59 individëve pozitivë i përkasin grupit të vullnetarëve me diferencë statistikisht të rëndësishme me dy kategoritë e tjera ($\chi^2=17.7$ $p<0.01$).

Në studimin tonë numrin më të madh të rasteve me sifiliz e kemi hasur në qytetin e Tiranës. Ky rezultat është i justifikueshëm, sepse në Tiranë jeton thuajse gjysma e popullsisë së Shqipërisë.

TPHA ka patur sensibilitet 99%, dhe specificitet 98% në diagnozë. Vetëm një rast ose 1.7% ka rezultuar fallso pozitivë me RPR dhe negativë me TPHA.

Të dhënat e mësipërme janë të ngjashme dhe me studimet e realizuara më parë nga Papajorgji M & Lika M, 2001, si dhe Torba Dh & Lika M, 2005-2006, ku pozitiviteti ka qenë respektivisht 18% dhe 19.4 %, por theksojmë se numri i të diagnostikuarve ka qenë shumë më i madh.

Autorë të ndryshëm nga vende të ndryshme raportojnë sensibilitet të RPR që varion 58.8%, 69.7%, 78%, 92.3% dhe specificitet 33.3 %, 96.5%, 99%, 99% . (13, 14, 15, 16) Po këta autorë raportojnë sensibilitet të TPHA që varion 100.0 %, 95% dhe specificitet 66.7%, 99%. (13, 15)

Rezultatet tona tregojnë që sensibiliteti i RPR ka qënë 77% dhe specificitet 86%. Ky reaksion, i cili është jotreponematoz, ka fallso-pozitivitet për disa sëmundje autoimune si Lupus eritemadotes, apo në persona me faktor pozitiviteti reumatik, apo dhe në shumë sëmundje të tjera infektive si: leptospirozë, leprozë, tuberkuloz, rikeciozë, malarie dhe sëmundja e quajtur Lyma.

KONKLUZIONE

Gjatë periudhës një vjecare kemi shtim të rasteve të reja me sifiliz. Grup moshë 25-34 vjeç ka qënë më e ekspozuar ndaj sëmundjes së Sifilizit. Kanë mbizotëruar rastet pozitivë në rrethin e Tiranës. Në studimin tonë RPR ka patur sensibilitet 77% dhe specificitet 85% dhe TPHA ka patur sensibilitet 99% dhe specificitet 98%.

Diagnoza serologjike e sifilizit vetëm me një test është e pamjaftueshme, konfirmimi i saj duhet të bëhet të paktën me dy teste.

LITERATURA

- Centers for Disease Control and Prevention. Primary and secondary syphilis – Jefferson County, Alabama, 2002–2007. MMWR Morb Mortal Wkly Rep. 2009; 58:463-7.
- Gerbase, A. C., J. T. Rowley, D. H. Heymann, S. F. Berkley, and P. Piot. 1998. Global prevalence and incidence estimates of selected curable STDs. Sex. Transm. Infect. 74(Suppl.1):S12-S16.
- Uusküla A, Puur A, Toompere K, DeHovitz J. Trends in the epidemiology of bacterial sexually transmitted infections in eastern Europe, 1995-2005. Sex Transm Infect. 2010 Feb; 86(1):6-14.
- Liam J. Herbert and Stephen I. Middleton. An estimate of syphilis incidence in Eastern Europe. J Glob Health. 2012 June; 2(1): 010402. doi: 10.7189/jogh.02.010402.
- Schmid GP, Stoner BP, Hawkes S, et al. The need and plan for global elimination of congenital syphilis. Sex Transm Dis 2007; 34: S5-S10.
- Goldstein, S. F., and N. W. Charon. 1990. Multiple-exposure photographic analysis of a motile spirochete. Proc. Natl. Acad. Sci. USA 87:4895-4899
- Fieldsteel, A. H., D. L. Cox, and R. A. Moeckli. 1981. Cultivation of virulent *Treponema pallidum* in tissue culture. Infect. Immun. 32:908-915
- Fraser, C. M., S. J. Norris, G. M. Weinstock, et al. Complete genome sequence of *Treponema pallidum*, the syphilis spirochete. 1998. Science 281:375-388.
- S A Larsen, B M Steiner and A H Rudolph. Laboratory diagnosis and interpretation of tests for syphilis. Clin. Microbiol. Rev. 1995, 8(1):1.
- Donovan B, Dayan L. Syphilis. In: Warrell DA, Cox TM, Firth JD, editors. Oxford textbook of medicine. Oxford: Oxford University Press, 2010: 885-896.
- Reyes MP, Hunt N, Ostrea EM Jr, George D. Maternal/congenital syphilis in a large tertiary-care urban hospital. Clin Infect Dis. 1993 Dec; 17(6):1041-6.
- Mahalakshmi. B, Therese Lily. K, Devipriya. U, Pushpalatha. V, Margarita. S & Madhavan. H.N. Infectious aetiology of congenital cataract based on torchestorches screening in a tertiary eye hospital in Chennai, Tamil Nadu, India. Indian J Med Res 131, April 2010, pp 559-564

13. Ozolins. D, Katkovska. S, Bobojeda. L, Rancane. A. Screening Assays to find out Late Latent Syphilis Cases – Which is the best one? Internet Journal of Medical Update 2009 July;4(2):29-35
14. Van Dyck E, Van de Velden L, Ndoye I, Piot P, Meheus A. Evaluation of the rapid plasma reagin “teardrop” card test for screening of syphilis in field conditions. Sex Transm Dis. 1993 Jul-Aug; 20(4):194-7.
15. Wiwanitkit. V. A cost-utility analysis of Treponema pallidum haemagglutination (TPHA) testing for syphilis screening of blood donors: is the TPHA test useful for syphilis screening in a blood centre? Blood Transfus. 2009 January; 7(1): 65–66.
16. Perryman. M W, Larsen. S A, Hambie. E A, Pettit. D E, Mullally. R L, Whittington.W. Evaluation of a new rapid plasma reagin card test as a screening test for syphilis. J. Clin. Microbiol. August 1982 vol. 16 no. 2 286-290

SEROLOGICAL DIAGNOSIS AND EPIDEMIOLOGY OF SYPHILIS

Dhurata Torba ¹, Mirela Lika² (Çekani), Zhaneta Abazaj³, Silva Bino¹, Shpëtim Qyra¹

¹ Department of infectious diseases, Institute of Public Health Tirana, Albania

² Department of Biology, Faculty of Natural Science, University of Tirana, Albania

³ National Centre of Blood Conservation Tirana, Albania

SUMMARY

Syphilis is a sexually transmitted disease which is caused by the bacterium *Treponema pallidum*. Another way that syphilis can be transmitted is by getting infected blood and vertical way, from mother to fetus when the mother is infected with the disease. The purpose of this study is to evaluate: the incidence, the age group most exposed to this disease, the distribution of the disease in Albania, the sensitivity and specificity of diagnostic methods and the comparison of these data with previous studies. This is a prospective study, unicentric, that was conducted in the Institute of Public Health, Tirana, in the time frame of one year (1 April 2011 to 1 May 2012). We have examined sera of volunteers, sera of patients from the Service of Infections Disease in the University Hospital Center “Mother Theresa”, and cases for confirmation from National Blood Donor Center, Tirana. To determine the diagnosis, we have used serological reactions the Rapid plasma reagin (RPR) and *Treponema pallidum* haemagglutination assay (TPHA). Data analysis were performed with SPSS 20 statistical method, chi-square test (χ^2) and one-way analysis of variance (ANOVA). Conclusions. During the period of one year, there were 59 new cases of syphilis. The 25-34 year age group was the most exposed to syphilis. Cases with positive syphilis was predominantly in Tirana city. The RPR used in our study had a sensitivity of 77% and a specificity of 85% and the TPHA had a sensitivity of 100% and a specificity of 99%.

Key words: *Treponema pallidum*, syphilis, RPR, TPHA, bacteria.

SURVEJANCA BIOLOGJIKE E AGJENTËVE INFEKTIVE TEK INDIVIDËT E POLITRANSFUZUAR NË SHQIPËRI

Eugena Tomini¹, Silva Bino¹, Artan Simaku¹, Mimoza Basho¹, Shpëtim Qyra¹

¹Instituti Shëndetit Publik, Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive.

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 61-65

REZYME

Kontrolli i gjakut për HIV dhe të agjentëve të tjerë infektivë në Shqipëri është i detyrueshëm me ligj kushtetues. Individët që marrin transfuzion të shumta, si dhe grupeve tjera të rrezikuara janë kontrolluar në mënyrë rutinore për praninë e agjentëve infektivë. Qëllimi: Për të vlerësuar përhapjen agjentëve infektivë në individët që politransfuzionohen. Metoda: mostrat janë mbledhur nga pacientët që marrin transfuzion të shumta në njësitë e hemodialises dhe oncohematologji, talasodrepanocitare në disa rrethe të vendit gjatë periudhës 2006-2008. Mostrat janë testuar për HbsAg, HCV dhe HIV. Eshtë përdorur metoda e ELISA. Rezultatet: 118 (32.4%) e mostrave janë pozitive, nga një total prej 364 mostrave (95% CI 27,8-37,4) $p < 0.001$. 2 (0.5%) raste janë infektuar me HIV, 27 (7.4%) raste me HBsAg, 89 raste (24.5%) me HCV. Përsa i përket HBsAg, 17 (63%) prej tyre ishin meshkuj dhe 10 (37%) femra. OR (meshkuj / femra) = 1.3 (95% CI 0.5-3.1) $p = 0.6$. Më e prekur grupmosha 25-44 vjeç, me 9 (33.3%) raste dhe 45 - 65 vjeç me 12 (44.4%) raste. Me HCV, më e prekur grupmosha e re aktive 15-25 vjeç me 27 (30%) raste, grupmosha 25-45 vjeç me 21 (24%) raste dhe grupmosha 5-15 vjeç dhe 45-65 vjeç me 9 (10%) raste respektivisht. Përfundime: Survejanca nga viti 2006 ka përfshirë individë që marrin transfuzione të shumta prej shume vitesh. Rastet HIV, janë konfirmuar në pacientët pediatrik para zbatimit të survejancës në vitin 2006. Nuk u gjet ko-infeksioni me HCV. Në gjashtë raste është gjetur co-infeksion HBsAg + HCV.

Fjalë kyce: Politransfuzuar, agjente infektiv, muster gjaku, transfuzion.

HYRJE

Parandalimi i përhapjes së agjentëve infeksioz tek të politransfuzuarit dhe indirekt vlerësimi i sigurisë së gjakut, ka një rëndësi të veçantë në Shëndet Publik. Kontrolli i gjakut për HIV dhe agjentë të tjerë infektivë rregullohet me ligjin nr. 8689 "Për parandalimin e përhapjes së infeksionit të HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë" (1). Sipas ligjit çdo njësi gjaku e dhuruar në Shqipëri kontrollohet për praninë e agjentëve infektivë që transmetohen nëpërmjet tij si HIV, Hepatit B dhe C, CMV dhe Sifiliz (2). Një numër i konsiderueshëm i dhuruesve me pagesë i përket grupeve vulnerabël ose atyre veçanërisht vulnerabël (popullsia Rome, përdoruesit e drogës, migrantët nga zonat rurale në ato urbane), kështu që ndërgjegjësimi për vetë-përrjashtim është i ulët (3, 4, 5). Proçesi i garantimit të sigurisë së gjakut kalon nëpër stadet e mëposhtme: vetë-përrjashtimi i dhuruesit, përrjashtimi gjatë intervistës me stafin e bankës së gjakut, përrjashtimi në rast se testi rezulton pozitiv ose i

papërcaktuar (6, 7, 8, 9). Personat e politransfuzuar janë ata që jetën e tyre e kanë të lidhur me transfuzione ritmike të herë pas hershme dhe që rreziku për kontaminim me agjentët infeksioz që transmetohen nëpërmjet gjakut është i lartë (10, 11, 12, 13).

Sipas OBSH (14,15,16) duke iu referuar te dhënave në lidhje me sigurinë e gjakut, grumbullimi Global i tij përcaktohet me rreth 92 milionë donacione çdo vit nga të gjitha mënyrat e dhuruesve të gjakut (të papaguara vullnetare, familja / zëvendësues dhe të paguara). Përafërsisht gjysma e këtyre donacioneve të gjakut janë mbledhur në vendet me të ardhura të larta, për 15% të popullsisë së botës.

Donacionet vullnetarë të gjakut, në 62 vende të botës, mbulojnë rreth 100%, ose pothuajse më shumë se 99% dhurimet vullnetare të gjakut pa pagesë.(17). Dyzetë vende mbledhin më pak se 25% të furnizimit të tyre të gjakut nga donatorët vullnetar të gjakut pa pagesë. Megjithatë orjentimi nga (WHO) Organizata Botërore e Shëndetësisë është për të gjitha vendet, për të marrë

të gjitha furnizimet e gjakut nga donatorët vullnetarë të papaguar deri në vitin 2020.

Rreth 8 000 qendra të gjakut në 159 vende raportojnë për grumbullimet e tyre të gjakut.(18). Mbledhja mesatare vjetore për një qendër të gjakut është 30 000 njësi në vendet me të ardhura të larta, 7 500 në vendet me të ardhura të mesme dhe 3 700 në vendet me të ardhura të ulëta, duke demonstruar gjerë dallimet në efektshmërinë e mbledhjes së gjakut ndër vendet me të ardhura më të larta. Në 39 vende, dhurimet e gjakut ende nuk testohen në mënyrë rutine për infeksione që transmetohen nga transfuzioni (ITTs) duke përfshirë HIV, hepatit B, hepatit C, dhe sifiliz; 47 % të donacioneve në vendet me të ardhura të ulëta mbeten akoma në nivelin e testeve jo me cilësi të sigurimit. Vetëm 31% e gjakut të grumbulluar në vende me të ardhura të ulëta është e ndarë në komponentë të gjakut. Kapacitetet për të siguruar pacientëve komponentë të ndryshme të gjakut që u nevojitet, është ende e kufizuar në këto vende.(19,20)

Globalisht, 106 vende kanë udhëzimet kombëtare në klinikë, të përshtatshëm për përdorim të gjakut në mënyrë të sigurt. Megjithatë, vetëm 13% e vendeve me të ardhura të ulëta - në krahasim me 30% të vendeve me të ardhura mesatare dhe 78% vende me të ardhura të larta - kanë një sistem kombëtar hemovigjilance për të monitoruar dhe për të përmirësuar sigurinë kombëtare të procesit të transfuzionit.(21,22)

QËLLIMI

Vlerësimi i përhapjes së agjentëve infeksiozë tek individët që politransfuzionohen në klinikat e hemodializës në Shqipëri dhe tek individët talasemikë dhe talaso-drepanocitarë . Në mënyrë indirekte arrihet dhe vlerësimi i sigurisë së gjakut, për agjentet infektive HIV, HepB, HepC, CMV dhe Sifiliz.

METODOLOGJIA

Për çdo pacient që transfuzionohet është përgatitur një skedë individuale e cila plotësohet pasi i është marrë mostra e gjakut. Çdo mostër gjaku e prelevuar është ruajtur në frigorifer +2 - +8 ose nëse i është nënshtruar centrifugimit, serumi ruhet në - 20°C. Mostrat e marra janë testuar për prezencën e Hep B, Hep C dhe HIV, në laboratorin e Hep/Hiv/Aids, në ISHP sipas metodës së ELISA. Në studim janë përfshirë rrethet Tiranë,

Durrës, Lushnjë, Gjirokastër, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Hemodializa e QSUT gjatë periudhës 2006 -2008.

REZULTATET

Gjatë vitit 2006 u vendos Survejanca biologjike për agjentët infektive tek individët e politransfuzuar.

Gjatë vitit 2006 është arritur të testohen të gjithë pacientët talasemikë dhe talaso-drepanocitar të repartit të onko-hematologjisë në QSUT në një total prej 135 pacientësh.

Rezultatet e testeve për 135 raste Onko-Hematologji, QSUT 2006




Figura 1. Rezultati i testimit për 135 raste të shërbimit të Onko-Hematologjisë.

Më pas gjatë viteve 2007-2008, survejanca përfshiu 7 rrethe të vendit si dhe hemodializën e Tiranës.

- Rrethet Gjirokastër, Korçë dhe Shkodër janë testuar për pacientët e hemodializuar.
- Lushnja, Vlora dhe Durrësi janë testuar për pacientët talasemikë dhe talaso-drepanocitar.
- Në rrethin e Tiranës janë testuar pacientët talasemikë dhe të hemodializuar.

Rezultatet e testimit:

118 (32.4%) e mostrave rezultuan positive për një total të 364 mostrave të testuara (95% CI 27.8-37.4) $p < 0.001$.

2 (0.5%) e rasteve janë të infektuar me HIV, (tab.3).

27 (7.4%) e rasteve me HBsAg, (tab.1).

89 (24.5%) e rasteve me HCV, (tab.2).

Në lidhje me HBsAg, 17 (63%) e tyre janë meshkuj dhe 10 (37%) e tyre femra. $OR_{(males/females)} = 1.3$ (95% CI 0.5-3.1) $p = 0.6$.

Tabela 1. Përqindja e rasteve të testuar për HbsAg, me metodën ELISA sipas rretheve

Nr.	Rrethi	Të testuar	HBsAg (ELISA)			
			+	%	-	%
1	Tiranë	116	3	2.6	113	97.4
2	Durrës	13	1	7.7	12	92.3
3	Lushnjë	97	2	2.1	95	97.9
4	Gjirokastrë	8	4	50.0	4	50.0
5	Shkodër	15	2	13.3	13	86.7
6	Korçë	4	2	50.0	2	50.0
7	Vlorë	6	0	0	6	100
8	Hem/dializa Tiranë	105	13	12.4	92	87.6

Tabela 2. Përqindja dhe numri i rasteve të testuar për HCV, me metodën ELISA sipas rretheve

Nr.	Rrethi	Të testuar	HCV (ELISA)			
			+	%	-	%
1	Tiranë	116	26	22.4	90	77.6
2	Durrës	13	0	0	13	100
3	Lushnjë	97	23	23.7	74	76.3
4	Gjirokastrë	8	1	12.5	7	87.5
5	Shkodër	15	3	20.0	12	80.0
6	Korçë	4	1	25.0	3	75.0
7	Vlorë	6	1	16.7	5	83.3
8	Hem/dializa Tiranë	105	33	31.4	72	68.6

Tabela 3. Përqindja e rasteve të testuar dhe të konfirmuar për HIV, me metodën ELISA sipas rretheve

Nr.	Rrethi	Të testuar	HIV(ELISA)			
			+	%	-	%
1	Tiranë	116	2	1.7	114	98.3
2	Durrës	13	0	0	13	100
3	Lushnjë	97	0	0	97	100
4	Gjirokastrë	8	0	0	8	100
5	Shkodër	15	0	0	15	100
6	Korçë	4	0	0	4	100
7	Vlorë	6	0	0	6	100
8	Hem/dializa Tiranë	105	0	0	105	100

Grupmosha më e prekur rezulton ajo nga 25-44 vjeç me 9 (33.3%) të rasteve dhe 45-65 vjeç me 12 (44.4%) të rasteve (fig.2).

Në lidhje me HCV, më e prekur është hasur grupmosha e re aktive 15-25 vjeç me 27 (30%) raste e ndjekur nga grupmosha 25-45 vjeç me 21 (24%) raste dhe grupmosha 5-15 vjeç dhe 45-65 vjeç me 9 (10%) raste respektivisht (fig.3).

Rezultatet e testimeve per 364 raste





Figura 2. Shpërndarja sipas agentëve infektiv të diagnostikuar, të rasteve të testuara.

HBsAg sipas grupmoshes



HCV sipas grupmoshes




Figura 3. Paraqitja e rasteve sipas grup moshës për HBsAg dhe HCV.

KONKLUZIONE

1. Rastet pediatrike të konfirmuara me HBsAg dhe HCV të vitit 2008 krahasuar me vitin 2006 rezultojnë të njëjtat pa asnjë rast rinfeksioni apo rast të ri të infektuar (situatë e njëjtë me 2006).
 - Nga rastet e paraqitura nuk rezultoi asnjë pacient pozitiv për agjentët infeksiozë i infektuar pas transfuzionit të parë
 - Vetëm një rast me bashkëekzistencë të dy infeksioneve (HIV + HCV).
 - Të gjitha rastet HCV+ dhe HBsAg+ janë të konfirmuara më parë.
2. Për vitin 2008 nga ekzaminimet e të politransfuzuarve rezultoi se:
 - Nga rastet e paraqitura nuk rezultoi asnjë pacient pozitiv për agjentët infeksiozë i infektuar pas transfuzionit të parë.
 - Survejanca biologjike tek të hemodializuarit, në momentin e testimit, është kryer pas disa vitesh politransfuzimesh.
 - Asnjë rast i infektuar me HIV.
 - Pesë raste me bashkëekzistencë të dy infeksioneve HBsAg + HCV (hemodializë e Tiranës).
 - Një rast me dy infeksione HBsAg + HCV (hemodializë e Korçës).
 - Një rast HIV + HCV (pediatrik, talasemik, 2006).

BIBLIOGRAFIA

1. Gresens CJ and Holland PV. Current risks of viral hepatitis from blood transfusion. *J Gastroenterology and Hepatology* 1998; 13:443-449.
2. Dr.Shk.Gj. Koja, Prof.Ass.A. Shehi, A.Njëhrrena, I.Minga Legjislacioni Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë për periudhën 1992-2010. Volumes I, II, III.
3. Bethesda, MD, Standards for Blood Banks and Transfusion Services. 18. American Association of Blood Banks, 1997, 41, K2.000.
4. Kleinman S, Chiavetta J, Hindieh F, Pi D, Ricketts M, Robillard P, Sher G, Chan P. The Surveillance and Epidemiology of Transfusions Working Group Final Report. Ottawa, 1999.
5. Kicklighter EJ and Klein HG. Hemolytic transfusion reactions. In: Linden JV and Bianco C, editors. *Blood Safety and Surveillance*. New York: Marcel Dekker, Inc. 2001:47-70.
6. Moor ACE, Dubbelman TMAR, VanSteveninck J, Brank A. Transfusion Transmitted diseases: risks, prevention nd perspectives. *Eur J Haematol* 1999; 62:1-18.
7. Goldman M and Blajchman MA. Blood-product associated bacterial sepsis: *Transfusion Medicine Reviews*. 1991; 5:73-83.
8. Dodd RY. Transmission of parasites and bacteria by blood components. *Vox Sang* 2000; 78(Suppl.2):239-242.
9. McQuiston J. Transmission of tick-borne agents of disease by blood transfusion. *The Compendium*. 53rd AABB annual meeting. 2000; Washington. DC: 29-31.
10. Chiavetta JA, Maki E, Gula CA, and Newman A. Estimated risk of Transfusion Transmitted infection in the Canadian blood supply (1987-1996). *Vox Sang* 2000; 78(Suppl. 1); P360 (abstract).
11. Blajchman MA. Reducing the risk of bacterial contamination of cellular blood components. *Advances in Transfusion Safety, Dev Biol*. 1999; 102:183-193.
12. Gresens CJ and Holland PV. Other reactions and all immunization. In: Linden JV and Bianco C, editors. *Blood Safety and Surveillance*. New York: Marcel Dekker, Inc. 2001:71-86.
13. WHO. Blood Safety. Key global fact and figures in 2011 Fact sheet n°279 | June 2011.
14. Kopko PM and Holland PV. Mechanisms of severe transfusion reactions. *Transfus Clin Biol* 2001; 8:278-281.
15. Popovsky MA. Transfusion and lung injury. *Transfus Clin Biol* 2001; 8:272-277.
16. Webb IJ and Anderson KC. Graft-versus-host disease. In: Linden JV and Bianco C, editors. *Blood Safety and Surveillance*. New York: Marcel Dekker, Inc. 2001:109-124.
17. Kondili LA, Tosti ME, Szklo M et al The relationship of chronic hepatitis and cirrhosis to alcohol intake, hepatitis B and C and delta virus infection: a case control study in Albania. *Epidemiology and Infection* 1998; 121:391-395.
18. Malamitsi Puchner A, Papacharitonos S, Sotos D et al. Prevalence study of different hepatitis markers among pregnant Albanian refugees in Greece. *Eur J Epidemiol* 1996;12:297-301.
19. Chironna M, Germinaro C, Lopalco PL, Quarto M, Barbuti S et al. HBV, HCV and HDV infections in Alba-

- nian refugees in Southern Italy (Apulia region) *Epidemiol and Infection* 2000; 125:163-167.
20. Stroffolini T, Mele A, Tosti ME, Gallo G, Balocchini E, Ragni P, Santonastasi F, Marzolini A, Cocozzi M, Moraghi A. The impact of the hepatitis B mass immunisation campaign on the incidence and risk factors of acute hepatitis B in Italy. *J Hepatol* 2000 33:980-985.
21. Stroffolini T. The changing pattern of hepatitis B virus infection over the past three decades in Italy. *Dig Liver Dis* 2005 37:622-627.

BIOLOGICAL SURVEILLANCE OF INFECTIOUS AGENTS AMONG INDIVIDUALS RECEIVING MULTIPLE TRANSFUSIONS IN ALBANIA

Eugena Tomini¹, Silva Bino¹, Artan Simaku¹, Mimoza Basho¹, Shpëtim Qyra¹

¹Institute of Public Health, Tirana, Albania

ABSTRACT

Introduction: Control of blood for HIV and other infectious agents in Albania is mandatory by constitutional law. Individuals receiving multiple transfusions as well as other vulnerable groups are routinely checked for the presence of infectious agents. **Aim:** To estimate the prevalence of infectious agents among individuals receiving multiple transfusions. **Method:** Blood specimens were collected from patients receiving multiple transfusions in units of hemodialysis and oncohematology in several districts of the country over the period 2006-2008. All specimens were tested for viral hepatitis B and C, and HIV. All specimens were tested using ELISA method. **Results:** 118 (32.4%) specimens resulted positive out of a total of 364 specimens tested (95%CI 27.8-37.4) $p < 0.001$. 2 (0.5%) cases were infected with HIV, 27 (7.4%) cases with HBsAg, 89 cases (24.5%) with HCV. With HBsAg, 17 (63%) of them were males and 10 (37%) females. $OR_{(males/females)} = 1.3$ (95% CI 0.5-3.1) $p = 0.6$. Most affected : agegroup 25-44yrs , 9 (33.3%) cases and 45-65yrs, 12 (44.4%) cases. With HCV, most affected the young active agegroup 15-25yrs with 27 (30%) cases followed by agegroup 25-45yrs with 21 (24%) cases and agegroups 5-15 yrs and 45-65yrs with 9 (10%) cases respectively. **Conclusions:** The surveillance from 2006 onwards, encompassed individuals receiving multiple transfusions from several years.. HIV cases were already confirmed in pediatric patients before implementation of the surveillance in 2006. In of them was found co-infection with HCV. In six cases was found co-infection of HBsAg + HCV.

Key words: Poly transfused, infectious agents, blood specimens, transfusion

PERDORIMI I DUHANIT TEK ADOLESHENTET TË GRUP MOSHES 15 - 18 VJEC NE VENDIN TONE 2009.

Rudina Çumashi¹, Rovena Daja¹

Instituti i Shëndetit Publik

Departamenti i Informacionit Shëndetëor, Teknologjisë dhe Komunikimit, Tiranë, Shqipëri

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 66-69

REZYME

Survejimi sistematik i sjelljeve të rrezikshme tek të rinjtë kishte si qëllim përcaktimin e prevalencës së duhanpirjes tek të rinjtë, moshën e pirjes së cigares së parë, aksesin për të blerë cigaret nga vetë adoleshentët, pirjen e duhanit në ambientet e shkollës, grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar dhe lokal si dhe sipas ndarjes së të rinjve nëpër klasa. Kampioni ishte prej 3200 nxënës të grup moshës 15-18 vjec, të përzgjedhur në 12 Qarqet e vendit si dhe Bashkia e Tiranës. Si instrument i studimit u përdor një pyetësor i standartizuar. Rezultatet: 59% e të rinjve kishin pirë ndonjë herë duhan, 12.8% e të rinjve kishin pirë duhan në moshën ≤ 12 vjec. Midis të rinjve duhan pirës <18 vjec 14.2% e tyre e kishin blerë vetë duhanin. 9.6% e nxënësve duhan pirës e kanë pirë atë në ambientet e shkollës dhe 11.7% e nxënësve duhan pirës kanë pirë 2 ose më shumë cigare për ditë. Më shumë pijnë duhan meshkujt sesa femrat.

Fjalë kyç: duhan pirja, të rinjtë, Republika e Shqipërisë

HYRJE

Duhani është ende shkaku kryesor i vdekjeve të parandalueshme në botë. Përdorimi i duhanit tek adoleshentët është një indikator kyç jo vetëm në fillimin e duhan pirjes por gjithashtu për trendin në të ardhmen të prevalencës së varësisë ndaj duhanit si dhe të sëmundjeve të lidhura me duhanin te të rriturit¹. Konsumi i duhanit është një faktor i njohur rreziku për sëmundjet kardiovaskulare, i cili shkakton kancer të mushkërive dhe forma të tjera kanceri, si dhe ndikon në shfaqjen e pneumonisë, emfizemës dhe bronkitit kronik².

Pjesa me e madhe e të rinjve janë të shëndetshëm. Megjithatë një numër i madh të rinjsh angazhohen në sjellje që rrezikojnë jo vetëm gjëndjen aktuale të shëndetit të tyre por shpesh shëndetin e tyre për vitet e ardhshme. Rreth 2/3 e vdekjeve të parakohshme dhe 1/3 e sëmundshmërisë tek të rriturit janë të lidhura me kushte apo sjellje të cilat fillojnë që në rini si: përdorimi i duhanit, mungesa e aktivitetit fizik, marrëdhënie seksuale të pambrojtura si dhe ekspozimi ndaj dhunës³.

Pjesa më e madhe e përdoruesve të duhanit në mbarë botën e kanë filluar atë kur kanë qënë adoleshentë përpara moshës 18 vjec^{4,5}. Sot është vlerësuar se 150 milion të rinj ne bote janë përdorues të duhanit³. Ky numër është rritur

në mënyrë globale dhe në mënyrë të vecantë tek femrat e reja¹. Të rinjtë që janë duhan pirës përveç problemeve me shëndetin u rritet shume edhe rrishtu për përdorim të alkoolit, të drogave të ndryshme në krahasim me bashkëmoshatarët të cilët nuk janë duhanpirës⁹.

Studime të ndryshme kanë treguar se përdorimi i duhanit është problem si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim⁶. Statistikat tregojnë se në Amerikë 19.5% e të rinjve të shkollave të mesme janë duhanpirës⁷. Rajoni i Europës e ka prevalencën e përdorimit të duhanit 20% për meshkujt dhe 15% për femrat të grup moshës 13 - 15 vjec⁸. Prevalencë të lartë të duhan pirjes te grup mosha 15 vjec e kanë vendet si Bullgaria, Croaci, Slovakia, Franca ku prevalenca e përdorimit të duhanit në 30 ditët para studimit shkonte afërsisht 40%¹⁰.

Në vendin tonë studime të ndryshme kanë treguar se prevalenca e duhan pirjes tek ne vazhdon të jetë në rritje dhe sidomos tek femrat fenomeni i duhan pirjes ka pasur një rritje në vitet e fundit^{2,11}. Për të monitoruar si dhe vlerësuar sjelljet riskante për shëndetin tek të rinjtë e vendit tonë u ndërmor « Studimi i Sjelljeve me risk tek të rinjtë e shkollave të mesme » në vitin 2009 - 2010. Ky studim do të vlerësonte sjelljet riskante më problematike të të rinjve si: përdorimin e duhanit, alkoolit dhe

drogave të tjera, sjelljet seksuale të cilat kontribuojnë në shtatzani të padëshirueshme, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe SIDA, sjellje që kontribuojnë në aksidente dhe dhunë, aktivitetin fizik tek të rinjtë si dhe praktika ushqyerje jo të shëndetshme.

QËLLIMI

Survejimi sistematik dhe gjithëpërfshirës i sjelljeve riskante tek të rinjtë e grup moshës 15 - 18 vjec kishte si qëllim: përcaktimin e prevalences se pirjes se duhanit tek te rinjte, prevalencës së obezitetit dhe mbipeshës, prevalencën e pjesmarrjes në aktivitete fizike, përcaktimin e ecurisë në kohë të tyre, grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar dhe lokal si dhe sipas kategorive të të rinjve. Këtu do të fokusohemi kryesisht tek përdorimi i duhanit tek adoleshentët.

METODOLOGJIA

Ky është një studim kombëtar në të cilin u përzgjedhën të rinjtë e shkollave të mesme publike dhe profesionale të grupmoshës 15 - 18 vjec. Përzgjedhja e të rinjve u udhëhoq nga parimi i përfaqësimit sa më të saktë të masës totale të të rinjve në arsimin e mesëm. Totali i nxënësve të cilët u përfshinë në studim ishte 3200 nxënës. U krye një përzgjedhje e randomizuar dhe e ponderuar sipas numrit të nxënësve në secilin nga 12 Qarqet e vendit si dhe në Bashkinë e Tiranës që u trajtua si njësi më vete. Në cdo qark në mënyrë të rastësishme u përzgjedhën 3 shkolla dhe në këto shkolla u përzgjedh një klasë në mënyrë të rastësishme për cdo vit. Si instrument i studimit u përdor një pyetësor i standartizuar. Pyetësori ishte i vetëadministrueshëm dhe përmbante pyetje llogjike me qëllim sigurimin e informacionit mbi një sërë ndryshorësh si demografike ashtu edhe lidhur me sjelljet riskante për shëndetin. Për organizimin e pyetësorit u mbështetëm në ekspertizën dhe përvijën e Centers for Disease Control and Prevention (CDC), SHBA. Analiza e të dhënave u krye me programin SPSS.

REZULTATET


Pyetjet që u janë bërë nxënësve në lidhje me duhanin masin duhan pirjen përgjatë jetës si dhe duhanpirjen aktuale, moshën kur kanë filluar ta pijnë për herë të parë, aksesin për të blerë cigare, pirjen e duhanit në ambientet e shkollës si dhe përpjekjet për ta lënë duhanin. Në Nëntor të 2006 u aprovua ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” në nenin 9 të të cilit thuhet

se “ndalohet shitja ose furnizimi, për qëllime tregtimi, i produkteve të duhanit personave nën moshën 18 vjec. Në këtë studim të kryer në nxënësit e shkollave të mesme 14.8% e nxënësve që pinin duhan me moshë < 18 vjec i kanë blerë cigaret vetë në një dyqan ose si cigare të hapura në rrugë.

Prevalenca e nxënësve të shkollave të mesme që kanë pirë ndonjë herë duhan ka ardhur duke u rritur nga viti 2005 kur është bërë studimi i parë deri në 2009, përkatësisht nga 54.6% në 59.1%. Grafiku 1


Në përgjithësi prevalenca e të provuarit të duhanit te paktën ndonjëherë në jetë ishte më e lartë në klasat e 10 dhe 11, përkatësisht (62.8% dhe 60.3%) sesa në klasat e 12 ku ishte 51.5%. Gjithashtu prevalencat ndryshojnë edhe midis meshkujve dhe femrave me 67.9% dhe 52.8%. Këto prevalenca kanë ardhur duke u rritur krahasuar me studimin që është bërë në 2005 të cilat ishin 64.4% e meshkujve dhe 46.9% e femrave kishin provuar të pinin ndonjëherë duhan. Ajo që vihet re është se kemi një rritje të përqindjes së femrave që kanë provuar duhanin më shumë sesa meshkujt përkatësisht me 6% femrat dhe 4% meshkujt krahasuar me 2005. Në qoftë se do të shikonim a kemi ndryshim mes zonave urbane dhe rurale vëmë re një diferencë të madhe të prevalencave përkatësisht 41.3% në zonat urbane dhe 17.7% në zonat rurale.

Në lidhje me moshën kur adoleshentët kanë pirë për herë të parë një cigare të plotë në studim u vu re se midis nxënësve të shkollave të mesme 11.5% e tyre kanë pirë një cigare të plotë për herë të parë në moshën 13 - 14 vjec dhe 22.3% në moshën 15 - 16 vjec. Në studim u vu re se 12.8% e nxënësve kanë pirë një cigare të plotë në moshën ≤ 12 vjec përqindje më e lartë kjo krahasuar me atë të studimit të vitit 2005 ku kjo përqindje ka qënë 10.9%. Grafiku 2.



Grafiku 1.

Përsa i përket duhan pirjes aktuale të të rinjve 28.8% e nxënësve kishin pirë duhan në 1 ose më shumë ditë gjatë 30 ditëve para se të kryheshe studimi. Prevalencat ndryshonin në mënyrë sinjifikative midis meshkujve dhe femrave, përkatësisht 43.1% dhe 18.7%, ndërsa në ndarjet sipas klasave nuk kishte ndonjë diferencë të dukshme. Nxënësit raportuan se në lidhje me numrin e cigareve që kishin pirë në 30 ditët para studimit 22% e tyre kishin pirë nga një deri në 5 cigare në ditë dhe 6% kishin pirë nga 6 - 20 cigare në ditë dhe 2% kishin pirë më shumë se 20 cigare në ditë. Grafiku 3



Grafiku 3.


Edhe pse në vendin tonë është aprovuar ligji në 2006 « Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit » ku në nenin 9 të saj cilësohet « ndalohet shitja ose furnizimi, për qëllime tregtimi i produkteve të duhanit personave nën moshën 18 vjeç » 14.8% e nxënësve të shkollave të mesme që pinin duhan me moshë < 18 vjeç i kishin blerë vetë ato në një dyqan ose si cigare të hapura. Gjithashtu ajo që u vu re në studim ishte se gjatë 30 ditëve të fundit para studimit 9.5% e nxënësve të shkollave të mesme kanë pirë duhan në mjediset e shkollës, dhe prej këtyre më shumë meshkujt 19.6% sesa femrat 2.3%.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjithashtu përgjatë jetës së tyre 9.5% e nxënësve duhan pirës kishin pirë duhan përditë për më shumë se 30 dite. Kjo prevalencë ka ardhur duke u rritur nëse e krahasojmë me të njëjtin studim të kryer në 2005 e cila ka qënë 8%. Përsa i përket përpjekjeve që nxënësit kishin bërë për të lënë duhanit ata raportuan se 16.4% e nxënësve duhan pirës ishin përpjekur vitin e fundit shkollor për ta lënë atë ku 27.5% ishin meshkuj dhe 8.6% femra.

Studimi nga të dhënat që nxori konfirmoi se duhan pirja tek të rinjtë e vendit tonë vazhdon të jetë një problem shqetësues. Përdorimi i duhanit vazhdon të ketë rritje me kalimin e viteve. Kjo vihet re nga prevalencat që kanë ardhur duke u rritur duke i krahasuar me të dy studimet që janë bërë në vitin 2005 dhe në 2009. Duhan pirja është e përqëndruar më shumë tek meshkujt sesa tek femrat megjithatë edhe tek femrat fenomeni i pirjes së duhanit ka ardhur duke u rritur. Ka më shumë femra të cilat pijnë duhan sot. Gjithashtu u vu re se kishim edhe përdorim të duhanit në mjediset e shkollës si dhe aksesit për blerjen e duhanit nga të rinjtë ishte shumë e lehtë gjë që tregon një mosfunksionim shumë të mirë të ligjit kundër duhanit.

Si përfundim mund të themi se studimi tregoi se duhan pirja tek të rinjtë vazhdon të jetë një problem ndaj rekomandojmë sa më poshtë vijon:



Grafiku 2.

- Promocion aktiv mbi efektet negative që duhani jep në shëndet.
- Në kurrikulat mësimore të ketë një hapësirë më të gjerë për edukim shëndetësor, për faktorët e ndryshëm të rrezikut për shëndetin tek të rinjtë.
- Punonjësit e shëndetësisë që janë nëpër shkolla si dhe vetë mësuesit të bëjnë një punë më sensibilizuese për të mos lejuar përdorimin e duhanit në ambientet e shkollës.

BIBLIOGRAFIA

1. Statistics on youth smoking in different countries. National Institute for health and Welfare.
2. Raporti i Studimit Demografik dhe Shendetesor ne Shqiperi, 2008 - 2009
3. Young People: health risks and solution. WHO August 2011.
4. US Department of Health and Human Services. Preventing tobacco use among young people. A report of the Surgeon General. Atlanta Georgia: Public health Services, CDC, Office on Smoking and Health, 1994.
5. Secretary of State for Health and Secretaries Of State for Scotland, Wales and Northern Ireland. Smoking kills. A White paper on tobacco, 30 November 1999.
6. The Global Youth Tobacco Survey Collaborative Group. Tobacco use among youth: a cross country comparison. Tobacco control 2002, 11: 252-270.
7. Center for Disease Control and Prevention. Youth Risk Behavior Surveillance - United States, 2009 Surveillance Summaries, MMWR 2010; 59 (No. SS-5).
8. WHO Regional Offices, 2009.
9. CDC, preventing Tobacco use Among Young People - A report of the Surgeon General, 1994
10. The 2001 ESPAD Report. Substance use among students in 36 European countries.
11. Ross H, Zaloshnja E, Levy T D, Tole Dh. Results from the Albanian adult tobacco.cent Eur J Public Health 2008 ; 16 (4): 182-188

USE OF TOBACCO AT ADOLESCENTS IN AGE GROUP 15 - 18 YEARS IN ALBANIA 2009

Rudina Çumashi¹, Roven Daja¹

¹Institute of Public Health

RESUME

Health risk behaviors contribute on the leading causes of death, disability and social problems among youth and adults. These behaviors often established during childhood and early adolescence.

The purpose of Youth Risk Behavior Surveillance System among adolescents was: to determine the prevalence of smoking among young, the age of smoking the first cigarette, the access to buy tobacco by adolescents, smoking on school premises, determining their progress over time, data collection at the national and local level and according to the division in classes of adolescents. Sample size of 3200 student (15 - 18 years) was selected in 12 districts of the country and the Municipality of Tirana. As the survey instrument a standardized questionnaire was used, adapted from Centers for Disease Control and Prevention (CDC).

Results: 59% of adolescent had tried cigarette smoking, 12.8% of adolescents had smoked at age ≤ 12 year. Between youth tobacco smoking < 18 year 14.2% of them had buy the tobacco by themselves. 9.6% of youth that are smoker had smoked on school premises and 11.7% of adolescent's smoker had smoked 2 or more cigarette per day.

Some recommendations are: Continuing promotion on the damage that cigarette smoking has on health, efficient health education, and greater focus of health education in school curricula.

Key words: tobacco smoking, youth, the Republic of Albania.

NDIKIMI I AMBIENTIT EDUKATIV NË ZHVILLIMIN PSIKO-MOTOR TË FËMIJËVE PARASHKOLLORË NË QYTETIN E VLOËS, SHQIPËRI

Aurela Saliaj¹, Ermira Kola², Lorena Lazaj³, Dona Manaj³

¹Departamenti i Kujdesit për Nënë dhe Fëmijën, Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri

²Reparti i Terapisë Intensive, Spitali Pediatrik, QSUT, Tiranë, Shqipëri

³Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 70-77

PËRMBLEDHJE

Vlerësimi i parametrave psikometrikë të fëmijëve parashkollorë (3-6 vjeç) është një nga aspektet më të rëndësishme të fëmijëve në këtë moshë, dhe për fat të keq më i neglizhuari. Ndërkohë që investimi i bërë nga shoqëria në këtë periudhë të jetës së fëmijës është përcaktues për zhvillimin e potencialit të plotë në jetën e tyre si adultë. Një nga faktorët që kontribuon ndjeshëm në këtë aspekt të zhvillimit të fëmijëve është stimulimi dhe motivimi që u bëhet atyre nga ana e ambientit edukativ në kopshtet, ku edhe kalojnë pjesën më të madhe të ditës. Me anë të një studimi cros-seksional ne vlerësuam nivelin e zhvillimit psiko-motor të fëmijëve parashkollorë të rregjistruar në disa nga kopshtet publike dhe private në qytetin e Vlorës, si dhe cilësinë e ambientit edukativ të këtyre kopshteve nëpërmjet testeve ndërkombëtare të standartizuara. Në përfundim të studimit u konstatua se përqindja e fëmijëve me vonesa të zhvillimit psiko-motor pothuaj në të gjitha kopshtet ishte e konsiderueshme, cilësia e ambienteve edukative të kopshteve në përgjithësi u klasifikua mbi minimal (afër mirë) dhe kishte një lidhje statistike të rëndësishme midis cilësisë së ambientit edukativ dhe përqindjes së fëmijëve me 2 apo më shumë parametra psikometrikë nën normalen e grup-moshës.

Fjalët kyçe: parametrat psikometrikë, zhvillimi psikomotor, ambienti edukativ, kopshtet e qytetit të Vlorës, Shqipëri.

HYRJA

E ardhmja e çdo shoqërie varet nga aftësia që ajo ka për të mundësuar shëndetin dhe mirëqënien e gjeneratës vijuese. Fëmijët e sotëm janë qytetarët, punëtorët dhe prindërit e së ardhmes. Kur ne investojmë me mençuri tek fëmija dhe familja, gjenerata që do të vijë do të na e shpërblejë këtë investim nëpërmjet një jete të tërë produktiviteti dhe qytetarie të përgjegjshme. Nëse ne dështojmë në realizimin e asaj çfarë nevojitet për ndërtimin e një baze të fortë për jetën e shëndetshme dhe produktive, e vemë zhvillimin dhe sigurinë tonë të ardhme në rrezik.

Vlerësimi i parametrave psikometrikë të fëmijëve parashkollorë është një pjesë e rëndësishme e vlerësimit të mirëzhvillimit të fëmijëve të kësaj moshe. Ka disa faktorë që kontribuojnë në zhvillimin e funksioneve psikomotorë, si statusi socio-ekonomik, ndërveprimi nënë (edukator)/ fëmijë dhe cilësia e ambientit edukativ (8). Në këtë punim ne jemi përqëndruar në nivelin që

paraqet zhvillimi psikomotor i fëmijëve parashkollorë që frekuentojnë kopshtet e Vlorës dhe në kontributin që ambienti edukativ ka në nivelin e parametrave psikometrikë të këtyre fëmijëve.

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e hershëm të fëmijës duket të jetë më tepër efektiv dhe më pak i kushtueshëm sesa adresimi i problemeve në moshat e mëvonshme. Shkencëtarët përdorin termin 'plasticitet' për t'iu referuar aftësisë së trurit për të ndryshuar dhe ky plasticitet është maksimal në fëmijërinë e hershme dhe bie me rritjen e moshës. Megjithatë 'dritarja e mundësive' për aftësitë e sjelljes adaptive dhe zhvillimit psiko-motor qëndron e hapur për shumë vite, tentativa për të ndryshuar sjelljet apo për të krijuar aftësi të reja në strukturën bazë të qarqeve trunore (të paformuar si duhet që në fillim) kërkon më tepër punë dhe është më "e kushtueshme". (8)

Këto të dhëna e drejtojnë vëmendjen tonë tek rëndësia e suportit informal familjar dhe e suportit formal të

institucioneve edukative përpara së fëmijët të shfaqin probleme të rëndësishme në sjellje dhe zhvillim. Një klimë instruktuese dhe zhvilluese e përshtatshme është nxitëse për aftësinë e fëmijës për të mësuar, së bashku me nevojën për lëvizje 'të planifikuara' në ambientin për të mësuarit motor (motorika globale dhe fine) (12).

Të dhënat e studimeve të ndryshme konkordojnë në faktin se cilësia e ambientit ku rritet fëmija ndikon në disa nivele. Nëse do të shpreheshim në kuadrin e eksperiencës së përditshme të fëmijëve, ata duken më të lumtur dhe më të përfshirë nga pikëpamja konjitive në institucionet ku edukatorët ndërveprojnë me ta pozitivisht dhe atje ku raporti edukator:fëmijë është më i ulët. (2,8)

Fëmijët që frekuentojnë institucione me cilësi të lartë (e matur kjo nëpërmjet performancës së edukatorëve, paisjeve të kopshtit, aktiviteteve të përshtatshme për moshën e fëmijëve dhe karakteristikave strukturale) shfaqin kompetenca konjitive, gjuhësore dhe sociale më të mira në testet e standartizuara psikometrike sipas prindërve, mësuesve dhe vlerësuesve profesionistë. (2,11)

Fëmijët që kanë ndërveprime më pozitive me edukatorët e tyre dhe marrdhënie më të sigurt me ta duket të jenë më prosocialë dhe më pozitivisht të përfshirë me bashkëmohatarët e tyre. Fëmijët që kanë mundësi të përfshihen në aktivitete si arte, kuba, dhe pjesë teatrale demonstrojnë siguri më të madhe konjitive gjatë lojës së lirë (2).

Sipas një studimi të Rrjetit Kërkimor për Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme USA (Early Child Care Research Network, 1999a) fëmijët, që në moshën 36 muajshe kanë pasur edukatorët të specializuara apo me më tepër edukim arsimor, shfaqën më pak probleme në sjellje dhe arritjen rezultate më të larta në lexim dhe perceptim gjuhësor në shkollë (8).

Të tjera studime kanë konkluduar se parashkollorëve mund t'iua reduktojmë pabarazitë në arritjet akademike të arsimit fillor duke i mbrojtur fëmijët nga disavantazhet familjare me anë të ambienteve edukative të cilësive të larta (11). Vetëm identifikimi dhe ndërhyrja e shpejtë mund ti reduktojë risqet e vonësve të zhvillimit (9).

Të dhënat e studiuesve të ndryshëm përforcojnë nevojën për të transformuar hapësirat e institucioneve në ambiente më mbështetëse për të patur më tepër përfitime në zhvillimin dhe shëndetin mendor të fëmijëve (1,7, 8). Rezultatet tregojnë se një klimë motivuese e shkallës së

lartë sjell përfitime psikologjike të lidhura me arritjet e motivimit. Këto të dhëna duhet të inkurajojnë edukatorët e arsimit parashkollor për të marrë në konsideratë efektin e klimës instruktuese në vet-perceptimin e fëmijëve (7).

QËLLIMI

Të vlerësohet sesi ndryshimi i ambientit edukativ ndikon zhvillimin psikomotor të fëmijëve parashkollorë, në mënyrë që të hidhet dritë mbi pikat e forta dhe të dobëta të parametrave psikometrikë të parashkollorëve të Vlorës dhe të ambientit ku ata edukohen.

Objektivat:

1. Identifikimi i nivelit të zhvillimit psiko-motor të fëmijëve parashkollorë që frekuentojnë kopshtet e qytetit të Vlorës, nëpërmjet vlerësimit të shpërndarjes së parametrave psikometrikë tek ta sipas standarteve të stadit të zhvillimit të grup-moshës.
2. Vlerësimi i cilësisë së ambientit edukativ që u ofrohet këtyre fëmijëve në kopshtet që frekuentojnë.
3. Hipotezë: Sa më e lartë cilësia e ambientit edukativ, aq më e ulët përqindja e parametrave psikometrikë nën normën e zhvillimit të grup-moshës.

MATERIALI DHE METODA

Në këtë studim kros-seksional, deskriptiv dhe analitik, u përfshinë të gjithë fëmijët parashkollorë (3-6 vjeç) të rregjistruar në disa prej kopshteve ditore (private dhe publike) në qytetin e Vlorës, Shqipëri. Nga studimi u përjashtuan fëmijët me sindroma gjenetike, hantikape shqisore apo vonesa mendore të diagnostikuara. Pasi u bë matja e parametrave psiko-metrikë të fëmijëve, u vlerësua sesi parametrat afër dhe nën minimumin e zhvillimit të grup-moshës vareshin nga ambienti edukativ që u ofrohej këtyre fëmijëve në kopshtet që frekuentonin.

Matja e parametrave psiko-metrikë u bë në bazë të testit ndërkombëtar të standartizuar Age&Stage Questionnaires-3 (ASQ-3) (Jane Squires & Diane Bricker 2009) (13), referuar moshës kronologjike të fëmijëve. Vlerësimi i cilësisë së ambientit edukativ u bë në bazë të sistemit pikëzues Early Care Environment Rate Scale - Revised (ECERS-R) (Harms, Clifford&Cryer, 2005) (6). Përpunimi statistikor u realizua në paketën statistikore SPSS ver.17.

REZULTATET

I - Identifikimi i nivelit të zhvillimit psiko-motor të fëmijëve parashkollorë që frekuentojnë kopshtet e qytetit të Vlorës.

Gjatë këtij studimi u vlerësuan parametrat psikometrikë të 141 fëmijëve parashkollorë të rregjistruar në 6 kopshte ditore (3 private dhe 3 shtetërore) në qytetin e Vlorës gjatë periudhës Janar-Qershor 2012. Në përfundim të tij u konstatua se (tab.nr.3) 63% e fëmijëve kishin vonesë zhvillimi psikomotor në të paktën 1 sektor, 30% e tyre kishin vonesa në 2 apo më shumë sektorë dhe 2% e fëmijëve kishin vonesë totale zhvillimi nën minimalen e grup-moshës.

Në tabelën nr.1 paraqitet shpërndarja e parametrave psikometrikë të të gjithë fëmijëve të marrë në studim sipas sektorëve të ASQ-3 duke iu referuar minimumit të pikëzimeve të grup-moshave të përcaktuara në këtë test. Sektori psikomotor me përqindjen më të ulët të zhvillimit ishte sektori Personal-Social (32% vonesa psikomotore) dhe sektori me përqindjen më të lartë të zhvillimit ishte Motorika globale (17% vonesa).

Me pikëzim shumë të ulët predominojnë qartë tre sektorë: Komunikimi, Zgjidhja e problemeve dhe Sektori personal-social me nga 9% të fëmijëve që nuk arrijnë as minimalen e zhvillimit të grup-moshës. Ndërsa zhvillimi në Motorikën globale dhe fine arrihen nga një numër më i madh fëmijësh (respektivisht 6 dhe 5%).

Tab.1 - Shpërndarja e parametrave psiko-metrikë të fëmijëve sipas minimumit të zhvillimit të grup-moshës (në bazë të pikëzimit të kapur në sektorët e ASQ-3).

	Komunikimi		Motorika globale		Motorika fine		Aftësia për të zgjidhur problemet		Sektori personal-social	
	Niveli	Pikëzim	Niveli	Pikëzim	Niveli	Pikëzim	Niveli	Pikëzim	Niveli	Pikëzim
Mbi minimumin e kërkuar	109	77%	117	83%	114	81%	103	73%	96	68%
Afër minimumit të kërkuar	19	14%	16	11%	20	14%	25	18%	32	23%
Nën minimumin e kërkuar	13	9%	8	6%	7	5%	13	9%	13	9%

II - Vlerësimi i cilësisë së ambientit edukativ që u ofrohet këtyre fëmijëve në kopshtet që frekuentojnë.

Në këtë studim u përfshinë me përzgjedhje të rastësishme tre kopshte private dhe tre kopshte publike të qytetit të Vlorës, të shpërndara në të gjithë territorin e qytetit (qendër dhe periferi). Në tabelën nr.2 janë paraqitur profilet e kopshteve në studim sipas klasifikimit ECERS-R. Në bazë të këtij klasifikimi vlerësohet si 'i papërshtatshëm' pikëzimi mesatar 1, si 'minimal' pikëzimi mesatar 3, si 'mirë' pikëzimi mesatar 5 dhe si 'shkëlqyer' pikëzimi mesatar 7.

Pikëzimin më të lartë e kanë kopshtet private, dy prej të cilave (Aulona dhe Montesori) janë rreth vlerësimit 'mirë' me 5.1 dhe 4.8 të pikëzimit mesatar. Por edhe kopshti privat Binjaket, me 4.65 nuk është larg vlerësimit 'mirë'.

Nga kopshtet publike më mirë paraqitet kopshti nr.10 me një pikëzim 4.05, ndërsa dy kopshtet e tjera me vlerësimet 3.7 dhe 3.26 e kalojnë 'minimalen', por janë larg vlerësimit 'mirë'.

Në total kopshtet e marra në studim në qytetin e Vlorës paraqisnin një pikëzim mesatar prej 4.3 pikësh, që është një nivel jo vetëm mbi 'minimalen', por edhe afër vlerësimit 'mirë'. Nëngrupi i shkallës klasifikuese ECERS-R me pikëzimin më të lartë për të gjitha kopshtet ishte nëngrupi 'Ndërveprimet' me 5.26 pikë, dhe që ka të bëjë me mbikëqyrjen e fëmijëve, disiplinën dhe bashkëpunimin midis stafit. Ndërsa pikëzimin më të ulët e kishin nëngrupet Komunikimi/Arsyetime dhe Aktivitetet (respektivisht me 3.75 dhe 3.4 pikë), sektorë që kanë të bëjnë me punën edukative (stimuluese, instruktuese dhe motivuese) me fëmijët nga ana e stafit profesional.

Tab.2 - Profili ECERS-R për kopshtet në studim, Vlorë

Nëngrupet e profilit	Elementët e nëngrupit	Pikëzimi mesatar						
		Aulona	Montesori	Binjakët	No. 10	Teli Ndini	No. 8	Pikëzimi mesatar
Hapësirat dhe paisjet	<i>Hapësira e brendshme Paisjet për kujdesin e përditshëm, lojën dhe mësimin. Paisjet për shlodhje Hapësirat për privatësi Ekspozimet e lidhura me fëmijët Hapësira për motorikën globale Paisjet për motorikën globale</i>	5	4.25	5.6	4.4	4	2.75	4.3
Rutina e kujdesit personal	<i>Përshëndetjet / Përcjellja Vaktet e ngrënies Gjumi / Pushimi Përdorimi i tualetit Higjiena Siguria</i>	6.5	4.7	6.2	4	4.2	3.3	4.8
Komunikimi-Arsyetimi	<i>Librat dhe figurat Inkurajimi i fëmijëve për të komunikuar Përdorimi i gjuhës për të zhvilluar aftësitë e arsytimit Përdorimi informal i të folurës</i>	5.75	4.5	3.75	3.5	2.5	2.5	3.75
Aktivitetet	<i>Motorika fine Artet Muzika /Llëvizjet Kubat Rëra / Uji Pjesët teatrale Natyra / Shkenca Matematika / Numrat Përdotimi i TV, DVD dhe kompiuterave Promovimi i pranimit të diversitetit</i>	4.2	4.1	4	2.9	3.4	1.8	3.4
Ndërveprimet	<i>Mbikëqyrja e aktiviteteve të motorikës globale Mbikëqyrja e përgjithshme e fëmijëve Disiplina Ndërveprimi staf-fëmijë Ndërveprimi midis fëmijëve</i>	6.4	5.6	5.2	5	4.4	5	5.26
Struktura e programit	<i>Programi Loja e lirë Koha në grup Masat për fëmijët me hantikape</i>	5	4.75	3	3.5	3.25	5.5	4.2
Prindërit dhe stafi edukues	<i>Masat për prindërit Masat për nevojat personale të stafit Masat për nevojat profesionale të stafit Ndërveprimi dhe bashkëpunimi i stafit Mbikëqyrja dhe vlerësimi i stafit Mundësitë për rritje profesionale</i>	4.3	6.17	4.2	5.5	3.8	3.8	4.6
Pikëzimi mesatar total		5.1	4.8	4.65	4.05	3.7	3.26	4.3

III – Lidhja midis cilësisë së ambientit edukativ në të cilin rriten fëmijët dhe zhvillimit psikomotor të tyre.

Në të gjitha kopshtet e marra në studim kishte fëmijë me parametra psiko-metrikë jo komform stadi të zhvillimit të grup-moshës.

Në tabelën nr.3 janë paraqitur pikëzimet mesatare të

kapura nga vlerësimi i cilësisë së ambientit edukativ të kopshteve në studim dhe rastet (përqindjet) e vonesave të zhvillimit psikomotor tek fëmijët që frekuentojnë këto kopshte. Në bazë të të dhënave të kësaj tablele u llogarit koeficienti i korrelacionit Pearson për të vlerësuar lidhjen midis ambientit edukativ dhe nivelit të zhvillimit të fëmijëve.

Tab.3 - Shpërndarja e fëmijëve me vonesa zhvillimi sipas kopshteve në studim

Kopshtet	ECERS-R	Fëmijë pa asnjë vonesë në sektorët e zhvillimit		Fëmijë me vonesë në 1 sektor zhvillimi		Fëmijë me vonesë në ≥ 2 sektorë zhvillimi		Fëmijët me vonesë totale zhvillimi
		Numri	Përqindje	Numri	Përqindje	Numri	Përqindje	
Aulona	5.1	9	60%	4	27%	2	13%	0
Montesori	4.8	5	42%	4	33%	3	25%	1
Binjakët	4.65	4	29%	6	43%	4	28.5%	0
No. 10	4.05	18	37.5%	19	40%	11	23%	0
Teli Ndini	3.7	5	23%	7	32%	10	45.5%	2
No. 8	3.26	12	40%	6	20%	12	40%	0
TOTAL	4.3	53	37%	46	33%	42	30%	3 = 2%
		r = +0.52, P>0.05		r = +0.36, P>0.05		r = -0.82, P<0.05		

Nga përpunimi i të dhënave të studimit tonë nuk duket se ka lidhje statistikisht të rëndësishme midis ambientit edukativ dhe përqindjes së fëmijëve me një ose asnjë vonesë zhvillimi. Ndërsa, koeficienti i korrelacionit Pearson midis cilësisë së ambientit edukues dhe përqindjes së vonesave në ≥ 2 sektorë zhvillimi u gjet $r = -0.82, P < 0.05 (P = 0.043/0.022)$.

Figura nr.1 paraqet Regresioni linear Alpha (y-intercept) = 88. Regresioni linear Beta (slope) = -13.8.

Në tabelën nr.4 paraqiten përqindjet e parametrave




Fig.1 Modeli i regresionit linear per ndikimin e ambientit edukativ mbi vonesat e zhvillimit psikomotor.

psikometrikë jonormalë për secilin nga sektorët e testit ASQ-3 sipas kopshteve që frekuentojnë fëmijët.

Përqindjen më të lartë të vonesave psikomotore pothuaj në të gjithë sektorët e paraqet kopshti Teli Ndini.

Duke i marrë me rradhë: kopshti Aulona përqindjen më të lartë të vonesave e ka në sektorët e Motorikës globale dhe fine, si dhe në Aftësinë për të zgjidhur problemet (13%). Kopshtet Montesori, Teli Ndini dhe Nr.10 sektorin më problematik kanë Sektorin personal-social (respektivisht 42%, 52% dhe 37.5%). Dy sektorët më problematikë të kopshtit Binjakët janë Komunikimi dhe Aftësia për të zgjidhur problemet (36%). Kopshti nr.8 sektorin me përqindjen më të lartë të vonesave ka sektorin e Komunikimit (33%).

Nëse analizojmë vonesat sipas parametrave psikometrikë shohim se në sektorin e Komunikimit dhe të Zgjidhjes së Problemeve përqindjet më të larta të fëmijëve që nuk janë në nivelin e zhvillimit të grup-moshës i kanë kopshtet Binjakët dhe Teli Ndini (36%-41%). Përqindja më e lartë e fëmijëve me Motorikë globale jo komform grup-moshës u vu re tek kopshti Binjakët (21%). Në sektorin e Motorikës fine dhe Personal-social përqindjet më të larta të vonesave i kishin kopshtet Montesori dhe Teli Ndini (nga 25% deri në 52%).

Tab.4 - Shpërndarja sipas kopshteve e fëmijëve me parametra psiko-metrikë afër dhe nën minimumin e zhvillimit të grup-moshës (në bazë të pikëzimit të kapur në sektorët e ASQ-3).

Kopshtet	ECERS-R	Komunikimi		Motorika globale		Motorika fine		Aftësia për të zgjidhur problemet		Sektori personal-social	
		1	7%	2	13%	2	13%	2	13%	1	7%
Aulona	5.1	1	7%	2	13%	2	13%	2	13%	1	7%
Montesori	4.8	3	25%	1	8%	3	25%	4	33%	5	42%
Binjakët	4.65	5	36%	3	21%	3	21%	5	36%	3	21%
No. 10	4.05	5	11%	9	19%	8	17%	10	21%	18	37.5%
Teli Ndini	3.7	8	36%	4	18%	7	32%	9	41%	11	52%
No. 8	3.26	10	33%	5	17%	5	17%	8	27%	7	23%
TOTAL	4.3	32	23%	24	17%	28	20%	38	27%	45	32%

DISKUTIMI

Nga ky vlerësim depistues i nivelit psikomotor të fëmijëve parashkollorë të qytetit të Vlorës u konstatua një përqindje shqetësuese e fëmijëve me vonesa zhvillimi (63%). 30% prej tyre kishin vonesa zhvillimi në më shumë se 1 sektor, dhe kjo përqindje përbën sigurisht kontigjentin më problematik me të cilët duhet bërë një punë e personalizuar. Por edhe përqindja e parashkollorëve me vonesë vetëm në një sektor zhvillimi (33%), që nënkupton fëmijët me kapacitete krejtësisht normale, por të cilët nuk janë stimuluar mjaftueshëm për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, ngre një pikëpyetje të madhe mbi mjaftueshmërinë e suportit informal të familjes apo suportin formal të institucionit ku edukohen këta fëmijë.

Siç mund të vërehet në tabelën nr.1 ka një përqindje shumë të lartë fëmijësh me pikëzim afër minimumit të kërkuar në të gjithë parametrat psikometrikë, që nënvizon sërish punën e pamjaftueshme që bëhet me këta fëmijë për ti stimuluar e motivuar të realizojnë aktivitetet normale të stadiit të zhvillimit. Një nga treguesit më negativë të punës së pamjaftueshme që bëhet me këta fëmijë është përqindja shumë e lartë e pikëzimit afër minimumit në Sektorin Personal-Social (23%) ku instruktimi dhe motivimi janë faktorët kryesorë që çojnë në përvetsimin e rutinës së përditshme dhe vendosjes së ndërveprimeve sociale.

Nëse analizojmë përqindjet e fëmijëve me parametra psikometrikë nën minimumin e pikëve të stadiit të zhvillimit shohim se janë relativisht përqindje të konsiderueshme, që variojnë 5-9%. Përqindjet më të ulta të vonesave të

zhvillimit i kanë sektorët e Motorikës globale dhe fine (6% dhe 5%) ndërsa në sektorët e tjerë të Komunikimit, Zgjidhjes së Problemeve dhe Sektorit personal-social 9% e fëmijëve kanë vonesa të rëndësishme zhvillimi.

Duhet të kemi parasysh që ASQ-3 është një test depistues, pra këta fëmijë konsiderohen normale dhe do të lejohen të futen në shkollë si fëmijët e tjerë, ndërkohë që nuk i kanë kapacitetet normale të stadiit të zhvillimit të grup-moshës së tyre dhe nuk do të kenë të njëjtat mundësi për të patur rezultate shkollorë si fëmijët e tjerë. Në këtë aspekt shifrat 30% e parashkollorëve kanë ≥ 2 vonesa psikometrike dhe 9% kanë pikëzim nën minimumin e nevojshëm të stadiit të zhvillimit në 3 nga 5 parametrat psikometrikë të testuar, janë me të vërtetë shqetësuese.

Përsa i përket vlerësimit të cilësisë së ambientit edukues të kopshteve të qytetit të Vlorës pikëzimi mesatar 4.3 në total është një pikëzim midis mjaftueshëm dhe mirë, që mund të konsiderohet i kënaqshëm për një vend me nivelin e zhvillimit të Shqipërisë. Por po të bëjmë një analizë më të detajuar të nëngrupeve të klasifikimit, do të shohim se pikët e larta kapen në sektorë të tillë si mbikëqyrja e fëmijëve, lejimi i kohës së lirë me aktivitete sipas dëshirës apo disponimi i hapësirave dhe paisjeve të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të motorikës globale e fine (që reflektohet edhe në përqindjet më të ulta të vonesave në këta dy sektorë). Kjo e fundit, veç të tjerash mundësohet nga fakti se 3 prej kopshteve janë privatë, ndërsa 2 prej kopshteve publike janë rikonstruktuar dhe paisur nga donacione shtetërore apo private.

Ndërkohë vijnë shumë shqetësuese pikët e ulta në sektorët e Komunikim/Arsyetimit dhe Aktiviteteve që janë përcaktuese në instruktimin dhe motivimin e fëmijëve në parametrat psikometrikë të Komunikimit dhe Zgjidhjes së problemeve, çka reflektohet edhe në përqindjet e larta të vonesave në këta sektorë dhe bën të nevojshëm rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit në drejtim të stimulimit psikomotor të fëmijëve. Këto rezultate mbështesin padyshim konkluzionin edhe të studimeve të tjera në këtë fushë (11,12) se vonesat e zhvillimit psikomotor të këtyre fëmijëve duket se shkaktohen nga suporti i pamjaftueshëm formal i kopshteve ku ata edukohen.

Duke analizuar në total lidhjen midis rankimit të kopshteve në klasifikimin ECERS-R dhe përqindjes së fëmijëve me ≥ 2 vonesa psikomotorë, vihet re qartë trendi për uljen e kësaj përqindjeje me rritjen e cilësisë së kopshteve, që përforcon akoma më tepër konkluzionet e nxjerra më sipër nga ky studim apo edhe nga studimet e bëra në vendet e tjera (2,8).

Devijacionin më të madh të variancës që vërehet tek ky trend e ka kopshti Teli Ndini (i rikonstruktuar dhe pajisur nga fonde shtetërore), ku me gjithë pikët e larta në cilësinë e ambientit edukativ, është kopshti me përqindjet më të larta të vonesave psikomotorë në total dhe pothuaj në të gjithë sektorët psikometrikë më vete. Kjo sepse, ashtu si konkordojnë edhe shumë studiuës të ndryshëm (3,9), zhvillimi psikomotor i fëmijës ndikohet gjithashtu së tepërmi edhe nga statusi socio-ekonomik dhe inteligjenca verbale e nënës, që në vlerësimin e zhvillimit psikomotor të fëmijëve të këtij kopshti kanë një peshë të konsiderueshme si faktorë konfondues.

KONKLuzionET

Niveli i parametrave psikometrikë tek fëmijët e qytetit të Vlorës lë për të dëshëruar. 63% e fëmijëve paraqesin vonesa zhvillimi psikomotor në të paktën 1 sektor psikometrik, 30% në 2 apo më shumë sektorë dhe 2% e fëmijëve kanë zhvillim psikomotor total nën minimalen e grup-moshës. Sektori psikomotor me përqindjen më të ulët të zhvillimit konform grup-moshës është sektori Personal-Social (32% vonesa psikomotorë) ndërsa Motorika globale është sektori me përqindjen më të lartë të zhvillimit normal (17% vonesa).

Në total kopshtet e marra në studim në qytetin e Vlorës paraqesin një pikëzim mesatar prej 4.3 pikësh, që është një nivel jo vetëm mbi 'minimalen', por edhe afër vlerësimit 'mirë'. Kopshtet private kanë pikëzim më të lartë se

kopshtet publike. Nëngrupi i shkallës klasifikuese ECERS-R me pikëzimin më të lartë për të gjitha kopshtet ishte nëngrupi 'Ndërveprimet' me 5.26 pikë. Ndërsa pikëzimin më të ulët e kishin nëngrupet Komunikimi/Arsyetimi dhe Aktivitetet (respektivisht me 3.75 dhe 3.4 pikë).

Nga përpunimi i të dhënave të studimit tonë nuk duket se ka lidhje statistiki të rëndësishme midis ambientit edukativ dhe përqindjes së fëmijëve me një ose asnjë vonesë zhvillimi. Ndërkaq duket se ka një trend të dukshëm të rritjes së përqindjes së fëmijëve me vonesa në ≥ 2 sektorë zhvillimi dhe uljes së cilësisë së ambientit edukativ ($r = -0.82, P < 0.05$).

REKOMANDIMET

Fusha e zhvillimit psikomotor është një fushë e pavlerësuar dhe e paeksploruar si duhet. Kërkime të mëtejshme duhet të realizohen në këtë drejtim me anë të studimeve screening apo analitike.

Vlerësimi i zhvillimit psikomotor të fëmijëve duhet të kryhet periodikisht, me anë të testeve psikometrike profesionale dhe jo në mënyrë intuitive. Plani i instruktimit dhe motivimit psikomotor të fëmijëve duhet të jetë i personalizuar (një-për-një) dhe i specializuar.

Trajnimi i stafit të kopshteve për realizimin e vlerësimit psiko-motor dhe rritja e kapaciteteve në stimulimin psikomotor të fëmijëve duhet të jetë pjesë e objektivave imediate të veprimtarisë së arsimit parashkollor.

REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

1. Aylward GP. *Developmental screening and assessment: what are we thinking?* J Dev Behav Pediatr. 2009;30(2):169-173.
2. Deborah Lowe Vandell and Barbara Wolfe. *Child Care Quality: Does It Matter and Does It Need to be Improved?* Institute for Research on Poverty University of Wisconsin-Madison (2000)
3. Elise Roze, Lisethe Meijer, Koenraad NJA van Braeckel. *Developmental trajectories from birth to school age in healthy term-born children.* Pediatrics 2010;126:e1134: doi:10.1542/peds.2010-0698. Retrieved from <http://pediatrics.aappublications.org/content/126/5/e1134.full.html>
4. Gauvain M, Munroe RL. *Child Dev. Contributions of societal modernity to cognitive development: a comparison of four cultures.* 2009 Nov-Dec;80(6):1628-42.
5. Guadarrama-Celaya F, et al. *Public Health Nurs. Screening of neurodevelopmental delays in four communities*

- of Mexico and Cuba. 2012 Mar-Apr;29(2):105-15. doi: 10.1111/j.1525-1446.2011.00982.x. Epub 2011 Oct 5.
6. Harris Thelma, Clifford Richard M., Cryer Debby. Teachers College, Columbia University. (2005) **Early childhood environment rating scale – revised edition**. ISBN – 13 978-0-8077-4549-6.
 7. Murray GK, Jones PB, Kuh D, Richards M. *Infant developmental milestones and subsequent cognitive function*. Ann neurol. 2007;62(2):128-136.
 8. National Scientific Council on the Developing Child. *The science of early childhood development: closing the gap between what we know and what we do*. <http://www.developingchild.net> (2007)
 9. Noble KG, McCandliss BD, Farah MJ. *Socio-economic gradients predict individual differences in neurocognitive abilities*. Dev Sci. 2007;10(4)464-480.
 10. Plek JP, Dawson L, Smith LM, Gasson N. *The role of early fine and gross motor development on later motor and cognitive ability*. Hum Mov Sci. 2008;27(5):668-681.
 11. Robinson LE, Rudisill ME, Goodway JD. Res Q Exerc Sport. *Instructional climates in preschool children who are at-risk. Part II: perceived physical competence*. 2009 Sep;80(3):543-51.
 12. Robinson LE, Goodway JD. Res Q Exerc Sport. *Instructional climates in preschool children who are at-risk. Part I: object-control skill development*. 2009 Sep;80(3):533-42.
 13. Squires Jane, Ph.D, Twombly Elizabeth, M.S., Bricher Diane, Ph.D, Potter LaWanda, M.S. (2009). *Ages & Stages Questionnaires – A parent-Completed Child Monitoring System, third edition. Psychometric studies of ASQ*. Retrieved from http://agesandstages.com/pdfs/asq3_technical_report.pdf.

THE IMPACT OF LEARNING ENVIRONMENT IN THE PSYCHOMOTOR DEVELOPMENT OF PRESCHOOLERS IN VLORA, ALBANIA

Aurela Saliaj¹, Ermira Kola², Lorena Lazaj³, Dona Manaj³

¹Mother&Child Care Department, Faculty of Public Health, University of Vlora, Albania.

²Intensive care unit, Pediatric Hospital, University Centre ‘Mother Theresa’, Tirana, Albania

³ Faculty of Public Health, University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania.

ABSTRACT

The assessment of preschooler's psychometric parameters is an important part of the growth&development evaluation of children at this age and unfortunately the most neglected. Furthermore the investment of the society in early childhood is fundamental for the full potential development in their adult life. One of the most important contributing factors in children psychomotor development is the stimulation and the motivation from the learning environment in the kindergartens where they spend the most part of their day.

Using a cross-sectional approach we assessed the level of psychomotor development of preschoolers enrolled in some of the public and private kindergartens in the city of Vlora, and evaluated their quality of learning environment through the international standardized tests and rates.

In the end of this study we noticed that the percentage of preschool children with psychometric delays was considerable in almost all kindergartens under the study, their care and learning environment in general was rated as above minimal (near good), and that exist a statistically significant relationship between quality of care environment and the percentage of children with 2 or more psychomotor delays for the age-group.

Key words: psychometric parameters, psychomotor development, early care environment, kindergartens of city of Vlora, Albania.

VLERESIMI I FAKTOREVE ETILOGJIKE NE TELOGEN EFFLUVIUM

Albana Lufi¹, Loreta Kuneshka², Ermira Vasili³

¹ Spitali Ushtarak Qendror Universitar

² Departamenti i Shendetit Publik Fakulteti i Mjekesise Tirane

³ Klinika e Dermatologjise QSUT "Nene Tereza"

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 78-85

HYRJE

Renia difuze e flokeve ne te gjithë siperfaqen e kokës perben ate qe ne e quajme deffluvium ose effluvium capelli. Kjo renie mund te jete e tipit imediat (effluvium anagen distofik) ose e tipit te vonshem (alopecia telogenike).

Qellimi: Vlerësimi i ndikimit te patologjiave te tiroides, të anemise, te stresit, te medikamenteve te perdorura per probleme te tjera, te semundjeve shoqeruese lokale te scalpit ose sistemike, dietes se mbajtur per te rene ne peshe dhe faktoreve ekzogjene ne telogen effluvium.

Materiali dhe metoda: Jane marre ne studim 219 paciente me diagnozen telogen effluvium dhe 219 paciente te perdorur si grup kontolli te paraqitur ne sherbimin ampulator te SUQU gjate periudhes janar 2010-mentor 2011. Per grup kontrolli jane perdorur paciente te cilet jane paraqitur tek dermatologu per probleme te tjera dhe nuk referonin renie te flokeve.

Rezultatet: Ne telogen effluvium crregullimet e tiroides jane hasur ne 17.8% te pacienteve, anemia ne 40.2%, stresi fizik dhe psikologjik ne 28.7%, kane perdorur medikamente 8.7% e pacienteve, semundje shoqeruese kane paraqitur rreth 25.1% e pacienteve, dieta eshte gjetur ne 20.1% te rasteve dhe faktoret ekzogjene kane ndikuar ne 2.7% te rasteve.

Konkluzioni: Anemia, crregullimet e tiroides, stresi, dhe semundjet shoqeruese ndikuan ne shfaqjen e telogen effluvium. Perdorimi i medikamenteve, dietat e mbajtura per te rene ne peshe dhe faktoret ekzogjene nuk ndikuan ne shfaqjen e telogen effluvium.

Fjale kyç: Telogen effluvium, faktoret e mundshem etiologjike

DISA TE DHENA MBI TELOGEN EFFLUVIUM

Defluvium capelli eshte patologji qe haset shpesh ne praktiken e perditshme te mjekëve dermatologje, ze vendin e dyte ne reniet e flokeve pas alopecise androgjenike dhe shkakton shpeshhere stres mjaft te madh tek pacientet. Vlen te theksojme se 1.7% e popullates zhvillon nje forme te renieve te flokeve gjate gjithë jetes se tyre.

Rritja gjithmone e me teper e numrit te rasteve me defluvium capelli na shtyn ta studiojme me teper kete patologji kryesisht ne aspektin etiologjik per te patur rezultate sa me te mira ne trajtimin e saj.

Per te kuptuar patogjenezën e effluvium capelli fillimisht po japin disa te dhena per ciklin e rritjes se flokeve.

Flokët nuk rriten ne menyre te vazhdueshme, por cdo folikul i pa sinkronizuar me folikujt e tjere ndjek nje ritëm ciklik me faza rritje dhe pushimi. Ne pushim te cdo faze

pushimi floku bie dhe fillon nje faze e re me formimin e nje floku te ri. Shumica e njerezve kane 100.000 fije floku dhe 10 deri 15 % e ketyre flokeve jane ne fazën telogene¹. Renia e 100 fije telogene ne dite eshte normale². Renia e flokeve anagene asnjehere nuk eshte normale. Renia e flokeve vjen si pasoje e nderprerjes se nje nga fazat e ciklit flokut^{3,4}

Dallohen tre faza ne ciklin e rritjes se flokut^{2,4}:

- 1.Faza anagene ose faza e rritjes.
- 2.Faza katagene ose faza tranzitore.
- 3.Faza telogene ose faza e pushimit.

Faza anagene: Floku se bashku me medulen, korteksin, kutikulen, dhe pjesen e thelle te rrenjes, formohen nga nje sasi e vazhdueshme mitozash. Ne kete faze cdo flok human rritet rreth 0.35mm ne dite dhe qendron per rreth 2-8 vjet⁵. Floku ne kete faze nuk bie vete dhe mund ta shkepusesh vetem me dhimbje.

Faza katagene: Kjo faze zgjat 4- 6 jave, papritur mitozat ndalojne, bulbi keratinizohet dhe floku pergatitet per ne fazen telogene.

Faza telogene: Kjo faze zgjat 2-3 muaj 5. Floku ne kete faze mund te shkeputet pa dhimbje. Ne fund te fazes floku bie vete ose mbetet ne kreher gjate krehjes.

Cikli i flokeve eshte i percaktuar gjenetikiisht per cdo folikul te flokeve, per cdo individ dhe per cdo zone te trupit.

Defluvium capelli mund te jete e tipit imediat effluvium (anagen distofik) ose e tipit te vonshem (alopecia telogenike).

ALOPECIA E TIPIT IMEDIAT OSE EFFLUVIUM ANAGEN DISTROFIKE

Gjate fazes anagene matriksi i flokeve ka nje aktivitet shume te larte mitotik dhe ne kete faze eshte vecanerisht sensitiv ndaj toksicitetit. Shume demtime serioze te folikujve ne kete faze cojne brenda disa oreve ose diteve kalimin e folikujve nga nje faze normale anagene ne nje faze anormale distrofike anagene. Frenohet aktiviteti metabolik dhe mitozat e shtuara, qe cojne ne ulje te madhesisse te matriksit floke- formues dhe si rezultat floku bie si nje flok anagen distrofik. Floket mund te bien brenda pak diteve pas demtimit. Trichograma tregon nje perqindje normale te flokeve ne fazen telogene por nje ulje te flokeve anagen normal dhe nje rritje relative te flokeve anagen distrofik (norma 1-2%).

ALOPECIA E TIPIT TE VONSHEM E NJOHUR SI TELOGEN EFFLUVIUM OSE ALOPECIA TELOGENIKE

Gjate fazes inaktive mitotike (fazes telogene) folikuli i flokut eshte jo sensitiv. Demtim i lehte ne matriksin e flokut ne fazan anagene con ne nje perfundim premature por fiziologjik te fazes anagene me kalim te folikulit ne fazen telogene. Keto floke te skalpit bien ne fund te fazes telogene. Telogen effluvium nuk zhvillohet deri 2-4 muaj pas ngjarjes demtuese. Trichograma eshte e alternuar ne favor te flokeve ne fazen telogene.

SHKAKTARET ME TE SHPESHTE TE ALOPECISE TE TIPIT IMEDIAT

- Kimioterapia

Pas nje doze kimioterapie floket bien disa dite- 3jave pasi ka filluar kimioterapia dhe behet mjaft e dukshme

1-2 muaj me von. Floket e kokes jane ne pergjithesi me te prekur, por te gjithë floket e trupit duke perfshire qerpiket dhe vetullat mund te preken⁶

- Radioterapia⁷
- Citostatiket⁶
- Helmimi nga metalet e renda dhe helmimet me acid borik⁸ ;
- Situatat me stres emocional te rende.

TELOGEN EFFLUVIUM (ALOPECIA E TIPIT TE VONSHEM)

Demtim i lehte ne matriksin e flokut ne fazan anagene con ne nje perfundim premature por fiziologjik te fazes anagene me kalim te folikulit ne fazen telogene⁹. Keto floke te skalpit bien ne fund te fazes telogene. Telogen effluvium nuk zhvillohet deri 2-4 muaj pas ngjarjes demtuese. Zakonisht mbi 100 fije bien cdo dite dhe kjo periudhe renie mund te zgjase nga 6 muaj - 6 vjet ose me shume nese shkaku vazhdon te persistoje dhe rezulton me nje ndryshim dramatik te paraqitjes se personit¹⁰. Trichograma eshte e alternuar ne favor te flokeve ne fazen telogene.

Telogen effluvium akut eshte percaktuar renia qe zgjat me pak se 6 muaj¹¹. Telogen effluvium kronik eshte percaktuar renia qe zgjat me shume se 6 muaj¹²

SHKAKTARET ME TE SHPESHTE TE TELOGEN EFFLUVIUM

- Alopecia post partum
- Crregullimet e tiroides hypo dhe hipertireoza¹³ (me shpesh hypotireoza)
- Sindromi i Ovarit Policistik^{14,15} (PCO)
- Mungesa e hekurit
- Infeksionet e shoqeruara me temperature te larte si Ethja tifoide, Influenca, Sifilizi sekundar, Erizipela¹⁶.
- Stresi psikologjik (fizik) si traumat kirurgjikale¹⁶, temperaturat e larta, semundjet kronike sistemike.
- Stresi emocional i rendesishem (vdekje, divorc, falimentim).
- Stadet e hershme te alopecise androgjenike¹⁸ Alopecia androgjenike ne stadet e para te saj prezantohet si telogen effluvium para se ajo te shfaqe kliniken e saj tipike.
- Fillimi dhe nderprerja e kontrceptiveve orale¹⁹.

- Semundjet akute psikiatrike.
- Semundjet kronike sistemike si amiloidoza sistemike¹⁵, Eritrodermia, Dermatomioziti, Lupusi sistematik, Diabeti melitus, semundje qe cojne ne kaheksi, AIDS, tumore, semundjet hepatike, morbus Crohn's¹⁶
- Semundjet inflamatore te kokes si psoriasis, dermatit seborhoik dhe dermatiti alergjik i kontaktit^{11,20}.
- Faktoret dietetike si mungesa e zinkut dhe e biotines^{15,17}, deficienca e acideve te rendesishme yndyrore, sindroma e malabsorbimit, mungesa e vitamines D.
- Dietat drastike dhe uljet e medha ne peshe per nje kohe te shkurter.
- Medikamentet per probleme te tjera .
- Demtimet ekzogjene te flokut si dekolorimet, permanenti.

Qellimi i studimit: Vlerësimi i ndikimit te patologjive te tiroides, të anemise, te stresit, te medikamenteve te perdorura per probleme te tjera, te semundjeve shoqeruese lokale te scalpit ose sistemike, dietes se mbajtur per te rene ne peshe dhe faktoreve ekzogjene ne telogen effluvium.

Materiali dhe metoda: Jane marre ne studim 219 paciente me diagnozen telogen effluvium prej te cileve 197 femra dhe 22 meshkuj dhe 219 paciente te perdorur si grup kontolli (165 femra dhe 54 meshkuj) te paraqitur ne sherbimin ampulator te SUQU gjate periudhes janar 2010-mentor 2011. Per grup kontrolli jane perdorur paciente te cilet jane paraqitur tek dermatologu per probleme te tjera si ekzema , pityriasis versicolor, lichen planus , acne vulgaris , infeksione mykotike , bakteriale dhe virale .Pacientet e grupit te kontrollit nuk referonin renie te flokeve. Per secilin pacient u plotesua nje pyetesor sipas te cilit pacientet duhet te kryenin nje sere ekzaminimesh dhe konsultash

si: niveli i ferritines, dozimi i hormoneve te tiroides, AAN, testi HIV, pyetje rreth semundjeve te tjera shoqeruese, medikamentet e perdorura per probleme te tjera, pyetje rreth stresit , dietes e anamnezes familjare. I njejti pyetesor u perdor dhe per pacientet e perdorur si grup kontrolli.

Tipi i studimit: kros-seksional (transversal).

Regresioni logjistik binar u përdor për vlerësimin e lidhjeve mes faktorëve te riskut dhe shfaqjes se semundjes.


REZULTATET E STUDIMIT

Tabela nr 1

Faktoret e riskut	Grupi I studimit		Grupi I kontrollit		p
	N	%	N	%	
Çrregullimet e tiroides	39	17.8	10	4.56	p=0.032
Hipertireoze	20	9.1	5	2.28	
Hypotireoze	19	8.7	5	2.28	
Anemia	88	40.2	27	12.4	p=0.009
Stresi fizik	63	28.7	12	5.4	p=0.039
emocional	11	5			
Semundje shoqeruese	52	23.7	12	5.4	p=0.01
lupus	55	25.1	13	6	
diabeti melitus	8	3.7			
psoriasis capitis	3	1.4	11	5	
dermatiti seboroik	13	5.8	1	0.5	p=0.44
Medikamentet e perdorura	31	14.2	1	0.5	
Antidepressive	19	8.7	10	4.6	
Izotretinoine	4	1.8			
Kontraceptive	3	1.4	1	0.5	
Terbinafine	9	4.1	3	1.4	p=0.07
Dieta	3	1.4	6	2.7	
Faktore ekzogjene	44	20.1	10	4.6	
Dekolorim	6	2.7	3	1.4	p=0.705
Permanent	4	1.8			
	2	0.9	3	1.4	

Ne tabelen nr 1 pasqyrohet numri dhe perqindja e faktoreve te riskut ne grupin e te semureve dhe ne grupin e kontrollit. Kollona e p ne tabele tregon nese kane qene ose jo sinjifikante faktoret e riskut ne grupin e te semureve.

Grafiku 1




Ne grafikun 1 kemi paraqitur crregullimet e funksionit te tiroides ne pacientet e grupit te studimit me telogen effluvium dhe ne grupin e kontrollit.

Crregullimet e funksionit te tiroides jane hasur ne 17.8% te pacienteve te grupit te studimit. Hipertireoza eshte hasur ne 9.1% (20 paciente)dhe hypotireoza ne 8.7%, (19 paciente)kurse ne grupin e kontrollit crregullimet e tiroides jane hasur ne 4.56% ku hipertireoza eshte gjetur ne 2,28%(5 paciente) dhe hypotireoza ne 2,28%(5 paciente).

Pas analizes me regresion logjistik u pa qe crregullimet e tiroides jane faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p= 0.032$


Grafiku 2



Ne grafikun 2 kemi paraqitur pranine e anemise ne grupin e studimit me telogen effluvium dhe ne grupin e kontrollit. Ne grupin e studimit anemia eshte vene re ne 40,2% ose ne 88 paciente, kurse ne grupin e kontrollit anemia eshte gjetur ne 12,4% ose ne 27 paciente.


Pas analizes me regresion logjistik u pa anemia eshte faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p= 0.009$

Grafiku 3



Ne grafikun 3 kemi paraqitur pranine e stresit ne grupin e studimit me telogen effluvium dhe ne grupin e kontrollit. Stresi eshte hasur ne 28.7% (ose ne 63 paciente) ne grupit te studimit ku 5% (ose 11 paciente) e perben stresi fizik dhe 23,7% (52 paciente) stresi emocional. Kurse ne grupin e kontrollit stresi eshte vene re ne 5.4 % (12 paciente) dhe ky eshte stress emocional. Pas analizes me regresion logjistik u pa se stresi eshte faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p=0,039$

Grafiku 4




Ne grafikun 4 kemi paraqitur ndikim e semundjeve shoqeruese ne grupin e studimit pra ne pacientet me telogen effluvium dhe pranine e ketyre semundjeve shoqeruese ne grupin e kontrollit.

Semundje shoqeruese kane paraqitur 25,1% e pacienteve te grupit te studimit. Lupusi sistemik eshte vene re ne 3.7%(8 paciente),diabeti mellitus ne 1.4% (3 paciente),psoriasis capitis ne 5.8% (13 paciente)dhe dermatit seboroik ne 14.2% (ose 32 paciente)

Ne grupin e kontrollit semundje shoqeruese kane paraqitur 6% e pacienteve prej te cileve: diabeti melitus eshte hasur ne 5% (11 paciente), psoriasis capitis ne 0.5%, (1 pacient) dermatiti seboroik ne 0.5%(1 pacient).

Pas analizës me regresion logjistik u pa se semundjet shoqeruese janë faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p=0,01$

Grafiku 5




Ne grafikun 5 kemi paraqitur ndikimin e medikamenteve te perdorura per probleme te tjera nga pacientet e grupit te studimit me telogen effluvium dhe nga grupi i kontrollit

Kane perdorur medikamente 8.7% e pacienteve te grupit te studimit. 1.8% e pacienteve (4 paciente) kane perdorur medikamente antidepresive, 1.4% (3 paciente) kane perdorur Izotretinoine, 4.1% (9 paciente) kane perdorur kontraceptive dhe 1.4% e pacienteve (3 paciente) kane perdorur Terbinafine.

Ne grupin e kontrollit kane perdorur medikamente per probleme te tjera 4.6% e pacienteve. 0.5% (1 pacient) ka perdorur izotretinoine, 1.4% (3 paciente) kane perdorur kontraceptive dhe 2.7% e grupit te kontrollit (6 paciente) kane perdorur Terbinafine.

Pas analizës me regresion logjistik u pa se perdorimi i medikamenteve rezultoi faktor jo sinjifikant ne telogen effluvium $p=0,44$

Grafiku 6




Ne grafikun 6 kemi paraqitur ndikimin e dietes ne pacientet e grupit te studimit me telogen effluvium, dhe pranine e dietes ne grupin e kontrollit .

20.1% e pacienteve te grupit te studimit (44 paciente) kane mbajtur diete per renie ne peshe, kurse ne grupin e kontrollit diete kane mbajtur 4.6% (10 paciente) .

Pas analizës me regresion logjistik u pa se dieta rezultoi faktor jo sinjifikant ne telogen effluvium $p=0,07$

Grafiku 7



Ne grafikun 7 kemi paraqitur ndikimin e faktoreve ekzogjene ne pacientet e grupit te studimit me telogen effluvium, dhe pranine e ketyre faktoreve ne grupin e kontrollit.

Faktoret ekzogjene kane qene te pranishem ne 2.7% te pacienteve te grupit te studimit ku dekolorimi perbente 1.8% (4 paciente) dhe permanenti 0.9% (2 paciente). Ne grupin e kontrollit faktoret ekzogjene kane qene te pranishem ne 1.4% (3 paciente).

Pas analizës me regresion logjistik u pa se faktoret ekzogjene rezultuan faktor jo sinjifikant ne telogen effluvium $p=0,705$

DISKUTIMI

Defluvium capelli është patologji që haset shpesh ne praktiken e perditshme te mjekeve dermatologe, vjen e dyta pas alopecise androgjenike dhe shkakton shpeshhere stres mjaft te madh tek pacientet.

Hormonet e tiroides kane nje ndikim te madh ne metabolizmin qelizor te proteinave, karbohidrateve, yndyrave dhe mineraleve. Qelizat e matrixit te flokeve, per shkak te shkalles se larte te veprimtarise metabolike jane mjaft te ndikuara nga mungesa ose

prodhimi i tepert i hormoneve te tiroides sepse folikujt e flokeve kane receptore per hormonet e tiroides vecanerisht per triiodothyronine (T_3). Ne studimin tone crregullimet e tiroides jane hasur ne 17.8% ose ne 39 paciente ku hipertireoza eshte hasur ne 9.1% (20 paciente)dhe hypotireoza ne 8.7%, (19 paciente)dhe pas analizes me regresion logjistik u pa qe crregullimet e tiroides jane faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p=0.032$.

Hekuri luan nje rol te rendesishem ne organizem kryesisht ne prodhimin e hemoglobines, mioglobulines ,oxigjenimin e ruazave te kuqe te gjakut ,gjithashtu ai luan rol kryesor per rritjen dhe mirembajtjen e flokeve. Reniet e flokeve si pasoje e mungeses se hekurit haset me teper ne grate e reja me cikël menstrual te zgjatur ose tek femrat qe bejne diete dhe shume rralle tek burrat. Ne studimin tone anemia eshte hasur ne 40.2% ose ne 88 paciente (79 femra dhe 9 meshkuj)dhe pas analizes me regresion logjistik u pa qe anemia eshte faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p=0.009$.

Lidhjet ndermjet stresit emocional dhe renieve te flokeve eshte shpesh here veshtire te percaktohet dhe renia e flokut shpesh here perben stres per pacientin. Ka mjaft te dhena per lidhjen midis stresit emocional madhor dhe renieve te flokeve. Stresi ka qene prej kohesh si nje faktor i rendesishem ne reniet e flokeve (Bosse and Gieler ,1987,PAUS,200 Botcharev 2003). Megjithate lidhjet midis renieve difuze kronike te flokeve dhe stresit psikologjik jane disa here kontradiktore¹⁷. Evidencat per kete lidhje jane te pakta dhe stresi i perditeshem eshte i pamjaftueshem si shkak i renies se flokeve^{12,15}. Ne studimin tone stresi eshte hasur ne 28.7% ose ne 63 paciente dhe pas analizes me regresion logjistik u pa se eshte faktor sinjifikant ne telogen effluvium $p=0.039$.

Renia e flokeve ndodh në rreth 45 për qind të njerëzve me lupus gjatë dekursit së sëmundjes së tyre. Më shpesh renia e flokëve ndodh në fillimin e sëmundjes, dhe mund të jetë një nga simptomat e para të sëmundjes të njohura nga personi. Renia e flokeve ne me te shumten e rasteve është e shperndare ne gjithe siperfaqien e kokes por ndonjëherë flokët bien dhe me vatra . Kur sëmundja është sjellë nën kontroll, flokët rriten përsëri. Ndonjëherë ne pacientet me lupus vihet re një skuqje të lëkurës e kokës, zakonisht ne lupusin subacut ose kronik dhe ne keto raste alopecia eshte e perhershme.

Edhe diabeti melitus shoqerohet shpesh here me renie te flokeve. Humbja e shpeshtë e flokëve është konsideruar

shpesh një nga simptomat e para të diabetit, i cili kërkon trajtim të menjëhershëm, në mënyrë që të shmangen ndërlikimet e mëtejshme. Diabeti shkakton qarkullim të dobët të gjakut. Qarkullimi i dobët i gjakut mund të ndikojë në aftësinë e folikujve te flokëve për të vepruar normalisht. Në kushte normale, flokët rritet për 2-6 vjet, pastaj floku shkon në fazen katagene , dhe përfundimisht ai bie dhe floke i ri prodhohet per te zvendesuar ate qe bie. Kur qarkullimi i gjakut është i varfër, gjëndra e flokut nuk eshte ne gjendje te prodhoje floke te rinj per te zvendesuar floket qe bien dhe si rrjedhim floket jane me te holle dhe me te ralle. Stresi është i lidhur direkt me diabetin dhe me renien e flokeve .Diabeti si sëmundje shkakton stres dhe ankth të tepërt, e cila nga ana tjetër bëhet shkak i renies së flokëve. Gjithashtu medikamentet qe perdoren per te trajtuar diabetin mund te shkaktojne renie te flokeve por kjo zakonisht eshte individuale, dhe çdo njeri reagon ndryshe për medikamente specifike.

Psoriasis dhe dermatiti seboroik i kokës ne format e shprehura mund të shkaktojnë renie te flokeve krahas skuamave dhe pllakave te trasha. Megjithatë, kjo forme e renieve te flokeve eshte kalimtare dhe renia rikuperohet pas trajtimit te psoriasis. Ka mendime te ndryshme qe lidhin psoriasis dhe dermatitin seboroik me telogen effluvium: heqia me force e skuamave, kruarjet e shpeshta qe shkaktojne ne koke mund te shkaktojne terheqie te flokeve, ndonjëherë medikamentet qe perdoren per trajtimin e ketyre patologjive shkaktojne humbjen e flokëve. Disa ilaçe që përdoren për të trajtuar psoriasis e kokës te tilla si acidi salicilici mund te demtoje përkohësisht flokët dhe të çojë në renien e tyre Në shumicën e rasteve, flokët rritet përsëri, kur trajtimi ndalet. Gjithashtu stresi qe shoqeron pacientet me psoriasis ose dermatit seboroik çon në renien e flokëve. Gjithashtu ka mendime se psoriasis eshte nje patologji autoimmune dhe renien e flokeve e lidhin me kete fakt.

Semundjet shoqeruese ne studimin tone u hasen ne 25.1% ose ne 55 paciente ku vendin kryesor e zinte dermatiti seboroik me 14.2%(31 paciente),psoriasis capitis eshte hasur ne 5.8%(13 paciente),lupusi sistemik eshte gjetur ne 3.7%(8 paciente) dhe diabeti melitus eshte gjetur ne 1.4%(3paciente) Semundjet shoqeruese rezultuan sinjifikante $p=0.01$.

Medikamente te ndryshme qe perdoren per te trajtuar probleme te tjera shkaktojne renie te flokeve duke interferuar ne ciklin normal te rritjes se flokeve kryesisht ne fazen anagene dhe gjate fazes telogene.Ne fund te

fazes telogjene floku bie dhe ai zvendsohet nga flok i ri. Medikamentet mund te shkaktojne dy tipe te renies se flokeve: telogen effluvium and anagen effluvium. Telogen effluvium eshte forma me e shpeshte e renies se flokeve e shkaktuar nga medikamentet dhe zakonisht shfaqet dy deri kater muaj pas marrjes se medikamentit. Medikamenti nderhyn ne ciklin e flokeve dhe jep renie te flokeve (100 deri 150 fije ne dite) duke bere kalim me te hershem te flokeve ne fazen telogjene. Shkalla e renies se flokeve varet nga tipi i medikamentit, doza e perdorimit te tij, gjithashtu nga ndjeshmeria individuale e individit ndaj medikamentit. Anagen effluvium eshte renia e flokeve qe ndodh gjate fazes anagene ose fazes se rritjes se flokut. Kjo forme haset tek personat qe bejne kimioterapi. Keto medikamente vrasin qelizat kanceroze te trupit por ato gjithashtu demtojne dhe qelizat e shendetshme duke perfshire matrixin e qelizave te flokeve. Kjo forme e renies se flokeve ndodh zakonisht pak dite deri dy jave nga fillimi i kimioterapise dhe progreson shume shpejt pas nje ose dy muajve (sipas American Cancer Society). Renia e flokeve eshte mjaft e shprehur deri ne renien e te gjitha floke te kokes, gjithashtu shoqerohet me renie te qerpikëve, te vetullave, dhe qimeve te tjera te trupit. Hypotermia e scalpit mund te parandaloje renien e flokeve gjate kimioterapise. Paketa akulli vendosen ne scalp per pak minuta perpara dhe menjehere pas kimioterapise. Akulli do te reduktoje qarkullimin e gjakut ne folikun e flokut dhe medikamentet e perdorura per kimioterapi nuk depertojne brenda folikujve te flokeve.

Ne studimin tone 8.7% ose 19 paciente kane perdorur medikamente per probleme te tjera dhe pas analizes me regresion logjistik u pa qe perdorimi i medikamenteve nuk eshte sinjifikant ne telogen effluvium $p = 0.44$.

Pervec faktoreve te permendur me siper reniet e flokeve mund te vijne dhe ne rastet e deficiencies te vitaminave, aminoacideve ose mineraleve. Reniet e flokeve mund te ndodhin kur dieta eshte e pa mjaftueshme me vitamine B kryesisht B6, biotine, acid folic, magnezium, sulfur dhe zinc. Vitamina B vecanerisht B5 acid pantothenic and B3 (niacin) kane rol te rendesishem ne rritjen e flokeve. Ne rastet e dietave te shpehura riritja e flokeve do te vihej re pas shume muajve te nderprerjes se dietes dhe kompesimit te deficiencies te vitaminave, aminoacideve ose mineraleve te nevojshme per rritjen e flokeve. Ne studimin tone 20.1% ose 44 paciente kane mbajtur diete per renie ne peshe dhe dieta na rezultoi jo sinjifikante $p = 0.07$.

Procedura te ndryshme si permanneti, dekolorimet ose lysterjet e flokeve me bojra mund te shkaktojne dobësi te

flokëve, duke e bërë atë te brishtë ose duke shkaktuar renie te flokeve. Nëse pacientet referojne per lidhje midis renieve te flokeve dhe procedurave te mesiperme (jane perjashtuar faktoret e tjere te mundshem te renieve te flokeve) rekomandohet evitimi i perseritur i ketyre procedurave dhe perdorimi i multivitaminave qe ndikojne ne rritjen dhe forcimin e flokeve. Ne kete studim faktoret ekzogjene jane hasur ne 2.7% ose ne 6 paciente dhe pas analizes me regresion logjistik u pa qe faktoret ekzogjene nuk jane sinjifikant ne telogen effluvium $p = 0.705$

Konkluzioni: Anemia, crregullimet e tiroides, stresi, dhe semundjet shoqeruese ndikuan ne shfaqien e telogen effluvium. Perdorimi i medikamenteve, dietat e mbajtura per te rene ne peshe dhe faktoret ekzogjene nuk ndikuan ne shfaqien e telogen effluvium.

REFERENCAT

1. Bergfeld WF, Mulinari-Brenner F. Shedding: how to manage a common cause of hair loss. *Cleve Clin J Med* 2001; 68:256-261.
2. Headington JT. Telogen effluvium: new concepts and review. *Arch Dermatol* 1993; 129:356-363.
3. Harrison S, Sinclair R. Telogen effluvium. *Clin Exp Dermatol* 2002; 27:389-395.
4. Kligman AM. Pathologic dynamics of human hair loss. I. Telogen effluvium. *Arch Dermatol* 1961; 83:175-198.
5. Paus R, Cotsarelis G. The biology of hair follicles. *N Engl J Med* 1999; 341:491-497.
6. Rook A, Dawber R. Chapter 1. The comparative physiology, embryology and physiology of human hair. In: Rook A, Dawber R, eds. *Diseases of the Hair and Scalp*. Oxford, UK: Blackwell Science Publications; 1982:1-17.
7. Bergfeld WF. Chapter 9. Telogen effluvium. In: McMichael J, Hordink MK, eds. *Hair and Scalp Diseases: Medical, Surgical, and Cosmetic Treatments*. London, UK: Informa Health Care; 2008:119-136.
8. Sinclair RD, Dawber RP. Androgenetic alopecia in men and women. *Clin Dermatol* 2001; 19:167-178.
9. Sperling LC. Hair and systemic disease. *Dermatol Clin* 2001; 19:711-726.
10. Tosti A, Pazzaglia M. Drug reactions affecting hair: diagnosis. *Dermatol Clin* 2007; 25:223-231.
11. Rook A, Dawber R. Chapter 5. Diffuse alopecia: endocrine, metabolic and chemical influences on the follicular cycle. In: Rook A, Dawber R, eds. *Diseases of the Hair*

- and Scalp. Oxford, UK: Blackwell Science Publications; 1982:115-145.
12. Goette DK, Odum RB. Alopecia in crash dieters. JAMA 1976; 235:2622-2623.
 13. Pillans PI, Woods DJ. Drug-induced alopecia. Int J Dermatol 1995; 34:149-158.
 14. Fiedler VC, Gray AC. Chapter 10. Diffuse alopecia: telogen hair loss. In: Olsen EA, ed. Disorders of Hair Growth: Diagnosis and Treatment. 2nd ed. New York, NY: McGraw-Hill Publishing; 2003:303-320.
 15. Apache PG. Eczematous dermatitis of the scalp. In: Zviak C, ed. The Science of Hair Care. New York, NY: Marcel Dekker, 1986:513-521.
 16. Whiting DA. Chronic telogen effluvium. Dermatol Clin 1996;14:723-731.
 17. Whiting DA. Chronic telogen effluvium: increased scalp hair shedding in middle-aged women. J Am Acad Dermatol 1996; 35:899-906.
 18. Olsen EA, Messenger AG, Shapiro J, et al. Evaluation and treatment of male and female pattern hair loss. J Am Acad Dermatol 2005; 52:301-311.
 19. Sinclair R, Grossman KL, Kvedar JC. Chapter 9: Anagen hair loss. In: Olsen EA, ed. Disorders of Hair Growth: Diagnosis and Treatment. 2nd ed. New York, NY: McGraw-Hill Publishing; 2003:275-302.
 20. Madani S, Shapiro J. Alopecia areata update. J Am Acad Dermatol 2000; 42:549-566.
 20. Shapiro J. Clinical practice. Hair loss in women. N Engl J Med 2007; 357:1620-1630.

ETIOLOGY FACTORS EVALUATION IN TELOGEN EFFLUVIUM

Albana Lufi ¹, Loreta Kuneshka ², Ermira Vasili ³,

¹ Central University Military Hospital, Tirana

² Department of Public Health, Faculty of Medicine, Tirana

³ Clinic of Dermatology, University Center and Hospital "Mother Teresa", Tirana

INTRODUCTION

Diffuse hair loss in the whole head surface is referred to as effluvium or effluvium capelli. This hair loss may be found in two types, the immediate type, anagen dystrophic effluvium or the late type, telogenic alopecia.

Objective: To evaluate the influence of thyroid pathologies, anemia, stress, medication prescribed for other health issues, other local or systemic concomitant diseases, diet with the intention to lose weight and of exogenous factors in telogen effluvium.

Material and method: 219 patients diagnosed with telogen effluvium and 219 patients as a control group, who showed up in the ambulatory service of Central University Military Hospital during the period of time from January 2010 to November 2011, were included in this study. In the control group were included patients who presented to the dermatologist for other health problems and who did not refer to have experienced hair loss.

Results: In the case of telogen effluvium, 17.8% of the patients had thyroid gland disorders, 40.2% anemia, 28.7% psychological and physical stress, 8.7% had used medication, 25.1% had concomitant diseases, 20.1% were in diet, exogenous factors were encountered in 2.7% of the patients.

Conclusion: Anemia, thyroid gland disorders, stress and concomitant diseases significantly influenced in the exertion of telogen effluvium. While applied medication, diet with the intent to lose weight and exogenous factors did not influence in the exertion of telogen effluvium.

Keywords: Telogen effluvium, possible etiology factors.

KORELACIONI I ASTMËS DHE IGE-VE SPECIFIKE TE FËMIJËT DERI NË 3 VJET

Hajdin Ymeri¹, Drita Telaku-Qosaj¹, Majlinda Berisha², Afijete Gërçari-Ymeri¹, Arlinda Maloku², Abdurrahim Gerguri¹, Shendvere Hasani¹

¹Klinika e Pediatrisë, QKUK, Prishtinë, Kosovë

²Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 86-90

REZYME

Hyrje: Astma është sëmundje kronike inflamatore e rrugëve të frymëmarrjes, që karakterizohet me obstrukcion akut i cili mund të kalojë në mënyrë spontane ose me medikamente. Qëllimi: Në këtë punim ka qenë intença e paraqitjes së korelacionit në mes Ige-ve specifike dhe astmës te fëmijët e moshës 6 muaj deri 3 vjet në Klinikën e Pediatrisë, QKUK. Metoda: Në hulumtim janë përfshirë gjithsejt 62 fëmijët (34 të hospitalizuar dhe 28 fëmijë të trajtuar në mënyrë ambulantore) të sëmurë nga astma, të cilëve iu janë matur Ige-të specifike. Rezultatet: Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të përfshirë në hulumtim (62 fëmijë). 34 fëmijë kanë qenë të hospitalizuar (21- meshkuj dhe 13- femra) dhe 28 janë trajtuar në mënyrë ambulantore (17-meshkuj dhe 11-femra). Ige-të specifike kanë qenë pozitive në 29 raste ose (46.7%). Te fëmijët e hospitalizuar kanë qenë pozitive te 12 meshkuj dhe 8 femra, ndërsa ata të trajtuar në mënyrë ambulantore 6 meshkuj dhe 3 femra. Sa i përket rasteve ose përqindjes së Ige-ve specifike sipas gjinisë Ige-të specifike kanë qenë në 18 raste ose (62.1%) të gjinisë mashkullore, ndërsa 11 raste ose (37.9%) të gjinisë femërore. Sipas grup-moshave pozitiviteti i Ige-ve specifike për të dy gjinitë prej 6 muajve deri 1 vit ka qenë 4 raste ose (13.79%). Prej moshës 1 deri 2 vjet 10 raste ose (34.48%), ndërsa prej 2 deri 3 vjet 15 raste ose (51.72%).

Konkluzioni: Nga të dhënat tona vërehet se Ige-të specifike janë indikator i rëndësishëm për astëm. Incidenca më e lartë është te fëmijët e gjinisë mashkullore te rastet e hulumtuara.

Përfundimi: Në bazë të rezultateve të përfituara mund të perfundojmë se te fëmijët ka pas lidhshmëri në mes Ige-ve specifike dhe astmës. Ige-të specifike kanë qenë të shprehura me sinjifikacë më të lartë ndaj D. Pteronissinus, D. farine.

Fjalët kyqe. Asthma, obstrukcion akut, Ige specifike

HYRJE

Astma është sëmundja më e shpeshtë kronike e fëmijëve e cila karakterizohet me inflamacion kronik të rrugëve të frymëmarrjes me intenzitet të ndryshuar e përcjellur me bronko-obstrukcion akut i cili mund të kalojë në mënyrë spontane ose me medikamente. Astma është çrregullim kronik me pjesëmarrje të qelizave të shumta duke përfshirë mastocitet, eozinofile dhe qelizat tjera. Kjo te personat me predispozicion shpie deri te paraqitja e simptomave të ndryshme, zakonisht të shoqëruara me obstrukcion të gjenralizuar por të ndryshueshëm të rrugëve të frymëmarrjes, shpesh reverzibil si dhe e shoqëruar me hiper-reagibilitet në stimulues të ndryshëm.(1)

Nga aspekti patofiziologjik, për manifestimin dhe zhvillimin e astmës vie në shprehje atopia, predispozicioni

trashëgues, rrethi jetësor në të cilin jeton fëmiju, hiper-reagibiliteti dhe faktorët tjerë. Vlen të theksohet se zhvillimi i hiper-reagibilitetit bronkial jospesifik dhe astmës është i ndërlidhur me shumë gjene pa marrë parasysh a është në pyetje atopia e që më së miri vërehet me polimorfizmin e gjeneve ADAM33, CTLA4 dhe CD28 (2, 3, 4).

Th-2 limfocitet janë qelizat kyqe për sintezën e Ige, të cilat janë klasa e antitropave përgjegjëse për zhvillimin e reaksionit të hipersenzitivitetit duke u lidhur me receptorët me afinitet të lartë në sipërfaqe të mastociteve dhe bazofileve duke inicuar aktivizimin e këtyre qelizave pas lidhjes me alergjenin(5, 6). Astma shoqërohet me alergjitë respiratore dhe vlerat e rritura të Ige totale në serum(7) dhe sipas studimeve të mëhershme tregohet se niveli i Ige-ve te fëmijët me astmë është më i lartë krahas

fëmijëve pa astmë (8), mirëpo raporti në mes senzibilitetit specifik ndaj alergjenëve të brendshëm dhe astmës te fëmijët nuk është mjaft i hulumtuar (9,13). Shpesh diskutohet për predispozicionin gjenetik i cili ngusht korelon me nivelin e IgE në gjak dhe inflamacionin e rrugëve të frymëmarrjes. Gjeni përgjegjës për rritjen e IgE-ve dhe hiper-reagibilitetit bronkial është i lokalizuar afër lokusit për rregullimin e nivelit të IgE-ve në serum, në kromozomin 5q10.

Astma është problemi më aktual i pulmologjisë, te fëmijët dhe një ndër problemet më të rëndësishme në përgjithësi, duke e pasur parasysh rritjen e prevalencës në dekadën e fundit te moshat e reja.

MATERIALI DHE METODA

Studimi është prospektiv dhe është realizuar gjatë vitit kalendarik Janar 2011- Qershor 2012 në Klinikën e Peditrisë, Reparti i Pulmologjisë. Në hulumtim janë përfshirë .Fëmijët,sipas vendit në të cilën janë bërë analizat (spitalore,dhe ambulatorë).Fëmijët sipas grup-moshave të cilëve iu është bërë analiza e IgE-ve specifike janë ndarë prej 6 muajve-1vjet ,prej 1-2 vjet dhe prej 2-3 vjet. Është analizuar edhe raporti i pozitivitetit të IgE-ve sipas gjinisë. Në hulumtim nuk janë përfshirë fëmijët e sëmurë me sëmundje tjera kronike,sistemike si dhe ata me infestime parazitare. Prindërit e fëmijëve të përfshirë në hulumtim janë informuar në mënyrë gojore dhe të shkruar për hulumtimin si dhe kanë aprovuar pjesëmarrjen e tyre në hulumtim. Të dhënat anamnestike janë marrë nga historia e sëmundjes si dhe janë plotësuar me pyetje shtesë. Analizat e IgE-ve specifike janë bërë sipas metodës RAST. Në hulumtim kanë qenë të përfshirë gjithsejt 62 raste, prej tyre 34 të hospitalizuar dhe 28 ambulatorë.


REZULTATET

Numri i fëmijëve të hospitalizuar dhe numri i fëmijëve të trajtuar në mënyrë ambulatorë janë prezantuar në tabelën 1, ku është paraqitur edhe përkatësia gjinore e tyre e prezantuar në mënyrë numerike dhe me përqindje (tabela 1.).

Tabela dhe Grafiku Nr. 1

	Numri	Përqindja %
Numri i fëmijëve të hospitalizuar	m: 21	33.9 %
	f: 13	20.9%
Numri i fëmijëve të trajtuar në mënyrë ambulatorë	m: 17	27.5%
	f: 11	17.7%
Gjithsejt	62	100%

Grafiku Nr.1




Në Tabelën dhe Grafikon Nr. 1 Shihet se nga numri i përgjithshëm i fëmijëve (62 fëmijët), 34 kanë qenë fëmijë të hospitalizuar prej tyre 21 të gjinisë mashkullore ose (33.9%) dhe 13 të gjinisë femërore ose (20.9%). Në trajtim ambulator kanë qenë gjithsejt 28 fëmijë, prej tyre 17 ose (27.5%) të gjinisë mashkullore dhe 11 ose (17.7%) të gjinisë femërore.Vërehet se ka pasë një diferencë në mes të fëmijëve të hospitalizuar,ndaj rasteve ambulatorë për 6 raste ose (9.6%)

Tabela dhe Grafiku Nr.2. Paraqitja IgE-ve specifike,që kanë rezultuar negative për rastet hospitalore dhe ambulatorike

	Numri	Përqindja%
IgE specifike negative te fëmijët e hospitalizuar	m: 13	39.4 %
	f: 8	24.2%
IgE specifike negative te fëmijët e trajtuar në mënyrë ambulatorë	m: 8	24.2%
	f: 4	12.2%
Gjithsejt	33	100%

Grafiku Nr.2




Në tabelën dhe grafikon Nr.2 Eshtë paraqitur numri dhe përqindja e rasteve të IgE-së specifike negative te fëmijët e përfshirë në hulumtim,sipas vendit ku është bërë analiza,

dhe sipas gjinisë. Sipas vendit ka pas 21 raste ose (63.6%) të hospitalizuar, dhe 12 raste ose (36.4%) ambulatorë. Diferenca është prej 9 rasteve ose (27,2%) në favor të rasteve të hospitalizuar. Sipas gjinisë janë 21 raste ose (63,6%) të gjinisë mashkullore, ndërsa 12 raste ose (36,4%) të gjinisë femërore. Diferenca në mes gjinisë është 9 raste ose (27,2%) në favor të gjinisë mashkullore. Numri total i rasteve me IgE specifike negative është 33 ose (53,22%) në raport me numrin e 62 rasteve që janë kryer. Janë matur IgE-të specifike ndaj D.pteronissimus, D.farinae, polenit, kafshëve shtëpiake (macës dhe qenit).

Tabela dhe Grafiku Nr.3. Paraqitja tabelare dhe grafike e IgE-ve specifike pozitive sipas vendit, ku është bërë analiza dhe gjinisë.

	Numri	Përqindja%
IgE-të specifike pozitive te fëmijët e hospitalizuar	m: 12	41.4 %
	f: 8	27.6%
IgE-të specifike pozitive te fëmijët e trajtuar në mënyrë ambulatorore	m: 6	20.7%
	f: 3	10.3%
Gjithsejt	29	100%

Grafiku Nr.3.



Në Tabelën dhe Grafikon Nr.3 janë paraqitur IgE-të specifike pozitive të fëmijët e hospitalizuar dhe ambulatorë sipas gjinisë. Në bazë të vendit ku janë bërë IgE-te specifike, janë 20 raste të fëmijët e hospitalizuar dhe 9 te ata ambulatorë, diferenca është për 11 raste ose (38%).

Sipas gjinisë kanë qënë IgE specifike pozitive me 18 raste të gjinisë mashkullore ose (62.1%), ndërsa të gjinisë femërore 11 raste ose (37.9%), diferenca në mes gjinive është 7 raste ose (24.2%) në favor të gjinisë mashkullore. Nga tabela 3 shihet se IgE-të specifike ka qënë pozitive te 29 ose (46.7%) në raport me numrin prej 62 rasteve të analizuar për IgE-të specifike.

Tabela dhe Grafiku Nr.4 Analizat e IgE-ve specifike sipas grup-moshave

Mosha	Analizat e IgE-ve specifike	Perqindja %
Prej 6 muajve deri 1 vit	12	19.35 %
Prej 1- 2 vjet	17	27.41 %
Prej 2-3 vjet	33	53.22 %
Gjithsejt	62	100 %

Grafiku Nr.4




Tabela dhe Grafiku Nr.4 Në bazë të këtyre rezultateve kuptojmë se më së shumti analiza janë bërë prej moshës 2-3 vjet 33 analiza ose (53.22%). Në rendin e dytë vie grup-mosha prej 1-2vjet ku janë bërë 17 analiza ose 27.41, e më së paku janë bërë analiza prej moshës 6 muaj deri 1 vjet, gjithsejt 12 analiza apo (19.35%)





Tabela dhe grafiku Nr.5 Paraqitja tabelare me analizat e bëra pozitive dhe negative të IgE-ve specifike sipas grup-moshave të fëmijët prej 6 muajve deri 1 vjet, prej 1-2 vjet dhe prej 2-3 vjet. Nga rezultatet vërejmë se në grup-moshën prej 6 muaj-1vjet janë 4 raste pozitive ose (13.79%), prej 1-2 vjet 10 raste ose (34.48%) dhe prej 2-3 vjet 15 raste ose (51.72%). Nga numri i përgjithshëm prej 29 rasteve që kanë qënë IgE specifike pozitive.

IgE-të specifike negative sipas grupmoshave prej 6 muajve-1 vjet kanë qënë 8 ose (24.2%) ,prej 1-2 vjet kanë qënë 7 raste ose (21.2%) dhe prej 2-3 vjet kanë qënë 18 raste

apo (54.4%). Mund të konkludojmë se për nga shkalla e IgE-ve negative dominojnë grup-moshat prej 2-3 vjet 18 raste ose (54.4%), pastaj vijnë grup-moshat 6 muaj deri 1 vjet me 8 raste ose (24.2%) dhe së fundi grup-mosha 1-2 vjet me 7 raste ose (21.2%). Numri total i rasteve negative të IgE-ve specifike është 33 raste apo (53.22%).

Tabela dhe Grafiku Nr.6 Raporti gjinorë i IgE-ve specifike pozitive.

IgE-te specifike pozitive sipas gjinisë	Numri i rasteve	Përqindja %
Meshkuj	18	62.1%
Femra	11	37.9%
Gjithsejt	29	100%



Në bazë të Tabelës dhe Grafikut Nr.6 Vërehet se nga 29 raste të të analizuarve me IgE specifike pozitive janë 18 ose (62.1%) të gjinisë mashkullore, ndërsa 11 raste ose (37.9%) të gjinisë femërore. Diferenca është për 7 raste ose (24.2%) në favor të gjinisë mashkullore.

DISKUTIMI

Në bazë të analizave të IgE-ve specifike, sipas vendit ku janë bërë dominojnë rastet e hospitalizuara (34 fëmijë) ndaj atyre të trajtuar në mënyrë ambulatore (28 fëmijë) të prezantuar në tabelat 1,2,3 .Sipas grup-moshave nga tabelat dhe grafikonet nr.4 dhe 5 është paraqitur numri i rasteve të analizuar sipas grup-moshave prej 6 muajve deri në 1 vjet kanë qenë 4 ose (13.79%) raste pozitive, 8 raste ose (24.2%) negative. Prej moshës 1-2 vjet kanë qenë 10 ose (34.48%) raste pozitive, 7 raste ose (21.2%) negative, dhe prej moshës 2-3 vjet kanë qenë 15 ose (51.72%) raste pozitive dhe 18 ose (54.54%) negative. Mund të konkludojmë se numri dhe përqindja më e lartë e fëmijëve me pozitivitet të IgE-ve specifike kanë qenë prej moshës 2-3 vjet, kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se fëmijët në këtë moshë kanë kontakt me alergjenët si D.Pteronissimus, D. Farine, polenet, epitelin e shtazëve (macës, qenit) dhe

alergjenet tjerë. Sipas gjinisë vërehet se ka incidencë më të lartë të fëmijëve të gjinisë mashkullore krahas atyre të gjinisë femërore. Të paraqitur në tabelën dhe grafikun nr.6 . Nga numri total i 62 fëmijëve 29 raste ose (46.7%) kanë rezultu pozitive. Të gjinisë mashkullore kanë qenë 18 raste ose (62.1%) ,ndërsa 11 ose (37.9%) raste të gjinisë femërore. Diferenca është për 7 raste ose (24.2%). Raporti i pozitivitetit të IgE-ve specifike sipas gjinisë është 1,6 : 1 në favor të gjinisë mashkullore .Ky raport është analog edhe te fëmijët të cilët kanë astëm që në moshën e hershme ku raporti është 3:2 në favor të gjinisë mashkullore, ndërsa në moshën para pubertetit ky raport përafërsisht është 1:1 (14). Përcaktimi i IgE-ve specifike te fëmijët e vegjël mund të na ndihmojë në identifikimin e fëmijëve potencial për sëmundjet alergjike në të ardhmën(8). Rezultate të përafërta kanë paraqitur edhe autorët e tjerë në punimet e tyre (9).

PËRFUNDIMI

Mund të përfundojmë se pas analizimit të rezultateve të fëmijët e përfshirë në hulumtimin tonë ka pasur lidhshmëri në mes të IgE-ve specifike dhe manifestimit të astmës. Arsyeja tjetër e përdorimit të matjes së IgE-ve specifike është ngase te fëmijët e vegjël nuk mundemi me saktësi të përcaktojmë shkaktarin e alergjisë. Kjo analizë nuk është e ndikuar nga përdorimi i medikamenteve si β_2 agonistët ose kortikosteroidët si dhe nga dermatitet aktuale të fëmijës, Ana negative e kësaj analize është kostoja e lartë e realizimit. Pasi që IgE-të specifike janë indikatorë i rëndësishëm për astëm potenciale në rastin tonë rezultatet kanë qenë pozitive ndaj D.pteronissinus, D, farine që përputhet edhe me rezultate të autorëve tjerë në rajon(10) dhe Botë (11). **Propozimi i masave** Duhet të merren masa preventive të higjienës dhe edukimit të prindërve që ekspozimi i fëmijës ndaj këtyre akarieneve të jetë në kufij minimal. Në rritjen e prevalencës së astmës përveç faktorit gjenetik, ka shumë ndikim edhe mesi në të cilin jeton fëmiju.

BIBLIOGRAFIA

1. NIH(National institutes of health) Global initiative For Asthma.A pocket guide for asthma management and prevention for physicans and nurses.NIH Publication 96-3659B.Bethseda,MD:NIH, 1998
2. Michael S, Lang L, Depner M et al, Unifying candidate gene and GvAS aproaches in astma, PloS, www.plosne.org/article/info%3Adoi%2F10.1371%2Fjournal.pone.0013894

3. Howard TD, Postma DS, Hawkins GA, Koppelman GH, Zheng SL, Wysong AK, Xu J, Meyers DA, Bleecker ER. Fine mapping of an IgE controlling gene on chromosome 2q: Analysis of CTLA4 and CD28. *J Allergy Clin Immunol* 2002;110:743-51.
4. Kyu-Young Oh,¹ Mi-Jin Kang,² Won-Ah Choi,² Ji-Won Kwon,³ Byoung-Ju Kim,³ Jinho Yu,³ Soo-Jong Hong^{3*}, Association Between Serum IgE Levels and the CTLA4 +49A/G and FCER1B -654C/T Polymorphisms in Korean Children With Asthma, *Allergy Asthma Immunol Res.* 2010 April;2(2):127-133.
5. Platts-Mills TA. The role of immunoglobulin E in allergy and asthma. *Am J Respir Crit Care Med* 2001;164:S1-S5. [PubMed: 11704610]
6. Nelson Textbook of Pediatrics, 19th edition, 2011, 130: 743-747
7. Gern J, Lemanske R Jr, Busse W. Early life origins of asthma. *J Clin Invest* 1999;104:837-843. [PubMed: 10510321] Borish L, Chipps B, Deniz Y, Gujrathi S, Zheng B, Dolan CM. Total serum IgE levels in a large cohort of patients with severe or difficult-to-treat asthma. *Ann Allergy Asthma Immunol* 2005;95:247-253. [PubMed: 16200815]
8. Halfon N, Newacheck PW. Childhood asthma and poverty: differential impacts and utilization of health services. *Pediatrics* 1993;91:56-61. [PubMed: 8416505]
9. Sly PD, Boner AL, Björkstén B et al. Identification of atopy in the prediction of asthma in children. *Lancet* 2008; 372:1100-6
10. Demetra Z. Rotsides¹, Inge F. Goldstein¹, Stephen M. Canfield², Matthew Perzanowski, Robert B. Mellins⁴, Lori Hoepner³, Maxine Ashby-Thompson¹, and Judith S. Jacobson¹, ASTHMA, ALLERGY, AND IgE LEVELS IN NYC HEAD START CHILDREN, *Respir Med.* 2010 March ; 104(3): 345-355. doi:10.1016/j.rmed.2009.10.016.
11. Kovač K, Dodig S, Tješić-Drinković D, Raos M. Correlation between asthma severity and serum IgE in asthmatic children sensitized to Dermatophagoides pteronyssinus. *Arch Med Res* 2007;38:99-105. [PubMed: 17174732]
12. Naqvi M, Choudhry S, Tsai H, Thyne S, Navarro D, Nazario S, et al. Association between IgE levels and asthma severity among African American, Mexican, and Puerto Rican patients with asthma. *J Allergy Clin Immunol* 2007;120:137-143. [PubMed: 17498790]
13. Pearce N, Pekkan J, Beasley R. How much asthma is really attributable to atopy? *Torax* 1999; 54:268-72
14. Semundžet Traktit te frymemarjes te femijet .Evda Vevecka / Prof.Dr. Luljeta Serbo-Kotta 2005 ; 205

CORRELATION OF ASTHMA AND SPECIFIC IGE IN CHILDREN UP TO THREE YEARS OF AGE

Hajdin Ymeri¹, Drita Telaku-Qosaj¹, Shendvere Hasani¹, Majlinda Berisha², Afijete Gerçari-Ymeri, Arlinda Maloku², Abdurrahim Gerguri¹

¹Pediatric Clinic, University Clinical Center of Kosova (UCCK)

²Faculty of Medicine, University of Pristina

RESUME:

Aim. Aim of this study was to present correlation between specific IgE and asthma in children aged 6 months- 3 years in Pediatric Clinic, UCCK. **Methods.** In this study in total, 62 children were involved (34 were hospitalised and 28 were ambulatory patients), which were diagnosed with asthma, and to whom specific IgE was measured. **Results.** From the total number of children involved in this study (62 children), 34 children were hospitalised (21 male and 13 female) and 28 of them were ambulatory patients (17 male and 11 female). Specific IgE was positive in 29 cases (46.7%). In hospitalised children it was positive in 12 males and 8 females while ambulatory patients IgE was positive in 6 males and 3 females. **Conclusion.** Correlation between asthma and specific IgE was 46.7% of the cases included in the research. Specific IgE was significantly positive towards D. Pteronissinus and D. farine. On the basis of positive specific IgE-s dominant males in the ratio 1.6: 1 to feminine

Key words: Asthma, akute obstruction, specific IgE

KARAKTERISTIKAT TERRITORIALE TË PREVALENCËS SË POLINOZËS NGA POLENI I KARAFILJGJENIT NË QYTETET KRUIJË, BERAT DHE TIRANË

Kastriot Shytaj¹, Arben Boçari², Mehmet Hoxha³, Elona Gjebrea³, Leonard Deda⁴

¹Departamenti i Diagnostikës dhe Reabilitimit Mjekësor, Fakulteti i Infermierisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri.

²Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor Tiranë, Tiranë, Shqipëri.

³Klinika e Alergjologjisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tirana, Shqipëri.

⁴Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës.

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 91-95

ABSTRAKTI

Hyrje Karafiljgjeni (*Parietaria*) është një bimë shumë alergjike që gjendet kryesisht në rajonin e Mesdheut. Ajo shkakton kryesisht Astme Bronkiale të bashkëshoqëruar me Rrufe Alergjike. Ajo rritet kryesisht në terrene të thata pranë mureve të vjetra siç edhe janë ato të kështjellave

Metoda. Ky është një studim retrospektiv i bazuar në informacionin e marrë nga kartelat e pacienteve të paraqitur në klinikën e Alergjologjisë QSUT “Nënë Tereza” Tiranë në periudhën 1996-2002 nga qytetet e Tiranës, Krujës, dhe Beratit. U analizuan 1368 pacientë kushti i vetëm i përfshirjes në studim ishte të kishin bërë provat alergjike të lëkurës me alergjene të ajrit (ku përfshihesh edhe Karafiljgjeni) dhe të kishin rezultuar pozitiv të paktën për njerin prej tyre

Rezultatet. Nga ky studim rezultoi që prevalenca e kësaj alergjie ishte në mënyrë sinjifikante ($p < 0.001$) më e lartë në Krujë dhe Berat se sa në Tiranë. Ndërkohë rezultoi se nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në prevalencë midis Krujës dhe Beratit.

Përfundim. Tirana, Kruja dhe Berati ndodhen në Shqipërinë e Mesme dhe shumë afër detit. Dallimi qëndron në faktin se qytetet e Krujës dhe Beratit ndodhen shumë pranë kështjellave të lashta dhe kjo shpjegon edhe arsyen se pse në këto qytete ka një prevalencë më të lartë të personave alergjike nga poleni i karafiljgjenit në raport me alergjitë e tjera.

Fjalë kyçe: Karafiljgjeni (*Parietaria*), polinoza, Astma Bronkiale, Rrufa Alergjike.

NE VEND TE HYRJES - NJE PERSHKRIM PER PARIETAREN

Karafiljgjeni (lat. *Parietaria*, ang. *Pellitory of the wall*) i përket familjes dythelbore të Urticaceae (ku futet edhe hithra) e ku bëjnë pjese mbi 10 specie të veçanta. Në rajonin e Mesdheut me të shpërhapura janë: *P. Judaica* (diffusa), *P. Officinalis*, *P. Lusitanica*, *P. Cretinica*, *P. Mauritanica*, etj.



Figura 1. Bima e karafiljgjenit

P. judaica është një bime që rritet deri në 30 - 40 cm, me gjethe ovoidale (3 - 12 cm), e lule të vogla që dalin në sjetullat e gjetheve pothuajse gjatë gjithë vitit (fig. 1). Ajo ka një polen me forme të rrumbullakët, diametër 14 - 19 µm, trizonoporat me ekzine mikroverrukatë e intime të bute me polenizim të tipit anemofil. Polenizimi i saj varet nga temperatura, lagështira dhe drita (M). Ajo rritet kryesisht në brigjet e Mesdheut por s'është e rradhë edhe në kontinent (1-3). Në shpërhapjen e saj në vende të ndryshme të globit ka ndikuar shumë njeriu pasi kjo bime është përdorur për efektet e saj kurative. Në rajonin e Mesdheut kjo bime lulëzon pothuajse gjatë gjithë vitit dhe poleni i saj mund të kapet në ajër nga Marsi (Shkurti) deri në Nëntor (4). Ka dy pike kur nivelet janë të afte të japin simptoma: mars - qershor - korrik dhe gusht - tetor.

Alergjenët me të rëndësishëm të gjitha specieve të saj janë glikoproteina të vogla me peshe molekulare ndërmjet 10 dhe 14 kDa, dhe ndaj tyre ka reagim të kryqëzuar të shprehur, kjo është edhe arsyeja pse janë ekuivalente si për diagnostikim ashtu edhe për imunoterapi pavarësisht nga cila specie është sensibilizuar pacienti (5,6). Gjithsesi alergjenët me të rëndësishëm janë Par o 1 (13.5 kDa) dhe Par j 1 (12 kDa). Po ashtu të dhënat e fundit dëshmojnë se poleni i Parietaria judaica ka në përbërje një aminopeptidazë e cila i hap rrugë alergjenit të polenit përgjatë barrierës epiteliale duke i lehtësuar kontaktin me qelizat dentritike (7).

Kjo bime preferon zona të thata kryesisht rreze mureve të vjetër (që këtej del edhe domethënia e emrit latin Parietaria si edhe atij anglez *Pellitory of the Wall* që do të thotë bima e mureve) në lartësinë 900 - 1000 m, në tokat e pasura me azot.

Poleni i Parietaries mund të shkaktojë astmë bronkiale, rrufe alergjike si dhe konjuktivit alergjik. Shume studime dëshmojnë që poleni i *Parietarias* është një nga shkaqet me të shpeshte të polinozave në rajonin e Mesdheut (6) (8 - 15).

Poleni i karafillejgenit zë 8% të poleneve të atmosferës së Tiranës (16). Përqendrime të larta të polenit të Karafillejgenit janë kapur që në fund të prillit e deri në fund të tetorit. Këto ndryshojnë nga viti në vit në varësi të kushteve meteorologjike (16).

Vendi ynë ndodhet në zonën mesdhetare ndaj edhe është e pritshme edhe një prevalencë e lartë e polinozës ndaj këtij poleni. Por Shqipëria dallohet edhe gjithashtu edhe për shumëllojshmërinë e relievit apo mikroklimave. Qëllimi i këtij studimi është pikërisht ndikimi i relievit, mikroklimave apo karakteristikave të tjera lokale në prevalencën e polinozës nga Parietaria.

MATERIALI DHE METODA

Ky është një studim retrospektiv i bazuar mbi të dhënat e ruajtura nga Klinika e Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike, QSU "Nene Tereza" Tirane. U shfrytëzuan kartelat e pacientëve që kishin bërë provat e lëkurës me alergjenë të ajrit ku përfshihesh edhe *Parietaria officinalis*. U përfshinë në studim të gjithë pacientet e paraqitur në klinike nga Kruja e Berati gjatë periudhës kohore 1996-2002, respektivisht 207 dhe 218 pacientë. Nga numri total i pacientëve të paraqitur në klinikë nga Tirana gjatë kësaj periudhe (over 6000 patients) u zgjedhën në mënyrë të rastësishme (randomizuar) 943 pacientë. Përzgjedhja u bë me ndihmën e "Research Randomizer" duke përdorur si subjekt të randomizimit numrin e kartelës mjekësore respektive për secilin pacient (17). Nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në moshë mesatare, ndarje sipas sekseve, shpërndarje sipas diagnozave apo në ndarjen në dy kategori; të monosensitizuar dhe të polisensitizuar.

Kriteri i vetëm seleksionimi ishte të kishin të paktën një alergjen pozitiv në provat e lëkurës me alergjenë të ajrit. Moshë mesatare 31.2 ± 13.1 , Maksimumi = 62, Minimumi = 7 vjeç.

Krahasimi i prevalencave të sensibilitetit nga poleni i Parietaries, seksit dhe diagnozave u bë me testin e χ^2 . Krahasimi i moshës mesatare u bë me T-testin variantin "two-tailed distribution, homoscedastic".

REZULTATET




Figura 2. Shpërndarja e diagnozave tek pacientet me SPT pozitiv për karafillejgenin.




Figura 3. Shpërndarja të monosensitivizuar dhe të polisensitivizuar.




Figura 4. Prevalenca e sensibilizimit nga karafillejjeni tek pacientet me të paktën një SPT pozitiv nga Tirana, Kruja dhe Berati.

Nga 943 pacientet e ardhur nga Tirana që kishin kryer provat e lëkurës për alergjenët e ajrit (ndër këto edhe për Parietaren) 52 rezultojnë të kishin dalë pozitivë për Parietaren, 5.5%. Kjo prevalencë ishte dukshëm më e lartë sesa tek pacientet e ardhur nga Kruja ($p < 0.001$) dhe po ashtu edhe se ata të ardhur nga Berati ($p < 0.001$). Prevalenca e pozitivitetit të SPT për Parietaren për pacientet nga Kruja dhe Berati ishte përkatësisht 17.3% dhe 15.6%. Dallimi midis pacientëve të ardhur nga Kruja dhe Berati nuk kishte rëndësi statistikore. Sensibilitetit nga poleni i Parietares (Testet e lëkurës pozitive nga alergjenët e polenit të parietares) rezultojnë 2.9 herë ($p < 0.001$) më i shpeshtë në pacientet nga Kruja dhe Berati sesa në ato që banojnë në Tiranë. Më së shpeshti pozitiviteti i SPT për

Parietaren bashkëshoqërohet me atë të Akarieneve dhe Graminaceve (fig. 5). Përsa i përket kësaj nuk kishte dallime të rëndësishme statistikore midis tre qyteteve.

Tabela 1. Përqindja e pacientëve me teste të lëkurës pozitive nga Parietaria.

Qyteti	SPT pozitiv për Parietaren	SPT pozitiv për të paktën një pneumoalergjen	%	Dallimi me Tiranën (p)
Tirana	52	943	5.5	
Kruja	36	207	17.4	<0.001
Berati	34	218	15.6	<0.001




Figura 5. Alergjenet që bashkëshoqërojnë më shpesh sensibilizimin nga poleni i Parietares sipas rezultateve të testeve të lëkurës për të tre rajonet në studim sëbashku. Në boshtin vertikal shprehet përqindja e pacientëve tek të cilët takohet bashkëshoqërimi i alergjenit përkatës (sipas shtyllave).

DISKUTIM

Siç vihet re nga rezultati ka një dallim të rëndësishëm statistikor në prevalencën e polinozës nga Parietaria midis qyteteve të Krujës e Beratit nga njëra anë dhe Tiranës nga ana tjetër. Kjo bimë preferon vende të thata dhe mure të ndërtesave të vjetra për të patur një rritje dhe zhvillim normal. Kruja dhe Berati janë qytete që lokalizohen pranë mureve të vjetra të kalave përkatëse (për me tepër në Berat ka banesë edhe brenda kalasë), ndaj mund të sugjerojmë që kjo bimë gjendet më shpesh

në këto ambiente e si rrjedhim edhe përqendrimi i polenit të saj në ajrin e këtyre qyteteve duhet të jete më i lartë se në Tiranë.

Njohja e terreneve ku mund të gjendet më shpesh një bimë e caktuar si karafillejgjeni është e dobishme për pacientet alergjike ndaj poleneve të tyre pasi i ndihmon ata që t'i shmangin këto zona. Gjithsesi referohet se prevalenca e sensibilizimit nga *Parietaria* është më e lartë tek te ardhurit vonë në zonën përkatëse sesa tek popullata autoktone, çka dëshmon se mund të jetë shumë e rëndësishme nëse individit është ekspozuar ndaj këtij poleni që në fëmijërinë e hershme (6) Përsa i përket desensibilizimit me imunoterapi ajo ngelet si opsion vetëm tek paciente astmatike të përzgjedhur mirë pasi dhe rezultatet nuk janë shumë konsistente (18). Gjithashtu duhet theksuar që reaksionet lokale dhe sistematike ndaj kësaj vaksine janë të shpeshta (19,20)

Gjithsesi duhet përmendur që studimi mbart të metat e metodave retrospektive, që kanë si pasojë kontrollin relativisht të dobët mbi të dhënat, duke rritur kështu mundësinë e gabimit nga shpërndarja. Kjo bën të nevojshëm ndërmarrrjen e studimeve të tjera më të kontrolluara për të rikonfirmuar rezultatet e mësipërme.

Duke qenë se Shqipëria dallohet për shumëllojshmëri të relievit dhe mikroklimave studime të mëtejshme mund të bëhen për këtë bimë apo edhe të tjera. Njohuritë që do të dilnin nga këto studime do të ishin me vlerë ndër të tjera edhe për mjekësinë veçanërisht për alergologjinë pasi do të ndihmonte në diagnostikimin dhe trajtimin e polinozave ndaj poleneve përkatëse.

REFERENCAT

1. Serafini U. Studies on hay fever with special regard to pollinosis due to *Parietaria officinalis*. *Acta Allergol* 1975;11:3-20.
2. Bousquet J, Hewitt B, Guerin B, Dhivert H, Michel FB. Allergy in the Mediterranean area. II: crossallergenicity among *Urticaceae* pollens (*Parietaria* and *Urtica*). *Clin Allergy* 1986;16:57-64.
3. Holgate ST, Jackson L, Watson HK, Ganderton MA. Sensitivity to *Parietaria* pollen in the Southampton area as determined by skin-prick and RAST tests. *Clin Allergy* 1988;18:549-56.
4. D'Amato G, Ruffilli A, Sacerdoti G, Bonini S. *Parietaria* pollinosis: a review. *Allergy* 1992;47:443-9.
5. Colombo P, Bonura A, Costa M, et al. The allergens of *Parietaria*. *Int Arch Allergy Immunol* 2003;130: 173-9.
6. Cvitanović S. Allergy to *Parietaria Officinalis* Pollen. *Croat Med J*. 1999;40(1):42-8.
7. Cortes L, Carvalho AL, Todo-Bom A, Faro C, Pires E, Verissimo P. Purification of a novel aminopeptidase from the pollen of *Parietaria judaica* that alters epithelial integrity and degrades neuropeptides. *J Allergy Clin Immunol* 2006;118:878-84.
8. Hernández Prieto M, Lorente Toledano F, Romo Cortina A, et al. Pollen calendar of the city of Salamanca (Spain). *Aeropalynological analysis for 1981-1982 and 1991-1992*. *Allergol Immunopathol (Madr)* 1998;26:209-2.
9. Bousquet J, Cour P, Guerin B, Michel FB. Allergy in the Mediterranean area. I. Pollen counts and pollinosis of Montpellier. *Clin Allergy* 1984;14:249-58.
10. Papageorgiou PS: Particularities of pollen allergies in Greece. *Pediatr Pulmonol Suppl* 1999; 18:168-71.
11. Terzioğlu E, Sin A, Kokuludağ A, et al. Sensitivity to *Parietaria* pollen in Izmir, Turkey as determined by skin prick and serum specific IgE values. *J Investig Allergol Clin Immunol* 1998;8:180-3.
12. Toubi E, Kessel A, Blant A, Golan TD. Follow-up after systemic adverse reactions of immunotherapy. *Allergy* 1999;54:617-20.
13. D'Amato G, Spieksma FT, Liccardi G, et al. Pollen-related allergy in Europe. *Allergy* 1998;53:567-78.
14. D'Amato G, Lobefalo G. Allergenic pollens in the southern Mediterranean area. *J Allergy Clin Immunol* 1989;83:116-22.
15. Busse WW, Reed CE, Hoehne JH. Where is the allergic reaction in ragweed asthma? *J Allergy Clin Immunol* 1972;50:289-93.
16. Gjebrea E, Priftanji A, Shytaj. *Aerobiologjia - një disiplinë e re në shërbim të alergologjisë. të dhëna mbi situatën polenike në Tiranë. Studime biologjike*. 2001;5 - 6;507-9.
17. <http://www.randomizer.org/form.htm>
18. Abramson MJ, Puy RM, Weiner JM. Is allergen immunotherapy effective in asthma? *Am J Respir Crit Care Med* 1995;151:969-74.
19. Cvitanović S, Zekan L, Capkun V, Marusić M. Specific hyposensitization in patients allergic to *Parietaria officinalis* pollen allergen. *J Investig Allergol Clin Immunol* 1994;4:283-90.
20. Barnes PJ. Is there a role for immunotherapy in the treatment of asthma? *Am J Respir Crit Care Med* 1996;154:1227-8.

GEOGRAPHIC DISTRIBUTION CHARACTERISTICS OF PARIETARIA POLLINOSIS IN THE CITIES OF KRUIJA, BERAT AND TIRANA

Kastriot Shytaj¹ Arben Boçari², Mehmet Hoxha³, Elona Gjebrea³, Leonard Deda⁴

¹Diagnostics and Medical Rehabilitation Department, Faculty of Nursing, Tirana Univeristy, Tirana, Albania.

²Informatics and Mathematics Department Faculty of Economics and Agrobusiness, Tirana University of Agriculture, Tirana, Albania.

³Clinic of Allergy, Univeristy Hospital Centre “Mother Teresa”, Tirana, Albania.

⁴Faculty of Medicine, University of Tirana.

ABSTRACT

Background. Parietaria is a highly allergenic herb that is found mainly in the Mediterranean area. Bronchial Asthma associated with rhinoconjunctivitis is the main disease of Parietaria pollinosis. This is most commonly found in rough and dry areas around ancient castles. The aim of this study was to find out if exposure to this allergen increases sensitivity in allergic patients.

Method. This is a retrospective study based on review of clinical records of patients presented at Allergology Clinic of University Health Centre “Mother Theresa” of Tirana Clinic between 1996-2002 from districts of Kruja, Berat and Tirana.

Results. 1368 patients were found to have respiratory symptoms. All of them had undergone a skin prick test with a standard battery of 20 most common pneumoallergens with at least one positive allergen. There was no significant difference between prevalence of sensitization from Parietaria among Kruja and Berat, but there were a very significant differences ($p < 0.001$) between these two regions and Tirana. 17% of patients had Allergic Rhinitis only, and 83% had both Allergic Rhinitis and Bronchial Asthma.

Discussion and Conclusion Tirana, Kruja and Berat are regions located both in the Middle of Albania with close proximity to each other and nearly the same distance from the sea shore. Citizens of Kruja and Berat are living near ancient castles, which are areas that are infested by Parietaria. Patients from these two regions had increased prevalence of sensitization compared to patients residing in Tirana.

Key words: Parietaria, polinosis, Bronchial Asthma, Allergic Rhinitis.

IMPAKTI I POLITIKAVE TË ISKSH-SË NË REZULTATET E REFORMËS FINANCIARE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHQIPËRI

Gazment Koduzi ¹

¹ Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH), Tirane, Shqipëri

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 96-102

REZYME

Ky studim ka për qëllim të masë impaktin e mekanizmave të financimit të qendrave shëndetësore të artikuluar në politikat e ISKSH në funksion të performances së personelit të tyre. Kjo do të arrihet përmes matjes të maten 3 komponentëve: a-Financat e qendrave shëndetësore në vite – do të maten nëpërmjet buxhetit vjetor të realizuar dhe atë të planifikuar, marrë nga sistemi i informacionit financiar të ISKSH-së; b-Performanca e qendrave shëndetësore – do të matet nëpërmjet indikatorëve të performancës dhe të bonusit të vendosura zyrtarisht nga ISKSH-ja në kontratën e qendrave shëndetësore; c-Niveli i njohurive të personelit shëndetësor për reformën – do të matet nëpërmjet një pyetësi të vetëadministruar. Nga analizimi i të dhënave duket qartë që politikat financiare të ndjekura nga ISKSH për të maksimalizuar rezultatet e reformës në kujdesin shëndetësor parësor kanë qenë të sukseshme. Performanca e QSh është rritur në mënyrë të qëndrueshme, duke reflektuar rritjen e besimit të popullatës të mjeku i familjes. Krahasuar me vitin 2007, performanca është rritur ndjeshëm deri në vitin 2010 me 37.5%.

Bonusi është rritur me gati 7% në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008, ndërkohe që në vitin 2010 është ulur me gati 15% krahasuar me vitin 2008 dhe është ulur me 22% krahasuar me vitin 2009, me një diferencë statistikisht të rëndësishme mes tyre. Nga intervistimi i stafit shëndetësor doli që shumica e Drejtorëve të QSh shprehën se janë dakort dhe shumë dakort që dokumenti i reformës është i qartë (86%) ndërkohë vetëm 14% nuk janë dakort ose aspak dakort që dokumenti i reformës është i qartë. Shumica e Drejtorëve (69%) u shprehën që janë dakort dhe shumë dakort që trainingimi për reformën ishte i mjaftueshëm, ndërsa 31% u shprehën që nuk janë dakort ose aspak dakort.

Fjalë Kyç: Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH), reforme, indikatore, performance, bonus, Qëndrat Shëndetësore (QSh), kujdesi shëndetësor parësor (KShP)

HYRJE

Pas Luftës së Dytë botërore Shqipëria u bë pjesë e bllokut socialist të lindjes nën ndikimin sovjetik. Pjesë e këtij ndikimi u bë edhe fusha e shëndetësisë, ku Shqipëria zbatoi sistemin Shemashko. Nën diktaturë rolin e politik bërësit, financuesit dhe ofruesit të shërbimeve shëndetësore e luante Ministria e Shëndetësisë. Me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri në vitin 1992 nuk kishte institucione financiare që mund të parandalonin shkatërrimin financiar të familjeve shqiptare nga pasojat financiare të semundjeve si dhe të kryente funksionin e blerjes së shërbimeve shëndetësore për popullatën e mbuluar me sigurim shëndetësor. Për këtë qëllim në vitin 1995 u krijua Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH). Fillimisht ISKSH kishte kontrata financimi me Mjekët e familjes dhe farmacistë e rrjetit të hapur (që ishin të gjitha private) për lëshimin

dhe rimbursimin e barnave me recetë. Me fillimin e reformës financiare, organizative dhe ligjore në kujdesin parësor në vitin 2007, ISKSH u bë financuesi i vetëm i këtij shërbimi përmes kontratave me Qendrat shëndetësore. Qëllimi kryesor ishte shpërblymimi financiar i praktikave më të mira dhe përmirësimi i rezultateve të kujdesit shëndetësor, si dhe të krijojë stimul për ofruesit që të jenë efficient ose më të përgjegjshëm ndaj përdoruesve të shërbimeve shëndetësore. Ky ishte një prej mekanizmave kryesorë të përdorur nga ISKSH në kontraktimin e Qendrave Shëndetësore (QSh) që prej fillimit të reformës shëndetësore në kujdesin shëndetësor parësor. Formula e re e financimit: 85% e buxhetit fiks për aktivitetin e përditshëm të QSh, 10% e buxhetit sipas performancës së mjekëve të familjes dhe 5% e buxhetit sipas indikatorëve të procesit (te quajtur bonus) me qëllim matjen e rezultateve të kujdesit shëndetësor në popullatën nën kujdesin e QSh. QSh kanë të drejtë që bazuar në mjetet

financiare të fituara bazuar në performancë, të japin dy herë në vit shpërblim për stafin mjeksor deri në dy paga mujore me qëllim motivimin financiar të tyre. Tema e studimit “Impakti i politikave të ISKSH-së në rezultatet e reformës financiare në kujdesin shëndetësor parësor në shqipëri” ka për qëllim hulumtimin nëse ka qënë e sukseshme politika financiare e ISKSH-së, bazuar në rezultatet e matura përmes indikatorëve dhe opinionit të personelit shëndetësor në qendrat shëndetësore të përzgjedhura për studim.

QELLIMI STUDIMIT

Të masë impaktin e mekanizmave të financimit të qendrave shëndetësore të artikuluar në politikat e ISKSH në funksion të performances së personelit të tyre.

MATERIALI DHE METODAT

Studimi është i tipit cross sectional. Target i studimit janë Qendrat Shëndetësore (QSh) në kujdesin parësor, mjekët e familjes dhe infermieret që punojnë në qendrat shëndetësore të përzgjedhura.

Ky studim synon të masë impaktin e mekanizmave financiare në QSh në funksion të performancës së personelit shëndetësor, sipas këtyre komponentëve: financat e QSh, performance e QSh dhe niveli I njohurive I stafit mjeksor për reformën, në qendrat shëndetësore të përzgjedhura.

Zgjedhja e mostrës:

Sistemi parësor në Shqipëri është i përbërë nga 419 qendra shëndetësore (QSh) të krijuara me fillimin e reformës në kujdesin shëndetësor parësor në vitin 2007. Të gjitha QSh kanë kontrate financimi me Insitutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor e cila është njëjtë për të gjitha. Pra, të gjitha qendrat shëndetësore janë të përshtatshme për të qënë pjesë e procesit të përzgjedhjes së mostrës.

52 qendra shëndetësore u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme për të qënë pjesë e studimit. Intervistimi I stafit mjeksor u krye duke përdorur një pyetësor të strukturuar paraprakisht dhe të vet-administruar. Të dhënat për aktivitetin financiar u morën nga database e ISKSH-së.

Instrumentat për mbledhjen e të dhënave janë: Pyetësor i vetëadministruar për vlerësimin e njohurive të personelit shëndetësor për reformën në parësor; të dhënave për indikatorët e performancës dhe bonusit janë marrë

nga Sistemi i Informacionit Shëndetësor (Sistemi i Informacionit Shëndetësor); analizimi i buxhetit të qendrave shëndetësore nga sistemi i raportimit financiar të ISKSH-se.

Metodat e mbledhjes e të dhënave:

Procesi i mbledhjes së të dhënave bazuar në instrumentat e përmendur më lart:

- 1- Pyetësor i vetëadministruar për vlerësimin e njohurive të personelit shëndetësor për reformën në parësor. I njëjti pyetësor u aplikua te të gjithë personeli shëndetësor i QSh të përzgjedhura për studim, që u gjenden në vendin e punës ditën e intervistimit. Pyetësori u përpilua duke patur parasysh komponentet kryesorë të reformës në parësor të zbatuara gjatë viteve 2007-2010 për të cilët do të merrej informacioni dhe opinion i personelit. **Testimi në terren** i pyetësorit u krye përpara se të përdorej për studimin, me qëllim për të finalizuar mënyrën e përpilimit të pyetjeve dhe gjuha e përdorur të ishte e kuptueshme nga personeli që do të intervistohesh.
- 2- Sistemi i Informacionit Shëndetësor është i bazuar në informacionin e mbledhur nga “Formulari i vizitës” dhe “Formulari i procedurave mjeksore” të plotësuar në mënyrë individuale për çdo vizitë të kryer nga mjekët apo infermieret në QSh. Ky system është funksional mbarë kombëtar prej vitit 2009. Plani i analizës i cili u mbështet në SISH, përfshinte variablet e indikatorëve të përdorur për matjen e performancës (10%) dhe bonusit (5%).
- 3- Sistemi i raportimit financiar është i bazuar në informacionin që raportohet për realizimin e buxhetit të qendrave shëndetësore bazuar në 3 komponentet e buxhetit: 80 % (financimi bazë) + 10% (performanca) + 5 % (bonusi)


Plani i analizës bazohet në buxhetin e planifikuar dhe në buxhetin e realizuar nga QSh gjatë vitit përkatës fiskal.

Analizimi I të dhënave u krye duke përdorur SPSS 19.0. Indikatorë të përzgjedhur u ekzaminuan kundrejt një seti variablash duke përdorur Chi-square test dhe ANOVA.

REZULTATET

Studimi u krye në 52 QSh në të gjithë vendin, ku shumica e tyre 71% ushtrojnë aktivitetin në zonat rurale dhe 29% në zonat urbane (Grafiku 1)


QSH sipas Urban/Rural



Grafiku 1: Shpërndarja e QSH në studim sipas zonave Urban / Rural

Shumica e personelit të intervistuar janë infermiere 73% ndërsa vetëm 27% e tyre i përkasin profesionit Mjek (Grafiku 2).

Struktura e personelit te intervistuar (%)



Grafiku 2: Struktura e personelit të intervistuar sipas profesionit Mjek / Infermier


Në të gjitha QSh pjesë e studimit, pyetjes nëse jeni Drejtor apo jo, i janë përgjigjur pozitivisht 52 Mjekë. Kjo tregon që aktualisht menaxherët e QSh-ve në kujdesin shëndetësor parësor janë me profesion Mjek(Tabela 1).

Tabela 1: Struktura e Drejtorëve të QSh sipas profesionit Mjek / Infermier

Profesioni	A jeni Drejtor i nje QSH		Total
	Po	Jo	
Mjek	52	132	184
Infermiere	0	500	500
Total	52	632	684

Shumica e Drejtorëve të QSh shprehen se janë dakort dhe shumë dakort që dokumenti i reformës është i qartë (86%) ndërkohë vetëm 14% nuk janë dakort ose aspak dakort që dokumenti i reformës është i qartë (Grafiku 3).


Dokumentit i reformes eshte i qarte



Grafiku 3: Dakortësia e Drejtorëve të QSh për dokumentin e refrmës në parësor

Kur filloi reforma në KShP në vitin 2007 Mjekët që u emëruan Drejtues të QSh-ve nuk kishin studiuar për menaxhim shëndetësor, kështu që u ndërmorën disa trainime për sqarimin e elementëve të reformës. Pyetjes nëse trainimi për refomën ishte i mjaftueshëm, 69% u shprehën që janë dakort dhe shumë dakort, ndërsa 31% u shprehën që nuk janë dakort ose aspak dakort (Grafiku 4).


Trajnimi mbi reformen eshte i mjaftueshem



Grafiku 4: Dakortësia e Drejtorëve të QSh mbi trainimin mbi refomën

Megjithëse shumica e Drejtorëve shprehen që trainimi mbi reformën është i mjaftueshëm, kur pyeten nëse kanë nevojë për më shumë trainim për të zbatuar reformën, 67% shprehen se janë dakort ose shumë dakort, dhe vetëm 33% shprehen se nuk kanë nevojë për më shumë trainim për refomën (Grafiku 5).

Kam nevoje per me shume trajnim per te zbatuar reformen




Grafiku 5: Dakortësia e Drejtorëve të QSh mbi nevojën për më shumë trainim për refomën

Krahasuar me vitin 2007, performanca është rritur ndjeshëm deri në vitin 2010 me 37.5%, me diferencë statistikisht të rëndësishme ($p < 0.001$). Performanca është rritur 33% në vitin 2008 krahasuar me v.2007, ndërkohë është ulur me gati 3% në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 (por pa një diferencë statistikisht të rëndësishme, $p = 0.986$), ndërkohe që në vitin 2010 është rritur me 4% krahasuar me vitin 2008 dhe po ashtu është rritur me rreth 7% krahasuar me vitin 2009, pa diferencë statistikisht të rëndësishme mes tyre ($p = 0.519$). (Testi ANOVA one-ëay)(Tabela 2).

Tabela 2: Ecuria e performancës gjatë viteve 2007-2010


	Rajoni	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
1	Berat	59.7	85	83.1	91.7
2	Diber	58.4	84	88.2	93.2
3	Durres	49.7	56	57.5	72.2
4	Elbasan	31.1	67.9	58.5	78.6
5	Fier	61.8	82.4	86	80.8
6	Gjirokastrer	21.1	61.6	56.6	88.6
7	Korce	59.0	92.7	94.3	96
8	Kukes	41.5	78	71.9	64.9
9	Lezhe	43.1	75.9	80.9	88.8
10	Shkoder	30.8	49.6	57.9	71.3
11	Tirane	73.3	99.2	93.1	94.7
12	Vlore	50.0	94.5	78.7	97.6
13	Sarande	23.8	84.5	65.5	50.6
14	Tropoje	33.8	100	99	100
	Mesatare	46.0	79.4	76.5	83.5
	Diferenca mes v.2007 dhe ..	-	↑ 33.4%	↑ 30.5%	↑ 37.5%
	Diferenca mes v.2008 dhe ..	-	-	↓ 2.8%	↑ 4%
	Diferenca mes v.2009 dhe 2010	-	-	-	↑ 6.9%

Grafiku 6 e shpreh në mënyrë vizuale më të qartë se si ka evoluar realizimi i performancës gjatë viteve 2007-2010, sipas Rajoneve ku kryejnë veprimtarinë QSh e përfshira në studim si dhe nivelit të realizimit.



Grafiku 6: Ecuria e performancës sipas viteve dhe Rajoneve ku kryejnë aktivitetin QSh

Megjithëse mesatarja e rritjes së performancës ishte 7% në vitin 2010 krahasuar me 2009, nëse bëjmë një grupim të rajoneve bazuar në diferencën e nivelit të performancës 2010-2009, sipas kriterëve: rritje deri 5%, deri 10%, deri 15% dhe mbi 15%, si dhe ulje mbi 5%, kemi një pamje shumë interesante. Shumica e rajoneve kanë patur rritje deri 5% (4 nga 12 rajone), nga 2 rajone kanë patur rritje deri në 10% dhe deri 15%, dhe vetëm 1 rajon ka patur rritje mbi 15% të performancës. Ndërkohë janë 3 rajone që kanë patur ulje mbi 5% të performancës gjatë vitit 2010 (Grafiku7).




Grafiku 7: Grupimi i rajoneve sipas nivelit të ndryshimit të performancës

Së fundmi është e mundur që PCT të performojë ndryshe në sepsisin neonatal për shkak të patogjenëve gram-pozitiv, gram-negativ, ose fungal. Prandaj jo vetëm karakteristikat klinike të neonatëve të përfshirë, por edhe profili mikrobiologjik lokal në një repart të terapisë intensive (NICU) ka të ngjarë të ndikojë në vlerën e PCT

REFERENCAT

1. American College of Obstetricians and Gynecologists. *Premature Rupture of Membranes*. Washington, DC: American College of Obstetricians and Gynecologists; 1998. ACOG Practice Bulletin No1
2. ACOG Committee on Practice Bulletins Obstetrics. ACOG Practice Bulletin No. 80: premature rupture of membranes. Clinical management guidelines for obstetrician-gynecologists. *Obstet Gynecol* 2007;109:1007-1019
3. Alexander JM, Cox SM. Clinical course of premature rupture of the membranes. *Semin Perinatol*. 1996;20:369-374
4. Duff P. Premature rupture of the membranes in term patients. *Semin Perinatol*. 1996;20:401-408.
5. Ohlsson A. Treatments of preterm premature rupture of the membranes: a meta-analysis. *Am J Obstet Gynecol*. 1989;160:890-906
6. Mercer BM, Goldenberg RL, Meis PJ, et al. The Preterm Prediction Study: prediction of preterm premature rupture of membranes through clinical findings and ancillary testing. The NICHD Maternal-Fetal Medicine Units Network. *Am J Obstet Gynecol*. 2000;183:738-745
7. Garite TJ. Management of premature rupture of membranes. *Clin Perinatol*. 2001;28:837-847
8. Harger JH, Hsing AW, Tuomala RE, et al. Risk factors for preterm premature rupture of fetal membranes: a multicenter case-control study. *Am J Obstet Gynecol*. 1990;163:130-137
9. Spinillo A, Montanari L, Sanpaolo P, et al. Fetal growth and infant neuro-developmental outcome after preterm premature rupture of membranes. *Obstet Gynecol*. 2004;103:1286-1293
10. Ramsey PS, Lieman JM, Brumfield CG, Carlo W. Chorioamnionitis increases neonatal morbidity in pregnancies complicated by preterm premature rupture of membranes. *Am J Obstet Gynecol*. 2005 Apr;192(4):1162-6

11. Amin AF, Mohammed MS, Sayed GH, AbdelRazik S. In laboring women with oligohydramnios. *Int J Gynaecol Obstet.* 2003;81:183-189
12. Yoon BH, Romero R, Park JS, et al. Fetal exposure to an intraamniotic inflammation and the development of cerebral palsy at the age of three years. *Am J Obstet Gynecol.* 2000;182:675-681
13. Erdemoglu E, Mungan T. Significance of detecting insulin like growth factor binding protein-1 in cervicovaginal secretions: comparison with nitrazine test and amniotic fluid volume assessment. *Acta Obstet Gynecol Scand.* 2004;83:622-626
14. Hannah ME, Hodnett ED, Willan A, et al. Prelabor rupture of the membranes at term: expectant management at home or in hospital? The Term PROM Study Group. *Obstet Gynecol.* 2000;96: 533-538
15. Mercer BM. Preterm premature rupture of the membranes: current approaches to evaluation and management. *Obstet Gynecol Clin North Am.* 2005;32:411-428
16. Di Renzo GC, Roura LC, for the European Association of Perinatal Medicine-Study Group on Preterm Birth. Guidelines for the management of spontaneous preterm labor. *J Perinat Med.* 2006
17. Rand L, Soto E, Norwitz ER, et al. The efficacy of antenatal corticosteroids between 32 and 34 weeks in patients with preterm premature rupture of membranes [abstract 343]. Presented at 53-rd Annual Meeting of the Society for Gynecologic Investigation; March 22-25, 2006; Toronto, Ontario, Canada
18. Tutchfield P, Whitaker R, Russell I, et al.; Antenatal Steroids for Term Elective Caesarean Section (ASTECS) Research Team. Antenatal betamethasone and incidence of neonatal respiratory distress after elective caesarean section: pragmatic randomised trial. *BMJ.* 2005;331:645-646
19. Peranteau WH, Wilson RD, Liechty KĚ, et al. Effect of maternal betamethasone administration on prenatal congenital cystic adenomatoid malformation growth and fetal survival. *Fetal Diagn Ther.* 2007;22:365-371
20. Wapner RJ, Sorokin Y, Thom EA, et al.; National Institute of Child Health and Human Development Maternal Fetal Medicine Units Network. Single versus weekly courses of antenatal corticosteroids: evaluation of safety and efficacy. *Am J Obstet Gynecol.* 2006;195:633-642
21. Crowther CA, Haslam RR, Hiller JE, et al.; Australasian Collaborative Trial of Repeat Doses of Steroids (ACTORDS) Study Group. Neonatal respiratory distress syndrome after repeat exposure to antenatal corticosteroids: a randomised controlled trial. *Lancet.* 2006;367:1913-1919
22. Bonanno C, Fuchs K, Wapner RJ. Single versus repeat courses of antenatal steroids to improve neonatal outcomes: risks and benefits. *Obstet Gynecol Surv.* 2007;62:261-271
23. Mercer BM. Is there a role for tocolytic therapy during conservative management of preterm premature rupture of the membranes? *Clin Obstet Gynecol.* 2007;50:487-496
24. Coombs CA, McCune M, Clark R, Fishman A. Aggressive tocolysis does not prolong pregnancy or reduce neonatal morbidity after preterm premature rupture of the membranes. *Am J Obstet Gynecol.* 2004;190:1723-1728
25. Wolfensberger A, Zimmermann R, von Mandach U. Neonatal mortality and morbidity after aggressive long-term tocolysis for preterm premature rupture of the membranes. *Fetal Diagn Ther.* 2006;21:366-373
26. Schrag S, Gorēitz R, Fultz-Butts K, Schuchat A. ; Prevention of perinatal group B streptococcal disease. Revised guidelines from CDC. *MMĚR Recomm Rep.* 2002;51:1-22
27. American College of Obstetricians and Gynecologists. ACOG Committee Opinion: number 279, December 2002. Prevention of early-onset group B streptococcal disease in newborns. *Obstet Gynecol* 2002;100:1405-1412
28. Kenyon SL, Taylor DJ, Tarnoē-Mordi W; for the ORACLE Collaborative Group. Broad-spectrum antibiotics for preterm, prelabor rupture of fetal membranes: the ORACLE I randomized trial. *Lancet.* 2001;357:979-988
29. Kenyon S, Boulvain M, Neilson J. Antibiotics for preterm rupture of the membranes: a systematic review. *Obstet Gynecol* 2004;104:1051-1057
30. Kenyon S, Boulvain M, Neilson J. Antibiotics for preterm rupture of membranes. *Cochrane Database Syst Rev.* 2003;2:CD001058
31. ACOG practice bulletin. Antepartum fetal surveillance. Number 9, October 1999 (replaces Technical Bulletin Number 188, January 1994). Clinical management guidelines for obstetrician-gynecologists. *Int J Gynaecol Obstet.* 2000;68:175-185
32. McElrath TF, Norwitz ER, Lieberman ES, Heffner LJ. Management of cervical cerclage and preterm premature rupture of the membranes: should the stitch be removed? *Am J Obstet Gynecol.* 2000; 183:840-846

33. Harding JE, Pang J, Knight DB, Liggins GC. Do antenatal corticosteroids help in the setting of preterm rupture of membranes?. *Am J Obstet Gynecol.* 2001;184:131-9
34. Ehernberg HM, Mercer BM. Antibiotics and the management of preterm premature rupture of the fetal membranes. *Clin Perinatol.* 2001;28:807-18
35. Mercer BM. Preterm premature rupture of the membranes. *Obstet Gynecol.* 2003;101:178-93
36. Rotschild A, Ling J, Puterman ML, Farquharson D. Neonatal outcome after prolonged preterm rupture of the membranes. *Am J Obstet Gynecol.* 1990;162:46-52
37. Manuck TA, Eller AG, Esplin MS, Stoddard GJ, Varner MW, Silver RM. Outcomes of expectantly managed preterm premature rupture of membranes occurring before 24 weeks of gestation. *Obstet Gynecol.* 2009 Jul;114(1):29-37
38. Linder N, Ohel G, Gas Keidar D, Tamir, B. Reichman Neonatal sepsis after prolonged premature rupture of membranes. *J Perinatol* 1995
39. H W Kilbride, D W Thibeault Neonatal complications of preterm premature rupture of membranes. *Pathophysiology and management. Clin Perinatol.* 2001 Dec; 28 (4):761-85 11817188
40. Shalini T, G.K Malik Neonatal sepsis: past, present and future; a review article. *Journal of Medical* 2010 July; 5 (2):45-54
41. Egarter C, Leitich H, Karas H, F WIESER Husslein P, Kaider A, et al. Antibiotics treatment in preterm premature rupture of membranes and neonatal morbidity: a metaanalysis. *Am J Obst Gynecol* 1996; 174: 589-97
42. Bromberger P, Lawrence JM, Brown D, Saunders B, Contreras R, Petitti DB. The influence of intra-partum antibiotics on the clinical spectrum of Early-Onset group B streptococcal infection in term infants. *Pediatrics* 2000; 106: 244-50

ETIOLOGY, DIAGNOSIS AND MANAGEMENT OF THE PREGNANCIES WITH PREMATURE RUPTURE OF THE FETAL MEMBRANES

Alma Nurçe¹, Nader Hajro¹, Enkeleida Kamberi², Alban Bajrami³, Edmond Pistulli¹

¹ Faculty of Nursing, University of Tirana, Albania

² Obstetric-Gynecologic Hospital "Koco Glozheni" Tirana

³ Faculty of Medicine, Tirana, Albania

ABSTRACT:

Premature rupture of membranes is the rupture of the fetal membranes before the onset of labor. In most cases, this occurs near term, but when membrane rupture occurs before 37 weeks' gestation, it is known as preterm premature rupture of membranes. It complicates approximately 3% of pregnancies and leads to one third of preterm births. It increases the risk of prematurity and can lead to significant perinatal morbidity, including respiratory distress syndrome, neonatal sepsis, umbilical cord prolapse, placental abruption and fetal death. Appropriate evaluation and management are important for improving neonatal outcomes. Treatment varies depending on gestational age and includes consideration of delivery when rupture of membranes occurs at or after 34 weeks' gestation. Corticosteroids can reduce many neonatal complications, particularly intraventricular hemorrhage and respiratory distress syndrome, and antibiotics are effective for increasing the latency period.

Key words: premature rupture of membranes, early birth, expectant management of labor, antenatal corticosteroids, antibiotic

STRATEGJITË E PËRBALLIMIT TË STRESIT TEK PËRKUJDESËSIT E PACIENTËVE ME KANCER

Veronika Duci¹

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Politikës dhe Punës Sociale, Shqipëri

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 117-121

REZYME:

Ky artikull ka si qëllim të shqyrtojë disa prej studimeve që janë kryer në fushën e përkujdesjes për pacientët me kancer të staveve të ndryshme. Konkretisht, fokusi në këtë artikull vihet në strategjitë e përballimit të stresit të përdorura nga vetë përkujdesësit. Përkujdesja për pacientët me kancer shoqërohet me një sërë problemesh, si në shëndetin fizik ashtu dhe në atë mendor. Në studime të ndryshme janë identifikuar faktorët që ndërmjetësojnë përkeqësimin apo përmirësimin e simptomave fizike dhe mendore të përkujdesjes. Disa nga këta faktorë janë: mbështetja sociale, vlerësimi i përkujdesjes, moshë, statusi funksional i pacientit, cilësia e perceptuar e jetës etj. Strategjitë e përballimit të stresit janë të rëndësishme dhe ndërmjetësuese për vazhdimin e përkujdesjes, por edhe për cilësinë me të cilën po ofrohet.

Fjalë kyç: përkujdesës, kancer, stresi, strategji përballimi, shëndeti.

HYRJE

Kur individët përballet me një ngjarje traumatike, ata duhet të përdorin një sërë strategjish për të përballuar dhe ndryshuar stresin që po përjetojnë. Një nga modelet më të njohura të përballjes me stresin është ai i Lazarus dhe Folkman, i cili përdoret edhe në fushën e stresit që shkaktohet nga kërcënimi për jetën (Lazarus dhe Folkman, 1984). Lazarus dhe Folkman (1984) kanë përkufizuar përballjen me stresin si një përpjekje për të manaxhuar kërkesat e jashtme ose të brendshme. Kërkesat e jashtme i referohen vetë ngjarjes ndërsa ato të brendshme i referohen reagimit emocional ndaj ngjarjes. Dallimi ka çuar në një diferencim mes përballjes së orientuar ndaj problemit (reagimet drejtohen drejt ngjarjes së jashtme) dhe asaj të orientuar ndaj emocionit (reagimet drejtohen ndaj reagimeve emocionale të individit ose ndaj gjendjeve të brendshme). Ajo çfarë modeli sugjeron është se përballja me stresin është një proces dhe jo një ngjarje e vetme.

Kanceri, siç përkufizohet nga Mages dhe Mendelsohn (1979), përmban rrezikun e një stresi të vazhdueshëm dhe të zgjatur në kohë që rezulton nga zbulimi i sëmundjes, procesin e diagnostikimit, ndërhyrjet kirurgjikale, trajtimi mjekësor, monitorimi pas trajtimit dhe frika e ripërsëritjes. Mënyra se si pacientët me kancer përshtaten me këto ndryshime në jetën e tyre, të shkaktuara nga eksperiencia të vazhdueshme stresuese varet nga mënyrat e përballimit të stresit (Spencer, Carver dhe Price, 1998).

Në studime të tjera (Carver, Scheier dhe Weintraub, 1989; Scheier, Carver dhe Bridges, 1994), strategjitë e përballimit klasifikohen për nga rezultati që kanë në ato me vlerë adaptive apo funksionale; efektiviteti i tyre është vlerësuar në terma të eliminimit të stresorit/distresit dhe ruajtjes së funksionimit social si dhe të sensit të mirëqënies (Zeidner dhe Saklofske, 1996). Kërkimet kanë treguar se përballja e orientuar ndaj problemit është më efektive se sa ajo e orientuar ndaj emocioneve në terma të reagimeve emocionale dhe niveleve të performancës në një situatë stresuese. Përpjekjet e orientuara ndaj problemit janë përpjekje për të bërë diçka më konstruktive rreth kushteve stresuese, të cilat mund të dëmtojnë, kërcënojnë ose sfidojnë një individ, ndërsa strategjitë e përballjes të orientuara ndaj emocioneve përfshijnë përpjekje për të rregulluar pasojat emocionale të ngjarjes stresuese. Taylor (1991) thekson se ndonëse të dyja strategjitë mund të përdoren në të gjitha rastet stresuese, përpjekjet për ta zgjidhur problemin janë veçanërisht të dobishme për të kontrolluar stresorë, ndërsa ato për të rregulluar emocionet përshtaten për të manaxhuar impaktin e stresorëve të pakontrollueshëm.

Gjatë përballjes me ngjarje stresuese, individët mund të bazohen në një shumëllojshmëri burimesh për t'i ndihmuar në procesin e përshtatjes dhe përballjes, duke përfshirë burime financiare, mbështetje sociale, arsimit, inteligjencën dhe predispozitat e personalitetit. Në një kontekst mjekësor burimet financiare dhe aftësitë

e personelit shëndetësor janë shumë të rëndësishme. Megjithatë, nuk mund të lihet pa përmendur rëndësia e burimeve sociale dhe personale. Nga këto dy të fundit, mbështetja sociale (formale dhe joformale) konsiderohet si më shumë e rëndësishme: ndihma e prekshme dhe e paprekshme që merr individi nga familja dhe miqtë, si dhe nga stafi i shëndetësisë në situata stresuese (Gilbar dhe Zusman, 2007).

STRATEGJITË E PËRBALLIMIT TË STRESIT

Carver, Scheier dhe Weintraub (1989) kanë ndarë strategjitë e përballimit të stresit në 15 të ndryshme. Ato paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Klasifikimi i strategjive të përballjes (Carver, Scheier dhe Weintraub, 1989)	
Tipi i strategjisë	Shembull
Riinterpretimi pozitiv dhe rritja	Kërkoj për diçka të mirë në atë që po ndodh.
Shkëputje mendore	Merrem me punë ose me aktivitete të tjera për ta hequr mendjen nga gjëra të tjera.
Fokus ose shfryrje e emocioneve	Shqetësohen dhe shfryj emocionet e mia.
Përdorimi i mbështetjes sociale instrumentale	Pyes njerëzit me eksperiencë të ngjashme se çfarë kanë bërë.
Përballja aktive	Bëj veprime shtesë në përpjekje për të zgjidhur problemin.
Kthimi drejt besimit fetar	Kërkoj ndihmë nga zoti.
Mohimi	Refuzoj të besoj se ka ndodhur në të vërtetë.
Shkëputje sjellore	Braktis përpjekjet për të marrë atë që dua.
Kufizimi	Detyroj veten të pres për kohën e duhur për të bërë diçka.
Marrja e mbështetjes sociale emocionale	Flas me dikë për mënyrën se si ndihem.
Pranimi	Mësoj të jetoj me situatën.
Përdorimi i substancave	Përdor alkool ose substance të tjera për të kaluar problemin.
Shtypja e aktiviteteve konkurruese	Nuk merrem me aktivitete të tjera në mënyrë që të merrem me këtë problem.
Planifikimi	Hartoj një strategji për atë që duhet të bëj.
Humori	bëj shaka lidhur me situatën

FAKTORËT INTRAPERSONALË

Stili i përballimit të stresit tek përkujdesësit

Shmangia është lidhur me një përshtatje të varfër psikologjike tek përkujdesësit (Rodrigue dhe Hoffman, 1994). Ata që shmangnin çështje që lidheshin me gjendjen mjekësore të pacientëve ose me trajtimin ose dorëzoheshin me pasivitet në studimin e Rodrigue dhe Hoffman (1994) ishin më të stresuar. Morse dhe Fife (1998) studiuuan partnerët pas marrjes së diagnozës, në relapsin e parë, pas rikthimit dhe kur pacientët/et ishin në një stad të avancuar. Ata gjetën se shmangia (si p.sh. nuk i tregonin të tjerëve se sa keq ndiheshin ose përdorimi i alkoolit apo medikamenteve) lidhej me një përshtatje më të keqe mes partnerëve, ndërsa mohimi (minimizimi i impaktit të sëmundjes në jetën e tyre) lidhej me një përshtatje pozitive. Mënyra e përballimit të stresit nga pacientët lidhej me distresin e përjetuar nga përkujdesësit. Ey dhe kolegët (1998) gjetën se pacientët burra, të cilët përdornin më shumë shmangien kishin nivele më të larta të ankthit dhe depresionit se sa gratë e tyre. Ptacek dhe kolegët (1994) gjetën se burrat raportojnë më pak probleme të shëndetit mendor kur pacientët përdornin më shumë strategjinë e përballimit të orientuar ndaj problemit dhe më pak atë shmangëse (Pitceathly dhe Maguire, 2003)

KËRKIMI I INFORMACIONIT SI STRATEGJI PËR PËRBALLIMIN E STRESIT

Një mënyrë tjetër për të përballuar stresin lidhet me kërkimin e informacionit. Disa individë priren të kenë më pak stres kur ata janë më të informuar ndërsa disa të tjerë e shmangin atë (monitorimi përkundrejt shmangies së informacionit). Në një studim është eksploruar niveli në të cilin korrespondojnë stilet e përballimit informative të stresit në reagimin psikologjik të 98 çifteve të martuara, ku njëri/a ishte pacienti/ja ndërsa tjetri/a përkujdesësi/ja kryesore. U analizuan efektet e korrespondimit dhe e ndikimit të rolit (pacient përkundrejt përkujdesës) si dhe ato të gjinisë. Rezultatet treguan një model të ndryshëm bazuar në gjininë dhe rolin. Për pacientet femra, korrespondimi në stilin e monitorimit të informacionit me partnerin e tyre lidhej me një reagim psikologjik më të mirë, ndërsa për pacientët burra korrespondimi në stilin e shmangies së informacionit lidhej me një reagim më të mirë psikologjik. Modelet e ndryshme që u morën për nga gjinia dhe roli treguan se roli dhe mungesa e kërkimit të informacionit ishin faktorët kryesorë që ndikonin sjelljen (Barnoy, Bar - Tal dhe Zisser, 2006).

Përkujdesja për individë me sëmundjen e Alzheimer – it mund të konsiderohet si një ngjarje stresuese dhe të kërkojë për strategji adaptimi. Janë studiuar shumë variabla, të cilat janë parë si ndërmjetësuese të ankthit dhe depresionit tek përkujdesësit. Edhe strategjitë e përballimit të stresit janë një nga këto variabla, megjithatë marrëdhënia me barrën e përkujdesjes dhe ankthit dhe depresionin është ende e paqartë. Në këtë studim u vërtetua hipoteza, sipas së cilës përkujdesësit me ankth dhe depresion klinikisht të rëndësishëm kishin më shumë mundësi të përdornin strategji shkëputjeje se sa ata jo – ankthiozë dhe jo – depresivë.

Nga ana tjetër, përkujdesësit, të cilët përdornin strategji përballimi që përfshinin angazhimin raportin nivele ankthi dhe depresioni më të ulëta. Për më tepër, këto rezultate tregojnë se marrëdhënia mes strategjive shkëputjeje të përballimit dhe ankthit/depresionit ishte e fortë, pavarësisht nga karakteristikat demografike dhe klinike si tek pacienti ashtu dhe tek përkujdesësi. Për rrjedhojë, përballimi me stresin është një parashikues i rëndësishëm i distresit të përjetuar nga përkujdesësi (Alberca e të tjerë).

STRATEGJITË E PËRBALLIMIT TË STRESIT DHE CILËSIA E JETËS

Përballja me kancerin e gjirit në një fazë të avancuar është një sfidë si për vetë gratë ashtu dhe për përkujdesësit familjarë. Të rëndësishme në këtë proces janë strategjitë e përballimit të stresit të pacientes dhe të përkujdesësit. Në studimin Kershaw dhe kolegëve (2004) është eksploruar marrëdhënia mes strategjive të përballimit të stresit dhe cilësisë së jetës në diadën paciente – përkujdesës. Analiza e profilit ka treguar se pacientët raportonin një përdorim më të madh të mbështetjes emocionale, mbështetjes në besimin fetar, rimendimit pozitiv, shpërqendrimit, ajrosjes dhe humorit ndërsa përkujdesësit raportonin një përdorim të madh të strategjisë së alkoolit/substancave. Analiza e regresionit tregoi se si tek pacientet ashtu dhe tek familjarët e tyre përballja aktive lidhej me një cilësi jetese më të lartë se sa shmangia. Për më tepër, niveli i distresit ndërmjetësonte lidhjen mes përballjes dhe cilësisë së jetës. Marrëdhënia negative strategjive shmangëse të përballjes dhe shëndetit mendor ishte më e fortë në rastet kur pacientët kishin nivele të ulëta të distresit dhe më e dobët kur pacientet kishin nivele të larta të distresit (Kershaw e të tjerë, 2004)

Në një studim tjetër u eksploruan eksperiencat emocionale dhe strategjitë e përballimit të stresit të përkujdesësve, kur ata kalonin nga diagnoza e një familjari me kancer terminal në fazën e përkujdesjes dhe pas humbjes së tij/saj. Disa gjetje mbështetën literaturën aktuale, sipas së cilës përkujdesja ka një impakt shumë të madh, por gjetje të tjera përballen me konceptin e “barrës”, duke zbuluar se emocione të forta pozitive përjetoreshin nga ata përkujdesës, të cilët e perceptonin përkujdesjen si një mundësi për të shprehur dashurinë e tyre. Pas humbjes u raportua përjetimi i emocionit të zisë në nivele të larta. Kishte një mungesë totale të mbështetjes emocionale nga profesionistët e shëndetësisë, veçanërisht në fazën e humbjes kur ishte shumë e nevojshme (Parker dhe Maddocks, 2001).

Sipas Teschendorf dhe kolegëve (2007) ka dy forma primare të përballjes. Një metodë është ajo e reflektimit personal për mendime specifike në lidhje me eksperiencën e përkujdesjes dhe vlerës apo kuptimit që ka. E dyta, lidhej me përdorimin e mekanizmave vetërregulluese për të shtypur ndjenja të padëshirueshme dhe për të nxjerrë më shumë mesazhe pozitive gjatë kryerjes së rolit. Duke përdorur metodën e parë të përballjes, reflektimin dhe procesimin e brendshëm, përkujdesësit vazhdonin të ishin optimist dhe përpiqeshin të transmetonin këtë shpresë tek pacientët/et. Flisnin për rëndësinë e të qenit pozitiv dhe besimin se ata mund të mbanin përgjegjësinë që iu ishte dhënë. Nga ana tjetër, ata ndiheshin të deprivuar, një koncept që lidhej me burimet e kufizuara, kishin mungesë mbështetjeje dhe më pak kohë për veten e tyre dhe humbje të kënaqësisë. Ata e dinin se dëgjoreshin si “egoist”, por këto ndjenja i kompensonin me dhembshuri, shpresë, durim dhe sensin e përgjegjësisë.

Disa funksione të rëndësishme në jetën e tyre anulloheshin për të ofruar më mirë përkujdesjen; për rrjedhojë, përjetonin humbje të gëzimit dhe liri të kufizuar. Marrëdhëniet familjare të tensionuara çonin në zemërim, frustracion dhe probleme në komunikim. Kërkesat për vëmendje nga pacientët ndonjëherë i linin përkujdesësit me probleme të pazgjidhura në familjen e tyre. Kombinimi i marrëdhënieve konfliktuale në familje, kërkesave të përkujdesjes dhe ndjenja e mungesës së forcës çonin në një besim të ulët dhe mjerim për përkujdesësin, në situata që interpretoreshin si vuajtje. Individët që diskutonin konfliktin, frustracionin dhe vuajtjen përdornin më shumë një metodë dialogu të brendshëm,

ose të mendimeve për të bindur veten se po bënin një gjë të mirë. I thonin vetes së tyre që të jenë të durueshëm, të përgjegjshëm dhe tolerantë ndaj paqëndrueshmërive të të tjerëve. Dialogu i brendshëm shërbente si një metodë për të zbutur emocionet negative dhe për të përforcuar vendosmërinë për sukses.

Metoda e dytë e përballjes me stresin përfshinte përdorimin e vetërregullimit për të kryer rolin. Përkujdesësit ishin të dhembshur dhe mbrojtës; shumë prej tyre rezistonin tundimin për të vendosur nevojat e tyre para atyre të pacientëve. Kontrollonin ndjenjat e tyre kur kryenin detyra të vështira si ndërrimet e rrobave. Me kalimin e kohës, u rrit besimi në detyrën e përkujdesësit, i cili përforcoi bindjen se po bënin një punë të mirë.

Përkujdesësit gjetën mënyra të reja për të mbrojtur veten nga ana emocionale për rolin që kishin ndërmarrë. Mendonin se ishte thelbësore të kontrollonin veten e tyre në mnyrë që të vazhdonin dhe të fshehnin ankthin e tyre. Disa përkujdesës merrnin pak ndihmë për detyrat e vështira. Aspekte specifike të rolit ishin mjaft jo - tërheqëse duke ei detyruar ata të gjejnë metoda inovative për të përmbushur detyrën e tyre ndërsa e fshehnin reagimin e tyre personal nga pacienti/ja. Mbanin një "maskë", shtirreshin së ishte e lehtë një detyrë ndonëse ishte e vështirë (Teschendorf e të tjerë, 2007).

PËRFUNDIME

Stresi është një përjetim i pakëndshëm që lind të momentin që individët përballen me një situatë të panjohur. Çdo individ përdor strategji të veçanta për të përballuar stresin e tij dhe për të vazhduar mirëfunksionimin në jetën e pëditshme. Disa nga këto strategji mund të lidhen drejtpërdrejtë me zgjidhjen e problemit - stressor, ndërsa disa të tjera me shikëputjen, largimin apo mohimin e problemit. Në të shumtën e rasteve, individët kërkojnë më shumë informacion për situatën në të cilën gjenden, në mënyrë që të zbusin tensionin psikologjik.

Përkujdesësit e pacientëve me kancer ndërmarrin një rol shumë të ri për ata: atë të përkujdesësit. Në shumë raste ata detyrohen nga rrethanat, normat, detyrimet etj. që ta marrin përsipër këtë detyrë. Për këtë arsye, por edhe për shkak të natyrës së sëmundjes së kancerit, shumë përkujdesës përballen me një sasi të konsiderueshme stresi në jetën e tyre, e cila buron si nga "barra" e përkujdesjes, ashtu dhe nga problemet e tjera që rrjedhin nga ajo. Strategjitë e përballimit të stresit i shërbejnë përkujdesësve për të rregulluar dhe zbutur gjendjen e

tyre emocionale si dhe për të qenë më efektiv në detyrën që kryejnë (Teschendorf e të tjerë, 2007).

REFERENCAT

1. Alberca HMG, Cruz B, Lara JP, Garrido V, Gris E, Lara A, Castilla C. Disengagement coping partially mediates the relationship between caregiver burden and anxiety and depression in caregivers of people with Alzheimer's disease. Results from the MÁLAGA-AD study, *Journal of Affective Disorders*, Article in press
2. Carver CS, Scheier MF, Weintraub JK. Assessing coping strategies: a theoretically based approach. *Journal of Personal Social Psychology* 1989;56:267-288.
3. Ey S, Compas B, Epping-Jordan J, Worsham N. Stress responses and psychological adjustment in patients with cancer and their spouses. *Journal of Psychosocial Oncology*. 1998; 16, 59-77.
4. Gilar O dhe Zusman A. The correlation between coping strategies, doctor-patient/spouse relationships and psychological distress among women cancer patients and their spouses. *Psycho-Oncology*, 2007; 16: 1010-1018
5. Grbich C, Parker D, Maddocks I. The emotions and coping strategies of caregivers of family members with a terminal cancer. *Journal of Palliative Care*. 2001; 17(1):30-6.
6. Kershaw T, Northouse L, Kritpracha Ch, Schafenacker A & Mood D. Coping strategies and quality of life in women with advanced breast cancer and their family caregivers, *Psychology & Health*, 2004; 19, 2, 139-155
7. Lazarus RS, Folkman S. *Stress, Appraisal and Coping*. Springer: New York: 1984.
8. Mages N, Mendelsohn C. Effects of cancer on patients' lives: a psychological approach. Në Hund A, Slone G, Cohen F (eds), *Health Psychology*. Jossey-Bass: San Francisco, 1979; 255-284.
9. Morse S, Fife B. Coping with a partner's cancer: adjustment at four stages of the illness trajectory. *Journal of Cancer*, 2003; 1517-152
10. Pitceathly C, Maguire P. The psychological impact of cancer on patients' partners and other key relatives: a review from the perspectives of husbands and wives. *Journal of Psychosocial Oncology*. 1994; 12, 47-72.
11. Ptaceck J, Ptaceck J, Dodge K. Coping with breast Oncology Nursing Forum 1998, 25, 751-760.
12. Rodrigue J, Hoffman III R. Caregivers of adults with cancer: multidimensional correlates of psychological

- distress. *Journal of Clinical Psychology* 1994, 1, 231-244.
13. Scheier MF, Carver CS, Bridges MW. Distinguishing optimism from neuroticism, trait anxiety, self-mastery, and self-esteem: a reevaluation of the life orientation test. *Journal of Personal Social Psychology* 1994; 67:1063-1078.
 14. Sivia Barnoy, Yoram Bar-Tal, Bracha Zisser, Correspondence in informational coping styles: How important is it for cancer patients and their spouses?, *Personality and Individual Differences*, 2006; 105-115
 15. Spencer SM, Carver CS, Price AA. Psychological and social factors in adaptation. In Holland J (ed.), *Psycho-Oncology*. Oxford University Press: New York, 1998; 211-222.
 16. Taylor SE. *Health Psychology*. Random House: New York, 1991
 17. Teschendorf B, Schwartz C, Estwing Ferrans C, O'Mara A, Novotny P, dhe Sloan. *Caregiver Role Stress: When Families Become Providers*, *Cancer Control*, 2007, Vol. 14, No. 2
 18. Zeidner M, Saklofske D. Adaptive and maladaptive coping. In Zeidner M, Endler NS (eds), *Handbook of Coping: Theory, Research, Applications*. Wiley: New York, 1996; 505-531.

STRESS COPING STRATEGIES IN CANCER CAREGIVERS

Veronika Duci¹,

¹ Lecturer at the University of Tirana, Faculty of Social Sciences, Department of Social Policy and Social Work, Albania

SUMMARY

This article aims to explore some of the studies conducted in the field of caregiving for patients with cancer in different stages. Specifically, the focus in this article is on the stress coping strategies used by caregivers. Caring for cancer patients is associated with a range of problems, such as physical and mental health. Various studies report the intermediate factors that mediate the worsening or improving of symptoms of physical and mental health in caregivers. Some of these factors are: social support, appraisal of care, age, patient's functional status, perceived quality of life etc. Strategies for coping with stress are important mediators for continuing care, but also for the quality of which they are offered.

Key words: caregiver, cancer, stress, coping strategies, health.

ÇRREGULLIMET E SISTEMIT KARDIOVASKULAR SI PASOJË E CIANOZËS KRONIKE TE FËMIJËT ME KEQFORMIME CIANOTIKE TË LINDURA TË ZEMRËS

Nijazi Gashi ¹, R. Bejiqi ², V. Kotori ¹, R. Retkoceri ², H. Bejiqi ³, A. Retkoceri ³

¹Shërbimi i Endokrinologjisë, Klinika e Pediatriës, QKUK Prishtinë, Kosovë

²Shërbimi i Kardiologjisë, Klinika e Pediatriës, QKUK Prishtinë, Kosovë

³Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Prishtinë, Kosovë

Medicus 2013, Vol. 18 (1): 122-130

ABSTRAKTI

Te fëmijët me keqformime cianotike të lindura të zemrës hipoksemia kronike çon deri te ndryshimet në strukturën dhe funksionin e enëve të gjakut. Disa prej këtyre ndryshimeve janë progresive dhe e ndërlikojnë funksionin e sistemit kardiovaskular, duke e rritur mundësinë e lajmërimit të trombozave dhe embolive. Hulumtimet e fundit tregojnë se çrregullimi i funksionit të endotelit, si pasojë e cianozës kronike, është faktor i rëndësishëm në patogenezën e rrezikut kardiovaskular, të shoqëruar me cianozë kronike. Hipoksemia e rëndë dhe rritja e përqendrimit të hemoglobinës në hapsirën intravaskulare të cianoza kronike, kontribuojnë në çrregullimin e funksionit të sistemit vaskular. Njëkohësisht, eritrocitoza kompenzuese ndikon në rritjen e viskozitetit të gjakut, i cili ndikon në enët e gjakut me ndryshimin e hemodinamikës, të strukturës dhe funksionit të vaskulaturës. Si pasojë e këtyre ndryshimeve redukohet perfuzioni i indeve dhe furnizimi i tyre me oksigjen. Si pasojë përfundimtare, këto ndryshime kanë zvoglimin e funksionit të sistemit kardiovaskular dhe janë faktor i rëndësishëm i morbiditetit dhe mortalitetit siç janë infarkti dhe tromboembolia pulmonare.

Qëlimi i punimit është të diskutohet mbi efektet dhe ndryshimet përcjellëse në sistemin kardiovaskular, të shkaktuara nga cianoza qendrore, me fokus të posaqëm në implikimin dhe ndryshimet në endotel të fëmijët me sëmundje të lindura të zemrës, të përcjellura me cianozë qendrore. Poshtu do të diskutohet për pasojat patofiziologjike dhe mekanike të eritrocitozës kompenzatore dhe mekanizmave të mundshëm të disfunkcionit vaskular të fëmijët me cianozë qendrore.

Fjalë kyç: Cianoza qendrore, hipoksia kronike, keqformimet e lindura të zemrës, Syndroma e hiperviskozitetit, Syndroma Eisenmenger

HYRJE

Hipoksemia e rëndë dhe rritja e përqendrimit të hemoglobinës në hapsirën intravaskulare të cianoza kronike, kontribuojnë në çrregullimin e funksionit të sistemit vaskular. Njëkohësisht, eritrocitoza kompenzuese ndikon në rritjen e viskozitetit të gjakut, i cili ndikon në enët e gjakut me ndryshimin e hemodinamikës, të strukturës dhe funksionit të vaskulaturës. Si pasojë e këtyre ndryshimeve redukohet perfuzioni i indeve dhe furnizimi i tyre me oksigjen. Si pasojë përfundimtare, këto ndryshime kanë zvoglimin e funksionit të sistemit kardiovaskular dhe janë faktor i rëndësishëm i morbiditetit dhe mortalitetit siç janë infarkti dhe tromboembolia pulmonare.

Cianoza pjesërisht e përfshinë endotelin vaskular, i cili ka funksion më shumë se një mbështjellës dhe barrierë e thjeshtë ndërmjet gjakut dhe indeve. Hulumtimet e fundit tregojnë se endoteli është strukturë komplekse e cila merr pjesë në rregullimin e tonusit vaskular si dhe në rregullimin e angiogenezës dhe hemostazës. Oksidi nitrik, i prodhuar nga endoteli, luan rol kryesor në rregullimin e tonusit të muskulaturës së lëmuar në muret e enëve të gjakut dhe, në këtë mënyrë, edhe në rregullimin e garkullimit të gjakut. Disfunkcioni i endotelit është faktori kryesor në patogenezën e shumë sëmundjeve ku disa prej tyre si ateroskleroza, hipertensioni dhe pamjaftueshmëria e zemrës tani janë mirë të hulumtuara dhe të definuara. Hulumtimet e fundit tregojnë se endoteli mund të përjetojë ndryshime të sëmundjet e ndryshme të lindura të zemrës, posaqërisht te ato të përcjellura me cianozë.

MANIFESTIMI KLINIK I SËMUNDJEVE VASKULARE TE KEQFORMIMET E LINDURA TË ZEMRËS, TË PËRCJELLURA ME CIANOZË QENDRORE

Ekziston një numër i madh i shkrimeve ku prezantohet bashkveprimi ndërmjet disfunktionit të endotelit dhe rritjes së incidencës së çrregullimeve vaskulare të rriturit si dhe në përkeqësimin e morbiditetit dhe mortalitetit të pacientët me pamjaftueshmëri kronike të zemrës. E njëjta ka ngjajshmëri edhe te adoleshentët me keqformime të lindura të zemrës, të përcjellura me cianoze qendrore, ku cianoza si shenjë klinike, funksionalisht është më së shpeshti e përfshirë në këtë grup të sëmundjeve. Studimet multicentrike tregojnë se mbi 14 % e pacientëve me keqformime cianotike të lindura të zemrës kanë pasur insulte cerebrovaskulare dhe se kjo fundamentalisht prekë dhe e ndryshon kualitetin e jetës (1). Për më tepër, hulumtimet radiologjike tregojnë se 1/3 e pacienteve me Sindromën Eisenmenger kanë pasur trombozë mesatare ose masive në pjesën proksimale të arteries pulmonare, krahasur me zero incidencën e trombozës të pacientët me hipertension primar pulmonar. Në anën tjetër, të njëjtat hulumtime tregojnë se incidenca e trombozës pulmonare nuk është në korelim me shkallën e përkeqësimit të hipoksemisë. Kjo mund të sqarohet me faktet se funksioni i endotelit të ndryshuar ka një rëndësi të posaçme në fillimin dhe provokimin e këtyre ndryshimeve vaskulare përkundër çrregullimeve komplekse në sistemin e hemostazës, me tendencë të zhvillimit të hemorragjisë të keqformimet e lindura të zemrës, të përcjellura me cianoze qendrore.

The Euro Heart Survey ka treguar se keqformimet e lindura të zemrës me cianoze kanë mortalitet 5 vjeçar 12.5 % dhe është shkaku më i lartë i vdekshmërisë të të rriturit me keqformime të lindura të zemrës. Te të rriturit me sindromën Eisenmenger, te më shumë se gjysma e tyre shkaktar i vdekjes është vdekja e papritur kurse në autopsi gjetja dhe shkaktari më i shpeshtë i është raptura masive e ndonjë arterie, më së shpeshti arteries pulmonare. Ende nuk janë të qartë mekanizmat por dihet se ndryshimet e endotelit janë shkaktar i zgjerimeve aneurizmale dhe rapturave të arterieve (1,2).

ÇRREGULLIMET VASKULARE SI PASOJË E ERITROCITIZËS DHE HIPERVISKOZITETIT

Eritropoeza dhe eritrocitoza, si pasojë e cianozës kronike, ndikojnë në rritjen e viskozitetit dhe shkaktojnë çrregullime reologjike të gjakut, ndikojnë në funksionin e endotelit dhe shkaktojnë çrregullime në funksionin e

sistemit vaskular, me tendencë të zhvillimit të trombozës dhe tromboembolive masive.

Viskoziteti definohet si rezistenca e lëngjeve gjatë qarkullimit dhe varet prej vetive të lëngut dhe diametrit të enës së gjakut në të cilën zhvillohet qarkullimi. Hematokriti është determinanta kryesore e viskozitetit të gjakut dhe në enët e mëdha të gjakut ekziston realcioni linear ndërmjet viskozitetit të gjakut dhe hematokritit. Te cianoza kronike eritrocitoza kompensatore është shkaktari kryesor në ngritjen e viskozitetit të gjakut kurse pasojat e hiperviskozitetit varen prej shpejtësisë së qarkullimit dhe diametrit të enëve të gjakut në të cilin qarkullimi zhvillohet. Kur shpejtësia e gjakut është e vogël, si p.sh. në qarkullimin venoz, viskoziteti rritet eksponencialisht me mundësi të zhvillimit të agregimit të eritrociteve dhe formimit të formacioneve trombotike. Në anën tjetër, kur shpejtësia e gjakut është e madhe si në qarkullimin arterial viskoziteti mbetet konstant. Përndryshe, vetitë e viskozitetit në mikroqarkullim dallojnë shumë nga qarkullimi në enët e mëdha të gjakut ku viskoziteti manifeston rënie progresive i njohur si efekti i Fahraeus-Lindqvist-it (2,3).

VISKOZITETI I GJAKUT ZVOGËLOHET NË MIKROQARKULLIM

Me 1929 *Fahraeus* e përshkroi fenomenin e zvoglimit të viskozitetit në mikroqarkullim: “Sqarimi i këtyre rezultateve eksperimentale pa dyshim qendron në faktin se gjaku, duke qarkulluar në gypa të ngushtë, ka më shumë plazmë dhe më pak elemente qelizore sesa kur gjaku qarkullon në gypa të gjërë. Në studimet e veta *Lipowski* gjithashtu e ka vërtetuar rënien e njëtrajtshme të hematokritit në qarkullimin periferik. Si pasojë, viskoziteti i gjakut zvogëlohet në enët e vogla të gjakut deri në diametrin mesatar të kapilarëve prej 10 µm. Këto veti biomekanike të gjakut janë të rëndësishme për jetën normale sepse në një pjesë të enëve të gjakut ka më shumë eritrocite me qëllim të furnizimit të indeve me shumë oksigjen kurse në pjesën kapilare gjaku ka më pak hemoglobinë dhe është më i pasur me plazmë. Kjo mundëson “pastrimin e plazmës” prej elementeve qelizore duke eliminuar në mënyrë selektive eritrocitet prej qarkullimit në enët e vogla të gjakut (4).

Në periferi, me zvogëlimin progresiv të diametrit të enëve të gjakut, eritrocitet marrin pozicion rreshtimi në kapilare, varësisht prej diametrit të kapilarëve. Qarkullimi në rresht në njërin anë zhvillohet me hematokrit të zvogëluar kurse në anën tjetër kontakti dhe

fërkimi ndërmjet qelizave është i vogël dhe pothuajse i pa rëndësishëm. Në këtë mënyrë mund të sqarohet se si në periferi viskoziteti më shumë është i varur prej mediumit suspendues - plazmës sesa prej elementeve të formuara - hematokritit. Studimet *in vivo* kanë treguar se me zvoglimin e diametrit të kapilarëve nën 2.7 µm vjen deri te deformimi dhe ripozicionimi i formës së eritrociteve dhe ata me vështirësi arrijnë në pjesën venoze të kapilarëve (5,6).

Ndryshimet e komplikuar në qarkullimin e gjakut në nivelet e ndryshme të shtratit vazal rezultojnë me dallime të rëndësishme në shkallën e fërkimit dhe stresit në mure të enëve të gjakut. Dhe përfundimisht, ndikimi i eritrocitozës është i ndryshëm në enët e mëdha të gjakut në krahasim me ndikimin në mikroqarkullim. Kjo është pasojë e eksponimit dhe veprimit kronik të stresit në mure të enëve të gjakut të eritrocitoza kompensatore, e cila lajmërohet te cianoza dhe hipoksia kronike, ku enët e mëdha të gjakut janë shumë më të eksponuara ndaj stresit se sa mikroqarkullimi, edhe pse kjo pjesë ende nuk është mirë e hulumtuar.

NDIKIMI I MUNGESËS SË HEKURIT NË ERTROCITE DHE MURE TË ENËVE TË GJAKUT ËSHTË KUNDRËSHTUES

Në mungesën e hekurit rriten ndryshimet dhe deformimet e eritrociteve, një dukuri e shpeshtë të cianoza kronike dhe eritrocitoza kompensatore, pjesërisht edhe te venepunksioni terapeutik. Më tepër se katër dekada janë zhvilluar debate të ndryshme, shpeshherë kontraverze lidhur me viskozitetin e gjakut dhe morfologjinë e eritrociteve, si pasojë e mungesës së hekurit. Linderkamp me bashkpunëtorë i ka analizuar fëmijët me cianoze dhe ka ardhë deri në përfundim se zvoglimi minimal i vëllimit mesatar të eritrociteve në shkallë sinjifikante ndikon në rritjen e deformabilitetit të eritrociteve, e rritë shkallën e agregimit dhe e rritë viskozitetin e gjakut. Poashtu, ai ka treguar se vëllimi mesatar i eritrociteve ose sasia mesatare e hemoglobinës është e shoqëruar me ngritje eksponenciale të viskozitetit të gjakut. Një purputhshmëri e mundur, e paraqitur në studim ndërmjet masës së eritrociteve dhe viskozitetit, është se para studimit është bërë korrigjimi i gjakut në vlera fikse të hematokritit ose hulumtimet janë bërë me gjak të ambalazhuar para hulumtimit të viskozitetit. Disa autorë tjerë në studimet e veta nuk kanë gjetur korrelim të rëndësishëm ndërmejt vëllimit mesatar të eritrociteve, sasisë mesatare të hemoglobinës dhe viskozitetit të gjakut.

Studimet e fundit të kryera nga Broberg me bashkpunëtorë, kanë shprehur dyshim në këtë teori, ku mungesa e hekurit ndikon në ngritjen e viskozitetit të gjakut, në kuadër të teorisë të eritrocitozës. Ata i kanë krahasuar 14 pacientë me mungesë të hekurit dhe me sëmundje cianotike të lindur të zemrës, me moshë mbi 16 vjeç, me 25 pacientë tjerë me sëmundje cianotike të zemrës dhe pa mungesë të hekurit. Të dy grupet e pacientëve kanë sindromën Eisenmenger. Pacientët me mungesë të hekurit kanë vlera më të ulta të hemoglobinës, kanë kapacitet më të ulët rezidual për oksigjen, e kanë vëllimin mesatar më të ulët kurse numri i eritrociteve është më i lartë. Vlerat e hematokritit në të dy grupet janë të njëjta. Viskoziteti i gjakut është matur me viskozimetër rotacional dhe teknikë të standardizuar. Pastaj, hematokriti është rregulluar në vlera 45 % me dhënien e plazmës autologe dhe prap është vlerësuar viskoziteti. Nuk është regjistruar dallim në viskozitetin e gjakut. Viskoziteti i plazmës poashtu është i njëjtë në të dy grupet (6,7). Kontraverza më e madhe e këtij studimi është shoqërimi i mungesës së hekurit me rritje të rrezikut për sëmundje kardiovaskulare te pacientë me keqformime cianotike të lindura të zemrës. Njëkohësisht është treguar se mungesa e hekurit e zvogëlon deformitetin e eritrociteve, e rrit viskozitetin dhe rrezikun për zhvillimin e trombozës dhe insulteve cerebrovaskulare. Poashtu, sipas publikimeve të fundit, mungesa e hekurit dhe rritja e viskozitetit të gjakut janë pjesërisht kontradiktore pasi që mungesa e hekurit është e shoqëruar me insulte edhe te fëmijët e shëndoshë. Kështu, mekanizmat e rritjes së rrezikut për insulte cerebrovaskulare te pacientët me mungesë të hekurit dhe me sëmundje të lindura të zemrës, të përcjellura me cianoze, mbasin të panjohura. Megjithatë, ndoshta mungesa e hekurit ka pasoja negative te keqformimet cianotike kongjenitale të zemrës. Kompensimi i hekurit me qëllim të parandalimit të insulteve iskemike nuk është vërtetuar, por kompensimi i kujdesshëm mund të arsyetohet te pacientët me mungesë të hekurit (8).

EFEKTI I ERTROCITOZËS NË FUNKSIONIN E ENDOTELIT

Shumë kohë më herët është vërtetuar se rritja e qarkullimit të gjakut e rrit diametrin e enëve të gjakut, fenomen i njohur si dilatim i provokuar me qarkullim. Hulumtimet teorike kanë treguar se faktori kryesor në këtë proces është viskoziteti i gjakut por i cili negativisht vepron në muret e enëve të gjakut, posaqërisht në endotel.

NGRITJA E PËRNJËHERSHME E STRESIT SHPIE DERI TË VAZODILATIMI

Me 1993 *Koller* dhe bashkpunëtorët kanë treguar se muskuli kremaseter dilatohet si përgjigje në rritjen e stresit vetëm nëse endoteli është intakt. Punimet e kujdeshme të *Tsai-t* dhe bashkpunëtorëve kanë treguar se qarkullimi në arteriole dhe venula rritet më shumë nëse bëhet transfuzioni i lëngjeve me viskozitet të lartë sesa atyre me viskozitet të ulët, duke sugjeruar se dallimi në stresin e mureve, me ngritjen e viskozitetit, shpie deri te vazodilatimi dhe rritja e perfuzionit të indeve. Më vonë kjo teori është vërtetuar në shumë studime. Sot është plotësisht e qartë se stresi i mureve në enët e gjakut është një trigger i rëndësishëm në rritjen e sintezës dhe në vlerat e oksidit nitrik të endotelit, kurse niveli i sintezës të acidit nitrik shpie deri te vazodilatimi dhe është i varur nga gjendja e endotelit në arterie (9).

EFEKTI I OKSIDIT NITRIK NË RELAKSIMIN VASKULAR, I SHOQËRUAR ME NDRYSHIMET E STRESIT TË MUREVE TË ENËVE TË GJAKUT

De Wit me bashkpunëtorë kanë vërtetuar se dilatimi i sistemit arterial mund të ndalohej me dhënien e L-N G monomethyl-argininës, një inhibitor i oksidit nitrik, i cili sintetizohet në endotel. Ngritja akute e viskozitetit të gjakut mund të ndikojë në rritjen e liritimit akut të oksidit nitrik, rritjen e vazodilatimit dhe perfuzionit kurse ngritja kronike, e cila shihet te eritrocitoza kompensatore, ka efekt shumë më kompleks si rimodelimi i vaskulaturës, me rritjen e diametrit të enëve të gjakut, me qëllim të normalizimit të stresit në muret e tyre. Elementi tjetër i rëndësishëm të rritja e hematokritit është mundësia që hemoglobina e lirë dhe brendaqelizore ndikon në pastrimin e oksidit nitrik. Pra, është e mundur që te eritrocitoza sekondare, stresi në muret e enëve të gjakut dhe rezistenca vaskulare janë të rritura si pasojë e inaktivizimit të oksidit nitrik, me prejardhje prej endotelit dhe i cili inaktivizohet prej një faktori të varur prej hemoglobinës.

HEMATOKRITI NDIKON NË FUNKSIONIN E ENËVE TË GJAKUT PËRMES PASTRIMIT TË OKSIDIT NITRIK

Një numër i konsiderueshëm i shkencëtarëve ka bërë hulumtime në drejtim të efektit të hematokritit në vazodilatimin e varur prej endotelit dhe kanë ardhur deri te përfundimi se te personat e shëndoshë, vazodilatimi i ndërmjetësuar prej qarkullimit, është në korelim të

anasjelltë me përqëndrimin e hemoglobinës, pavarësisht prej qarkullimit dhe diametrit të enëve të gjakut. Dilatimi i ndërmjetësuar prej qarkullimit është dy herë më i lartë te personat me vlera të hemoglobinës nën 14 g/dl sesa te personat me hemoglobinë të lartë. Po e njëta nuk ndodh te të sëmurët me diabet melit tip 2, të shoqëruar me disfunkcion të membranës bazale të endotelit. Zbulimet tjera te pacientët me anemi kronike sugjerojnë se, rritja e liritimit bazal të oksidit nitrik kontribuon në zvoglimin e rezistencës vaskulare sistemike. Është vërtetuar se aktiviteti vazodilatativ i acetil-kolinës është në korrelim me nivelin e hemoglobinës në qarkullim. Reagimi i rrjetit vaskular ndaj acetil-kolinës është i varur prej oksidit nitrik të endotelit. Është treguar se efekti i tij është dukshëm më i vogël te pacientët me policitemi dhe hipoksi në krahasim me pacientët me normocitemi dhe hipoksemi. Disa autorë (*Sutton et al, Rosenthal et al*) kanë treguar se pacientët me keqformime cianotike kongjenitale të zemrës dhe eritrocitozë të rëndë, ku hematokriti është më i lartë së 66 -73 %, eritrocitet izovolemike ndikojnë në zvoglimin e rezistencës së përgjithshme periferike dhe ngritjen e cardiac output-it, ngritjen e vëllimit goditës, rritjen e qarkullimit sistematik dhe furnizimit me oksigjen (7,8,9).

